



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
Drejtoria e Inspektimit.



RAPORT – INSPEKTIMI

**“KONSTATIMI I GJENDJES AKTUALE TË TRAJTIMIT TË PERSONAVE
TË SHOQËRUAR, NDALUAR APO ARRESTUAR NGA STRUKTURAT E
POLICISË SË SHTETIT NË ZBATIM TË 12 REKOMANDIMEVE TË
RAPORTIT ANALITIK PËR VITIN 2010 TË KOMISIONIT EUROPIAN”.**

Tiranë, më 22.06.2011



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Në bazë të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së nr.218/2, datë 28.03.2011 "Për kryerjen e një Inspektimi në Strukturat e Policisë së Shtetit", si dhe Protokollit të Inspektimit nr.218/3, datë 28.03.2011, Drejtoria e Inspektimit të SHKB-së zhvilloi inspektimin me objekt:

"Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Inspektimi kaloi nëpër fazën e planifikimit të problematikës ku do përqëndrohej inspektimi, metodologjisë që do përdorej, identifikimin real të performancës, të treguesve që kanë progres dhe të atyre treguesve që kanë nevojë për përmirësim.

Inspektimi shqyrtoi momentin aktual

Koha e kryerjes së inspektimit 28.03.2011 – 13.04.2011

QËLLIMI

Evidentimi, analizimi dhe vlerësimi me objektivitet, në përputhje me 12 Rekomandimet e Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian të trajtimit të personave të ndaluar/arrestuar nga Policia e Shtetit.

OBJEKTIVAT

1. Evidentimi i numrit të dhomave të sigurisë
2. Evidentimi i gjendjes së trajtimit të personave të shoqëruar dhe ndaluar.
3. Evidentimi i rasteve të keqtrajtimit të të ndaluarve dhe kallëzimit të punonjësve të Policisë së Shtetit në Prokurori
4. Evidentimi i respektimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.
5. Vlerësimin e zbatimit të ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarte të punës.
6. Verifikimi i kushteve dhe kritereve të:
 - Sigurisë së jetës
 - Trajtimit ushqimor
 - Trajtimit shëndetësor
 - Të jetesës
 - Higjieno – sanitare
 - Pranimit
 - Të ndërtimit e funksionimit
7. Vlerësimin e mbajtjes dhe administrimit të dokumentacionit lidhur me personat e ndaluar/arrestuar.
 - Regjistra
 - Libra
 - Fashikuj
 - Dosje



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

8. Verifikimin e kriterëve të personelit të shërbimit për trajtimin e personave të ndaluar.
9. Evidentimin e detyrave të realizuara.
10. Evidentimin e mangësive.
11. Konstatimin e shpenzimeve të kryera (zëri në buxhet) për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar.
12. Dhënia e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e punës.

METODOLOGJIA

Ky inspektim u realizua nëpërmjet analizës së disa burimeve:

1. Kqyrjes së ambienteve të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë (fotografimi dhe përshkrimi)
2. Kqyrjes së administrimit të dokumentacion
3. Intervistimit të personave të shoqëruar ose ndaluar
4. Intervistimit të punonjësve të policisë

PËRBËRJA E GRUPIT

- Drejtor Drejtorie	Heral SARAÇI,	(Përgjegjës Grupi)
- Përgjegjës Sektori	Florian SULEJMANI	(Anëtar)
- Inspektore	Rita Gjati	(Anëtare)
- Inspektor	Artan KOLA,	(Anëtar)
- Inspektor	Enton RADOVANI,	(Anëtar)
- Inspektor	Altin PONARI,	(Anëtar)
- Inspektor	Sterjo GOLLOSHI,	(Anëtar)
- Inspektor	Ilir QARRI,	(Anëtar)
- Shef Sektori	Franc NDOJA	(Anëtar)
- Shef Sektori	Asllan HOXHAI	(Anëtar)
- Shef Sektori	Fadil ZENELAJ	(Anëtar)
- Shef Sektori	Arsen ZEKA	(Anëtar)
- Shef Sektori	Imer UKA	(Anëtar)
- Shef Sektori	Musa METKO	(Anëtar)
- Shef Sektori	Nazar LAMO	(Anëtar)
- Shef Sektori	Altin CURRI	(Anëtar)
- Shef Sektori	Paulin ÇUPI	(Anëtar)
- Shef Sektori	Gëzim DUMANI	(Anëtar)
- Specialist	Behar SULEJMANI	(Anëtar)
- Specialist	Arseni MEMA	(Anëtar)



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

VERIFIKIMET

- Në DPQ Tiranë u kryen nga Drejtor Heral SARAÇI, Inspektor Sterjo GOLLOSHI dhe Shef Sektori Franc NDOJA (përfshirë edhe specialistin e hetimit sipas komisariatit që mbulon)
- Në DPQ Shkodër dhe DPQ Lezhë nga Përgjegjës Sektori Florian SULEJMANI, Shef Sektori Paulin ÇUPI dhe Shef Sektori Gëzim DUMANI (përfshirë edhe specialistin e hetimit sipas komisariatit që mbulon)
- Në DPQ Kukës dhe DPQ Dibër nga Inspektor Ilir QARRI, Shef Sektori Asllan HOXHAI dhe Specialist Behar SULEJMANI (përfshirë edhe specialistin e hetimit sipas komisariatit që mbulon)
- Në DPQ Gjirokastrë, DPQ Vlorë dhe DPQ Fier nga Inspektor Artan KOLA, Inspektor Altin PONARI, Shef Sektori Musa METKOShef Sektori Imer UKA dhe Shef Sektori Arsen ZEKA, (përfshirë edhe specialistin e hetimit sipas komisariatit që mbulon)
- Në DPQ Durrës dhe DPQ Elbasan nga Inspektore Rita Gjati, Shef Sektori Fadil ZENELAJ dhe Shef Sektori Altin CURRI (përfshirë edhe specialistin e hetimit sipas komisariatit që mbulon)
- Në DPQ Korçë dhe DPQ Berat nga Inspektor Enton RADOVANI, Shef Sektori Nazar LAMO dhe Specialist Arseni MEMA (përfshirë edhe specialistin e hetimit sipas komisariatit që mbulon).

AKTE LIGJORE DHE NËN LIGJORE

- **12 Rekomandimet e Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".**
- Ligji nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale"
- Ligji nr.8485, datë 18.12.2006 "Kodi i Procedurës Administrative"
- Ligji nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit"
- Urdhër nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike"
- Urdhrat dhe Udhëzimet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ligji i njeh Policisë së Shtetit një sërë kompetencash për ushtrimin e funksioneve të saj si shoqërimin, arrestimin, kontrollin, sequestrimin, përdorimin e forcës etj, kompetenca këto, që kanë të bëjnë me privimin e qytetarëve nga liria, ndërhyrjen në jetën private etj, por vetëm për qëllime të ligjshme dhe në interes të publikut.

Procedura e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit, duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Në ambientet ku akomodohen, të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve, duhet t'u garantohen trajtim njerëzor dhe kushte infrastrukturore të cilat nuk duhet të çenojnë shëndetin fizik apo mendor të tyre.

Në funksion të përmirësimit të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka nxjerrë një sërë aktesh nënligjore, ku përcaktohen në mënyrë të detajuar kushtet, kriteret dhe dokumentacioni që mbahet në lidhje me trajtimin e këtyre personave, ku si më kryesoret përmendim:

- Urdhër nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike",
- Urdhër nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore",
- Urdhër nr.506, datë 06.05.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH, "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit"

1. Kushtet dhe kriteret për trajtimin e personave të ndaluar dhe arrestuar në njësitë policore.

Kushtet që duhet të plotësojnë dhomat e sigurisë.

Dhomat e sigurisë duhet të plotësojnë kushtet për një trajtim njerëzor të personave të ndaluar apo arrestuar.

Në këto kushte përfshihen:

- ***Elementët e sigurisë për jetën e personave të ndaluar apo arrestuar.***

Çdo dhomë sigurie duhet të përbëhet nga a) paradhoma dhe b) ambienti i qëndrimit të cilat ndahen nga njëra tjetra me zgarë hekuri të montuar në tavan e dysheme në mënyrë vertikale.

Në ambientin e qëndrimit nuk duhet të ketë asnjë paisje hidraulike, elektrike të cilat mund të përbëjnë shkak për veprime të dëmshme për personin e ndaluar/arrestuar ose persona të tjerë.

- ***Kushtet e jetesës***

Për çdo dhomë sigurimi duhet të sigurohet se ajo ka hapësirë të mjaftueshme në raport me numrin e të ndaluarve/arrestuarve (normat ndërkombëtare 9m³ dhe 6m² për person). Të ketë ajrim normal dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Në rastet kur ambientet nuk plotësojnë kushtet minimale për trajtim, duhet garantuar ajrim për të paktën 2 orë në ditë.

- ***Trajtimi ushqimor***

Për personat e ndaluar dhe arrestuar duhet të garantohet trajtim ushqimor, i kontrolluar dhe i pajisur me aksesoret përkatës (pjatë, lugë, pirun plastik).



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- *Trajtimi shëndetësor*

Për çdo person të ndaluar dhe arrestuar menjëherë pas kryerjes së procedurave të pranimi duhet kryer vizita mjekësore nga personeli mjekësor i strukturës ose qendrat spitalore rajonale. Të gjitha të dhënat duhet të pasqyrohen në kartelën mjekësore dhe regjistrin e vizitave mjekësore. Përveç vizitës mjekësore paraprake personeli mjekësor duhet të kryejë vizita mjekësore sa herë që personi i ndaluar apo arrestuar paraqet kërkesë apo shqetësime. Vizitat duhet të kryhen në ambiente të caktuar dhe barnat duhet të sigurohen nga struktura, por edhe nga familja. Personat me sëmundje ngjitëse apo probleme të shëndetit mendor duhet të mbahen në ambiente të veçanta.

Në ambientet e brendshme duhet të ketë krevat i fiksuar dhe i pajisur me të gjitha paisjet e hotelierisë të cilat duhet të jenë të pastra dhe në përputhje me stinën.

- *Kushtet higjeno sanitare*

Paisjet hidro-sanitare duhet të jenë në paradhomë dhe personat e ndaluar/arrestuar mund ti përdorin ato tre herë në ditë (vaktet), si edhe për të patur mundësinë e pastrimit të tyre, si edhe nyje e veçantë për larjen e trupit.

Kushtet dhe kriteret e pranimi

Pranimi i të arrestuarit ose ndaluarit në ambjentet e dhomave të sigurisë bëhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë kundrejt dokumentacionit të mëposhtëm;

a. Për të ndaluarin/arrestuarin

- Procesverbalin e arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurori, ose procesverbali për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për caktimin e masës së arrestit, si dhe kopje të vendimit gjyqësor.
- Procesverbalin e kontrollit personal së bashku me sendet personale që i janë gjetur gjatë kontrollit.
- Një dokument zyrtar identifikimi.

b. Për të dënuarit në mungesë me vendim gjykatë të formës së prerë.

- Vendimi i formës së prerë të gjykatës për dënimin me burgim të personit në mungesë.
- Kopje të Urdhrit të Prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal.
- Procesverbali i ekzekutimit të urdhrit të prokurorit.
- Procesverbal për kontrollin personal dhe sendet personale.
- Një dokument identifikimi zyrtar.

Në momentin e pranimi për personat e ndaluar/arrestuar duhet bërë kontrolli fizik nga punonjës policie i të njëjtit seks, si edhe vendosja në ambiente të specifikuar për meshkuj, femra, të mitur.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Sendet ruhen në ambiente të veçanta e të sigurta nga përgjegjësi, por me kërkesë të vetë personit mund ti kalojnë edhe familjarëve.

Dokumentacioni që mbahet në dhomat e sigurisë.

Përgjegjësi i dhomave të sigurisë në një raft të veçantë brenda sistemit të dhomave të sigurisë mban, plotëson dhe administron këto dokumente:

- a. Regjistri për evidentimin e personave të ndaluar dhe arrestuar,
- b. Regjistri i sendeve personale të ndaluarve dhe arrestuarve,
- c. Regjistri i evidentimit të marrjes në pyetje nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, takimeve me mbrojtësit ligjorë, me mbrojtësit e të drejtave të njeriut avokatin e popullit etj.
- d. Regjistri i evidentimit të vizitave mjekësore brenda 24 orëshit të parë, gjatë qëndrimit apo në qendrat rajonale spitalore,
- e. Libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit dhe evidentimit të kontrolleve në dhomat e sigurisë dhe lënive të detyrave.
- f. Fashikujt (dosjet) personale për çdo të ndaluar dhe arrestuar me kopje të dokumenteve të tyre.
- g. Dosje për administrimin e procesverbaleve të dorëzimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në institucionet e paraburgimeve, të dorëzimit të sendeve personale si dhe urdhrat për transferim apo shoqërim ne rastet e veprimeve hetimore, etj.
- h. Lista e personelit të shërbimit dhe atë ndihmës që kanë të drejtë të futen në këto ambiente, të miratuar nga Shefi i Komisariatit.
- i. Të gjithë librat e shërbimit e regjistrat të regjistrohen me numër fletësh në sekretari.

2. Personat e shoqëruar.

Sipas ligjit nr. 9749, dt. 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit" shoqërimi, nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrativ dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimit në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij.

Kushtet e mjediseve ku mbahen personat e shoqëruar.

Për një trajtim dinjitoz e njerëzor të personave që shoqërohen, mjediset ku mbahen këta persona të plotësojnë kushtet, si më poshtë:

- a. Këto mjedise të jenë brenda ose pranë godinave, ndërtesave të drejtorive, komisariateve dhe stacioneve të policisë.
- b. Të jenë me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave si dhe të kenë dritare me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral.
- c. Të kenë të vendosura pajisje e orendi të tilla pune për specialistët e ndihmës/specialistët e policisë si tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- d. Të jenë të lyera, të pastra higjienikisht si dhe të kenë ndriçim të mjaftueshëm artificial.
- e. Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to të ketë tualete të ndara për femra dhe meshkuj të pajisur me mjetet e domosdoshme.
- f. Në këto mjedise të mos mbahen sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.
- g. Dritaret e këtyre mjedisve të jenë të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.

Trajtimi i personave të shoqëruar:

Të gjithë personat që shoqërohen dhe mbahen në mjediset e zyrat e Policisë së Shtetit, trajtohen në mënyrë të barabartë, pa u diskriminuar për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, si më poshtë :

- a. Personat e shoqëruar mbahen në mjedise e ambiente të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar (dhomat e sigurisë).
- b. Të shoqëruarit meshkuj, femra dhe të miturit mbahen në mjedise të veçanta (të ndara) nga njëra tjetra.
- c. Menjëherë pas shoqërimit të personit në mjediset e zyrat e policisë apo organin urdhërdhënës, punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin njofton drejtuesin e komisariatit/stacionit të policisë apo atë të organit urdhërdhënës.
- d. Punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin bën dokumentimin e veprimeve me të shoqëruarin në regjistrin sipas rubrikave përkatëse për këtë qëllim.
- e. Mbajtja e personave të shoqëruar në mjediset e zyrat e policisë kryhet deri në verifikimin e zgjidhjen e çështjes për të cilën është kryer shoqërimi, por jo më shumë se 10 orë.

Kur vlerësohet se personi i shoqëruar ka nevojë për përkujdes mjekësor, merren masat e nevojshme për dhënien e ndihmës mjekësore si dhe kur është e domosdoshme dërgohet për trajtim shëndetësor të specializuar.

Dokumentimi i të dhënave dhe i veprimeve në rastet e shoqërimit të personave

Dokumentimi i të dhënave dhe veprimeve që kryhen me personat e shoqëruar bëhet nga punonjësi i policisë që bën shoqërimin, si më poshtë:



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Në rastet e shoqërimit administrativ të personave në mjediset e zyrat e policisë, punonjësi i policisë bën dokumentimin e regjistrimin e të dhënave në librin apo regjistrin e personave të shoqëruar, si më poshtë :

- a) Emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja.
 - b) Adresa e saktë e vendbanimit.
 - c) Pamja e jashtme e personit duke përfshirë dhe shenja të veçanta që mund të kenë (me një dorë apo një sy, shenja djegieje apo plage, nishane etj)
 - d) Puna apo veprimtaria që kryen.
 - e) Arsytet e shkaqet e shoqërimit.
 - f) Komisariatit dhe zyrën përkatëse ku është kryer shoqërimi.
 - g) Emrin, mbiemrin e funksionin e punonjësit të policisë që ka kryer shoqërimin.
 - h) Ora, data e shoqërimit.
 - i) Ora, data e lënies së lirë të personit.
 - j) Punonjësi i policisë që punoi për verifikimin e zgjidhjen e çështjes së personit të shoqëruar.
 - k) Emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vendndodhjes së personit të shoqëruar.
1. Punonjësi i policisë që kryen shoqërimin e personit plotëson formularin "SH" (bashkëlidhur kësaj procedure) në dy kopje dhe ja dorëzon punonjësit të policisë të shërbimit të informacionit në sallën e drejtimit dhe të koordinimit.
 2. Punonjësi i shërbimit të informacionit pasi bën verifikimin e formularit model "SH" dhe në rast se gjen gabime në formular ja kthen punonjësit të policisë që bëri shoqërimin për ta korrigjuar.
 3. Nëse ka mosmarrëveshje në përcaktimin e strukturës respektive që do të kryej veprimet me personin e shoqëruar, punonjësi i shërbimit të informacionit njofton titullarin e organit (institucionit) të policisë, i cili do të vendosë se cila strukturë dhe punonjës policie do të merret me këtë çështje.
 4. Në rastet kur punonjësi i policisë i strukturës respektive gjykon se me personin e shoqëruar nuk do të kryhen veprime të tjera, bën plotësimet përkatëse në formularin model "SH" duke vepruar si më poshtë:
 - a. Nëse për personin e shoqëruar ekziston një praktikë e mëparshme, një kopje të formularit ja bashkëngjit kësaj praktike, kurse kopjen tjetër e dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore.
 - b. Nëse për personin e shoqëruar nuk ekziston praktikë e mëparshme, të dy kopjet e formularit i dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore.
 5. Punonjësi i policisë i strukturës respektive nëse gjykon se me personin e shoqëruar do të kryhen veprime të tjera për identifikimin e tij bën plotësimet përkatëse në formularin model "SH" dhe shoqëron personin në laboratorin e policisë shkencore.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT, TIRANË

Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë është e strukturuar në 7 Komisariate :

Komisariati i Policisë nr.1,
Komisariati i Policisë nr. 2,
Komisariati i Policisë nr. 3,
Komisariati i Policisë nr. 4,
Komisariati i Policisë nr. 5,
Komisariati i Policisë nr. 6,
Komisariati i Policisë Kavajë.

Grupi i inspektimit mori kontakt me Drejtorin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Tiranë, Drejtues Sajmir MUÇAJ, i cili bëri prezent kushtet aktuale të dhomave të sigurisë, trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar, si dhe problemet që dalin gjatë dinamikës së përditshme të punës.

Komisariatet e DPQ, Tiranë kanë ambiente shoqërimi dhe dhoma sigurie, me përjashtim të Komisarariatit të Policisë nr.6, i cili ka vetëm ambiente shoqërimi, ndërsa si dhoma sigurie, ky komisarariat përdor ato të Komisarariatit të Policisë nr.2.

Z.Muçaj u shpreh se kushtet e dhomave të sigurisë nuk janë në nivelin e kërkuar, përveç Kom.Pol nr.5 dhe Kom.Pol Kavajë.

Më tej ai theksoi se për vitin 2011 është çelur një fond i posaçëm prej 5 000 000 lekë, për rikonstruksionin e dhomave të sigurisë në DPQ, Tiranë.

Të ndaluarit apo arrestuarit trajtohen me ushqim nga strukturat përkatëse të policisë.

Lidhur me trajtimin ushqimor të personave të ndaluar apo arrestuar, z.Muçaj u shpreh se në buxhetin e vitit 2011 është parashikuar si zë i veçantë trajtimi ushqimor, për garantimin e të cilit është lidhur një kontratë shërbimi (catering) me një subjekt privat.¹

Drejtoria e Policisë së Qarkut

Dhomat e sigurisë:

Në DPQ,Tiranë ka 4 dhoma sigurie, të cilat përdoren për të tre kategoritë e personave të ndaluar apo arrestuar - meshkuj, femra dhe te mitur, *por ato nuk ishin të kategorizuara*².

¹ a) Shkresë "Dërgohet detajimi i buxhetit për vitin 2011", nr.20 prot, dt.07.01.2011

b) Kontratë Furnizimi DPQ, Tiranë – "KPL" shpk, nr.6762/1, dt.03.12.2010

² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Në momentin e inspektimit në këto ambiente kishte dy persona të ndaluar.

Infrastruktura

Nga verifikimi dhe kqyrja e dhomave të sigurisë, rezulton se:

- Kushtet dhe parametrat teknike të tyre, nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në *"Procedurat Standarte të Punës për Departamentin e Sigurisë Publike"*³ dhe *"Manualin për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"*, miratuar, respektivisht me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.

- Dhomat, nuk siguronin ajrim normal dhe ndriçim të mjaftueshëm natyror. Ato kishin përmasa 270 x 130 cm dhe dritare 30 x 60 cm, përmasa të cilat nuk plotësojnë normat dhe parametrat teknikë (jetësorë dhe të sigurisë) që janë: Sip. e përgjithshme për një person jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), siç parashikohet në kreun V pika II, III dhe IV të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Në këto ambiente nuk kishte mjedise tëposaçme ajrimi, siç parashikohet në kreun IV pika VI të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

- Gjithashtu në këto ambiente mungonte një dhomë e veçantë për kryerjen e vizitave mjekësore siç parashikohet në Kreun IV/IV, pika 3, të *Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore*.

- *Kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv dhe nuk kishte nje të posaçme për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike.*

Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht kushteve të këqija të këtyre dhomave, nga punonjësit e kësaj strukture bëhej një punë e mirë për mirëmbajtjen e tyre.

Kushtet e trajtimit

Në lidhje me trajtimin u intervistuan 2 personat e ndaluar, O.M⁴ dhe F.SH⁵ të dy madhorë, të cilët ishin në pritje të caktimit të masës së sigurimit nga gjykata. Të ndaluarit u pyetën në lidhje me trajtimin nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të ndalimit, kushtet e jetesës dhe trajtimin ushqimor dhe shëndetësor.

Gjatë intervistimit të ndaluarit nuk paraqitën ankesa në lidhje me trajtimin e tyre nga punonjësit e policisë.

Të ndaluarit trajtoheshin me ushqim nga struktura përkatëse e policisë.

³ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tiranë

⁴P.Verbal Intervistimi, shtetasi O.M

⁵P.Verbal Intervistimi, shtetasi F.Sh



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Reportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Nga verifikimi i dokumentacionit (fashikullit), rezultoi se kartelat shëndetësore të të ndaluarve ishin plotësuar.

Të ndaluarit u shprehën se deri në momentin e intervistimit, nuk ishin vizituar nga mjeku, pavarësisht se kishin më tepër se 24 orë që ndodheshin aty.

Gjatë verifikimeve të bërë rezultoi se të ndaluarit janë kontaktuar nga nd/mjeku, i strukturës policore, i cili ka plotësuar edhe kartelën.

Grupi i inspektimit, pa dashur të hetojë nëse të ndaluarit janë kontrolluar apo vizituar nga mjeku, kjo edhe për shkak se ata nuk kishin ankesa, tërheq vëmendjen që vizita mjekësore të mos *neglizhohet dhe të kryhet që në momentin e parë të ndalimit apo arrestimit të personit, siç parashikohet në Procedurat Standarte të Punës së Departamentit të Sigurisë Publike", Kap IV/C/1, miratuar me Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.*

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit që mbahej në dhomat e sigurisë⁶, rezultoi se:

- a) Regjistri i personave të ndaluar/arrestuar, përgjithësisht ishte mbajtur në rregull, por,duhet theksuar se formati nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.1).
- b) Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte dhe mbajtur pastër.
- c) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit, përgjithësisht ishte plotësuar në mënyrë korrekte, por duhet theksuar se në të, nuk ishin pasqyruar të gjithë personat pavarësisht nëse kishin patur ose jo sende personale.
- d) Regjistri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë; nuk ishin pasqyruar të gjithë personat.
- e) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- f) Regjistri i pranimi të ushqimit nga familjarët, nuk parashikohet në procedurat standarde, për t'u administruar nga dhomat e sigurisë, por përdorej në rastet kur me rekomandim të mjekut, personi kishte nevojë për trajtim të diferencuar ushqimor.
- g) Në momentin e inspektimit në fashikullin për 2 personat e ndaluar, mungonte formulari i identifikimit me tre fotografi dhe kartela daktiloskopike.
- h) Dosja me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP, u gjet e rregullt.

⁶ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tiranë

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.8 prot, dt. 03.01.2011,

2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.6 prot, dt. 03.01.2011.

3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.16 prot, dt. 03.01.2011.

4. Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.49 prot, dt. 09.03.2011.

5. Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarin nr.9 prot, dt. 03.01.2011

6. Regjistër i pranimi të ushqimit nga familjarët nr.118 prot, dt.30.08.2010

7. Fashikuj për shtetasit O.M dhe F.SH copë 2



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- i) Lista e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë, u gjet e rregullt dhe e afishuar.

Në përfundim, u intervistua k/inspektor **Arben BALLA**⁷ me detyrë përgjegjëse i dhomave të sigurisë. Gjatë intervistës z.Balla konfirmoi problematikën e evidentuar nga grupi i inspektimit, por sipas tij mangësitë e konstatuara vijnë kryesisht nga mungesa e infrastrukturës. Gjithashtu ai vlerësoi si problem mungesën e dhomës për kryerjen e vizitave mjekësore dhe mospatjen e ambienteve të përshtatshme për kryerjen e detyrave.

Dhomat e shoqërimit:

Në DPQ Tiranë ka 2 dhoma për shoqërimin e personave të cilat përdoren për tre kategoritë - meshkuj, femra, dhe të mitur, por ato nuk ishin të kategorizuara⁸.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhomat e shoqërimit të personave kishin hapësirë dhe ajrim normal, si dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Po ashtu, paisjet dhe orenditë e këtyre dhomave ishin në përputhje me Procedurat Standarte të Punës.

*Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"*⁹, pasi mungonin tualetet e veçanta për femrat/meshkujt.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar, i cili ndodhej në Zyrën e Informacionit¹⁰, rezultoi se:

- Format i nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarte të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".

- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftohej vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2), të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua n/komisar **Zylfo VELEDI**¹¹, i cili u shpreh se formulari i shoqërimit plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe pas verifikimit që i bëhej nga punonjësi i zyrës së informacionit ai i kalohej sektorit përkatës.

⁷P.Verbal Intervistimi

⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tiranë

⁹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tiranë

¹⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tiranë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.10, datë 03.01.2011.

¹¹P.Verbal Intervistimi Z.Veledi



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Komisariati i Policisë Nr.1

Dhomat e sigurisë:

Në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tirane, kishte 3 dhoma sigurie prej të cilave në funksionim ishin ¹², *por ato nuk ishin të kategorizuara sipas personave.*

Personat e ndaluar apo të arrestuar femra ose të mitur akomodoheshin në ambientet e DPQ-së.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të ndaluar apo arrestuar.

Infrastruktura

Nga verifikimi dhe kqyrja e dhomave të sigurisë, rezulton se kushtet dhe parametrat e tyre, nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në *"Procedurat Standarte të Punës për Departamentin e Sigurisë Publike"*¹³ dhe *"Manualin për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"*, miratuar, respektivisht me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.

Dhomat, nuk siguronin ajrim normal dhe ndriçim të mjaftueshëm natyror.

Ato kishin përmasa 230 x 200 cm dhe dritare 30 x 60 cm, përmasa të cilat nuk plotësojnë normat dhe parametrat teknikë (jetësorë dhe të sigurisë) që janë: Sip. e përgjithshme për një person jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), siç parashikohet në kreun V pika II, III dhe IV të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Në këto ambiente nuk kishte mjedise të posaçme ajrimi, siç parashikohet në kreun IV pika VI të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Gjithashtu në këto ambiente mungonte një dhomë e veçantë për kryerjen e vizitave mjekësore siç parashikohet në Kreun IV/IV, pika 3, të *Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore.*

Po ashtu, kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpermendura, pasi tualeti ishte kolektiv dhe nuk kishte nyje të posaçme për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike.

Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht kushteve të këqija të këtyre dhomave, nga punonjësit e kësaj strukture bëhej një punë e mirë për mirëmbajtjen e tyre.

¹² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.1 , Tiranë

¹³ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.1, Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Kushtet e trajtimit

Në lidhje me trajtimin ushqimor nga ana e punonjësve u konfirmua fakti se ushqimi vjen me catering në bazë të kontratës së nënshkruar nga DPQ. (Shiko DPQ)

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit të dhomave të sigurisë¹⁴, rezultoi se:

- a) Regjistri i personave të ndaluar/arrestuar:
 - Format i nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarte të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010, (Lidhja Model nr.1) të DPPSH.
 - Ishte i amortizuar pasi kishte një kohë të gjatë përdorimi (dt. 16.08.2007).
 - Mënyra e plotësimit ishte korrekte.
- b) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit:
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin
 - Mënyra e plotësimit ishte korrekte
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë:
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin,
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat
- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- e) Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- f) Libri i kontrollit në dhomat e sigurisë, nuk parashikohet si libër i veçantë nga procedurat standarte, (duhet të jetë në të njëjtin libër me Marrjen dhe Dorëzimin e Shërbimit) për t'u administruar nga dhomat e sigurisë, por ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- g) Fashikuj – nuk kishte persona të ndaluar/arrestuar.
- h) Dosja me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP, u gjet e rregullt
- i) Lista e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë, u gjet e rregullt dhe e afishuar.

Përgjegjësi i dhomave të sigurisë k/inspektor **Dashamir HOXHA** konfirmoi problematikën e evidentuar nga grupi i inspektimit, por sipas tij mangësitë e konstatuara vijnë kryesisht nga mungesa e infrastrukturës. Gjithashtu ai vlerësoi si problem mungesën e dhomës për kryerjen e vizitave mjekësore dhe mospasjen e ambienteve të përshtatshme për kryerjen e detyrave.

¹⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.1, Tiranë.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.41 prot, dt. 16.08.2007,
2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.66 prot, dt. 23.09.2010.
3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.61 prot, dt. 16.08.2010.
4. Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.49 prot, dt. 05.01.2011.
5. Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarin nr.41 prot, dt. 31.03.2008
6. Regjistër i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.44 prot, dt.29.05.2008.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Dhomat e shoqërimit:

Në Komisariatit e Policisë nr.1 kishte 2 dhoma për shoqërimin e personave të cilat përdoreshin për të tre kategoritë - meshkuj, femra, dhe të mitur, por ato nuk ishin të kategorizuara¹⁵.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhomat e shoqërimit të personave kishin hapësirë dhe ajrim normal, si dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Dhomat nuk ishin të pajisura me orenditë e nevojshme siç parashikohet në Procedurat Standarte të Punës .

*Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"*¹⁶, pasi mungonin tualetet e veçanta për femra/meshkuj.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar, i cili ndodhej në Zyrën e Informacionit¹⁷ rezultoi se:

- Formati nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 të DPPSH.

- Kishte mospërputhje të datës së fillimit të regjistrimit me datën e protokollim/ sekretimit respektivisht: regjistri ishte vënë në funksionim më datë 20.07.2010 por ishte protokolluar/ sekretuar më datë 16.09.2010

- Ishte mbajtur keq nga ana fizike.

- Kishte përdorim të kodeve policore në rubrikën "Punonjësi i policisë që ka bërë shoqërimin", në një kohe që sipas procedurave standarte të punës, tek kjo rubrikë duhet të shkruhet emri dhe mbiemri i punonjësit të policisë.

- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

- Kishte korrigjime të shpeshta, të cilat jo vetëm vështirësonin leximin, por në disa raste e bënin shkrimin të palexueshëm.

Gjatë verifikimit rezultoi se, formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, por ai mbahej në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të, gjë që bie në kundërshtim me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike" ku parashikohet: "Në rastet kur punonjësi i policisë i strukturës respektive gjykon se me personin e shoqëruar nuk

¹⁵ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tiranë

¹⁶ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.1 , Tiranë

¹⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.1 , Tiranë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.64, datë 16.09.2010.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

do të kryhen veprime të tjera, bën plotësimet përkatëse në formularin model "SH" duke vepruar si më poshtë :

- "Nëse për personin e shoqëruar ekziston një praktikë e mëparshme, një kopje të formularit ja bashkëngjit kësaj praktike, kurse kopjen tjetër e dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore".

- "Nëse për personin e shoqëruar nuk ekziston praktikë e mëparshme, të dy kopjet e formularit i dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore".

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohet ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrimit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat.

Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua k/inspektor **Besnik QYLALLI**¹⁸, i cili u shpreh se ky formular plotësohet nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe më pas bëhet plotësimi i regjistrimit nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Në lidhje me orën e shoqërimit, e cila shënohet në këto formularë ai u shpreh se, si orë shoqërimi shënohet ora e mbërritjes në komisariat (ora e plotësimit të formularit të shoqërimit).

Komisariati i Policisë Nr.2

Dhomat e sigurisë:

Në Komisaratin e Policisë nr.2, kishte 2 dhoma sigurie¹⁹, prej të cilave 1 ishte në funksionim, dhe shërbente edhe për personat e ndaluar apo arrestuar nga Komisarati i Policisë Nr.6.

Personat e ndaluar /arrestuar femra ose të mitur dërgoheshin në ambientet e DPQ-së.

Në momentin e inspektimit kishte 1 person të ndaluar.

Infrastruktura

Nga verifikimi dhe kqyrja e dhomave të sigurisë, rezulton se kushtet dhe parametrat e tyre, nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në "*Procedurat Standarte të Punës për Departamentin e Sigurisë Publike*" dhe "*Manualin për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore*", miratuar , respektivisht me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.

Dhomat, nuk siguronin ajrim normal dhe ndriçim të mjaftueshëm natyror.

¹⁸P.Verbal Intervistimi B.Qylalli

¹⁹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2, Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Ato kishin përmasa 260 x 260 cm dhe dritare 30 x 60, përmasa të cilat nuk plotësojnë normat dhe parametrat teknikë (jetësorë dhe të sigurisë) që janë: Sip. e përgjithshme për një person jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), siç parashikohet në kreun V pika II, III dhe IV të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"²⁰.

Në këto ambiente nuk kishte mjedise të posaçme ajrimi, siç parashikohet në kreun IV pika VI të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Gjithashtu në këto ambiente mungonte një dhomë e veçantë për kryerjen e vizitave mjekësore siç parashikohet në Kreun IV/IV, pika 3, të *Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore*.

Kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv dhe nuk kishte nyje të posaçme për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike.

Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht kushteve të këqija të këtyre dhomave, nga punonjësit e kësaj strukture bëhej një punë e mirë për mirëmbajtjen e tyre.

Kushtet e trajtimit

Lidhur me trajtimin e të ndaluarit S.S²¹ nga punonjësit e policisë që në momentin e parë dhe gjatë qëndrimit në dhomat e sigurisë, ky i fundit nuk pranoi të jepte intervistë.

Të ndaluarit apo të arrestuarit trajtoheshin me ushqim nga struktura përkatëse e policisë.

Nga verifikimi i bërë rezultoi se *sasia dhe cilësia e ushqimit ishte normale dhe respektohej orari i ngrënies.*

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit të dhomave të sigurisë²², rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar

²⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë

²¹P.Verbal Intervistimi shtetasi S.S

²²Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.79 prot, dt. 23.04.2010,
2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.80 prot, dt. 23.04.2010.
3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.81 prot, dt. 23.04.2010.
4. Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit nr.87/1 prot, dt. 19.11.2010
5. Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.84 prot, dt.23.04.2010.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- Formatimi nuk ishte në përputhje me procedurat Standarde dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010
- Kishte korrigjime dhe përdorim të korrektorit.
- b) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin, ndërsa përsa i përket mënyrës së mbajtjes rezultoi të ishte mbajtur në rregull.
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin, si edhe nuk ishin pasqyruar të gjithë personat
- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit
 - ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- e) Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit i kontrollit në dhomat e sigurisë
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin, por ishte plotësuar në mënyrë korrekte, në vazhdimësi dhe mbajtur pastër.
- f) Në momentin e inspektimit në fashikullin për personain S.S mungonte formulari i identifikimit me tre fotografi dhe kartela daktiloskopike.
- g) Dosje me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP.
 - U gjet e rregullt
- h) Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë.
 - U gjet e rregullt dhe e afishuar.

Në mungesë të përgjegjësit të dhomave të sigurisë, grupi i inspektimit kontaktoi z.Brahasani, i cili ushtronte këtë detyrë në momentin e inspektimit. Ai konfirmoi problematikën e evidentuar, por sipas tij kjo situatë vjen më së shumti nga mungesa e infrastrukturës. Gjithashtu ai vlerësoi si problematikë mungesën e dhomës për kryerjen e vizitave mjekësore dhe mospasjen e ambienteve të përshtatshme për vendosjen e personave me probleme të shëndetit mendor ose nën efektin e alkoolit apo substancave psikotrope.

Dhomat e shoqërimit:

Në Komisaratin e Policisë nr.2, kishte 2 dhoma për shoqërimin e personave²³, prej të cilave njëra ishte zyrë dhe përdorej si dhomë shoqërimi për dy kategori (femra dhe të mitur).

Në momentin e inspektimit kishte 2 persona të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit të personave meshkuj nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal, si dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe nuk ishte e pajisur me orënditë e nevojshme siç parashikohet në Procedurat Standarte të Punës.

²³ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

*Kushtet higjieno sanitare nuk plotësojnë kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"*²⁴.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit²⁵ rezultoi se:

- Formati i regjistrimit nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarde të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2) të DPPSH.
- Kishte përdorim të kodeve policore në rubrikat: "Punonjësi i policisë që ka bërë shoqërimin" dhe "Kush e mori në dorëzim dhe e ndoqi problemin", në një kohë që në këtë rubrikë duhet shënuar emri dhe mbiemri i punonjësit të policisë.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë verifikimit rezultoi se, formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, por ai mbahej në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të, gjë që bie në kundërshtim me *pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike"*.

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrimit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat.

Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua k/inspektor **Arben BRAHASANI**²⁶, i cili u shpreh se ky formular plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe më pas bëhej plotësimi i regjistrimit nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Në lidhje me orën e shoqërimit, e cila shënohet në këto formularë ai u shpreh se, si orë shoqërimi shënohet ora e mbërritjes në komisariat (ora e plotësimit të formularit të shoqërimit).

²⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë

²⁵ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë, Tiranë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.21, datë 14.01.2011.

²⁶P.Verbal Intervistimi A.Brahasani



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar
apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të
Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".
Komisariati i Policisë Nr.3

Dhomat e sigurisë:

Në këtë strukturë kishte 2 dhoma sigurie²⁷, prej të cilave 1 ishte në funksionim. Për sa i përket kategorizimit nuk ishte bërë duke patur parasysh se të ndaluarit/arrestuarit femra ose të mitur akomodohen në ambientet e DPQ-së.

Në momentin e inspektimit kishte 3 persona të ndaluar/arrestuar.

Infrastruktura

Nga verifikimi dhe kqyrja e dhomave të sigurisë, rezulton se kushtet dhe parametrat e tyre, nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në "*Procedurat Standarte të Punës për Departamentin e Sigurisë Publike*" dhe "*Manualin për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore*", miratuar, respektivisht me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.

Dhomat, nuk siguronin ajrim normal dhe ndriçim të mjaftueshëm natyror.

Ato kishin përmasa 350 x 200 cm dhe dritare 30 x 60 cm, përmasa të cilat nuk plotësojnë normat dhe parametrat teknikë (jetësorë dhe të sigurisë) që janë: Sip. e përgjithshme për një person jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), siç parashikohet në kreun V pika II, III dhe IV të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"

Në këto ambiente nuk kishte mjedise të posaçme ajrimi, siç parashikohet në kreun IV pika VI të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Gjithashtu në këto ambiente mungonte një dhomë e veçantë për kryerjen e vizitave mjekësore siç parashikohet në Kreun IV/IV, pika 3, të *Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore*.

*Kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv dhe nuk kishte nyje të posaçme për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike.*²⁸

Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht kushteve të këqija të këtyre dhomave, nga punonjësit e kësaj strukture bëhej një punë e mirë për mirëmbajtjen e tyre.

Kushtet e trajtimit

Në momentin e inspektimit në dhomën e sigurisë ndodheshin 3 persona:

- E.L i arrestuar (i dënuar me vendim të formës së prerë)
- L.S - i ndaluar, përdorues i lëndëve narkotike

²⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.3, Tiranë

²⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.3 , Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- E.H - i arrestuar në flagrancë, me probleme shëndetësore.

Grupi i inspektimit intervistoi dy prej personave të lartpërmendur dhe konkretisht personat E.L dhe E.H, ndërsa L.S nuk pranoi të intervistohej:

- Gjatë intervistës dhe kontrollit të dokumentacionit në lidhje me të arrestuarin (i dënuar me vendim të formës së prerë) E.L²⁹, rezulton se ky person është shoqëruar nga strukturat e Policisë Kukës më dt.29.03.2011 ora 22.30 dhe është vendosur në dhomat e sigurisë së Komisarariatit të Policisë nr.3, Tiranë. Në momentin e inspektimit dt. 01.04.2010 ora 11.00 i arrestuari ndodhej akoma në ambientet e Kom.Pol Nr.3, Tiranë.

Meqënëse personi i lartpërmendur është arrestuar në zbatim të një vendim dënimi, me vendim të formës së prerë, duhej transferuar në IEVP, siç parashikohet në Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Manual për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore", Kreu 1 pika VIII/2.

- Gjatë verifikimit të dokumentacionit në lidhje me të arrestuarin në flagrancë E.H³⁰, rezulton se ky person është shoqëruar në komisarariat, më datë 31.03.2011 ora 21.30, pas një aksidenti me makinë, por meqënëse gjatë intervistimit ai ka goditur punonjësin e policisë (intervistuesin), për këtë arsye, është arrestuar në flagrancë, po këtë datë ora 22.00, për veprën penale të "Goditje për shkak të detyrës".

Gjatë kqyrjes së të arrestuarit në flagrancë ashtu siç pohon edhe gjatë intervistimit ³¹, rezulton se ai është dëmtuar në këmbë nga aksidenti me makinë.

Gjatë intervistës i arrestuari pretendon se pas mbërritjes në Kom.Pol. Nr.3, ndaj tij është ushtruar dhunë verbale dhe fizike nga ana e shefit të komisarariatit.

Përveç sa sipër i arrestuari E.H pretendon se pavarësisht kërkesës së tij për vizitë mjekësore, duke qënë se kishte dëmtime në këmbë (nga aksidenti), dhe në pjesën e prapme të kokës (sipas pretendimeve nga dhuna e ushtruar), ato nuk ishin marrë parasysh.

Në lidhje me pretendimet e të arrestuarit E.H nga ana jonë u bënë verifikimet përkatëse dhe konkretisht:

U verifikua formulari "SH", i cili plotësohet në momentin e parë të shoqërimit të personit në komisarariat. Ky formular ishte i plotësuar dhe në faqen 3 të tij në rubrikën "Shpjegues", figuron se E.H është shoqëruar në Kom.Pol.nr.3, për shkak të përplasjes me makinë dhe kundërshtimit të për të kryer testin e alkoolit të kërkuar nga policia rrugore.

Në rubrikën "Kushtet e të ndaluarit/arrestuarit në momentin e ndalimit" figuron se E.H ka dëmtime të lehta në kokë dhe se në pamje të parë duket në gjendje të dehur.

U pyetën dy personat e tjerë E.L dhe L.S, të cilët kanë qëndruar në një dhomë me të arrestuarin E.H. Në shpjegimet e tyre nuk rezulton se ndaj E.H të jetë përdorur dhunë. Të lartpërmendurit shpjegojnë se E.H pothuajse gjatë gjithë kohës ka qënë në gjendje gjumi.

²⁹P.Verbal Intervistimi shtetasi E.L

³⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.3, Tiranë

³¹P.Verbal Intervistimishtetasi E.H



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

U pyetën punonjësit e policisë të dhomave të sigurisë, ku gjatë shpjegimit të tyre nuk rezulton që E.H. të jetë keqtrajtuar, por dëmtimet e tij kanë qenë prezente që në momentin e parë të shoqërimit.

Në bazë të verifikimeve të bëra nuk rezulton që ndaj të arrestuarit E.H të jetë ushtruar dhunë nga punonjësit e policisë.

Personi i arrestuar L.S, nuk pranoi të intervistohet dhe nuk paraqiti ndonjë ankesë lidhur me trajtimin e tij.

Lidhur me trajtimin ushqimor të të ndaluarve ose arrestuarve, ai bëhej nga ana e strukturës përkatëse të policisë, fakt ky që u konfirmua edhe nga të ndaluarit/arrestuarit.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit të dhomave të sigurisë³², rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Format i nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010,
 - Ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- b) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit.
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin,
 - Ishte plotësuar në rregull.
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin,
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat e ndaluar apo të arrestuar.
- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- e) Regjistri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit i kontrollit në dhomat e sigurisë.
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin
 - Ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- f) Në momentin e inspektimit në fashikullin për të tre personat, mungonte formulari i identifikimit me tre fotografi dhe kartela daktiloskopike, ndërsa për personin E.H mungonte edhe kartela shëndetësore.
- g) Dosja me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP, u gjet e rregullt
- i) Lista e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë, u gjet e rregullt dhe e afishuar.

³² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.3 , Tiranë.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.58 prot, dt. 28.01.2011,

2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.56 prot, dt.28.01.2011.

3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.100 prot, dt. 23.11.2006.

4.Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit nr.57 prot, dt. 28.01.2011

5.Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.121 prot, dt.06.07.2010.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë strukturë kishte 1 dhomë për shoqërimin e personave³³. Gjithashtu jashtë ambienteve të sigurisë kishte edhe një dhomë shoqërimi për personat që pritet të kalojnë në dhomat e sigurisë.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit të personave meshkuj nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal, si dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe nuk ishte e pajisur me orenditë e nevojshme siç parashikohet në Procedurat Standarte të Punës.

Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"³⁴.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit³⁵ rezultoi se:

- Formati i regjistrit nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarde të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2) të DPPSH.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë verifikimit rezultoi se, formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, por ai mbahej në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të, gjë që bie në kundërshtim me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat.

Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

³³ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.3, Tiranë

³⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë

³⁵ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.3, Tiranë, Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.55, datë 28.01.2011.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua k/inspektor **Shpëtim HYSENI**³⁶, i cili u shpreh se ky formular plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe më pas bëhej plotësimi i regjistrit nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Në lidhje me orën e shoqërimit, e cila shënohet në këto formularë ai u shpreh se, si orë shoqërimi shënohet ora e mbërritjes në komisariat (ora e plotësimit të formularit të shoqërimit).

Komisariati i Policisë Nr.4

Dhomat e sigurisë:

Në këtë strukturë kishte 1 dhomë sigurie³⁷.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të ndaluar.

Infrastruktura

Nga verifikimi dhe kqyrja e dhomës së sigurisë, rezulton se kushtet dhe parametrat e saj, nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në "*Procedurat Standarte të Punës për Departamentin e Sigurisë Publike*" dhe "*Manualin për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndalarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore*", miratuar, respektivisht me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH. Dhoma, nuk siguronte ajrim normal dhe ndriçim të mjaftueshëm natyror.

Dhoma e sigurisë kishte përmasa 350 x 300 cm dhe dritare 120 x 60 cm e cila ishte e mbuluar me një fletë llamarine me vrima, e cila e izolonte dritaren në 90% të sipërfaqes. Këto përmasa nuk plotësojnë normat dhe parametrat teknikë (jetësorë dhe të sigurisë) të parashikuara në Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 që janë: Sip. e përgjithshme për një person jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), siç parashikohet në kreun V pika II, III dhe IV të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndalarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"

Në këto ambiente nuk kishte mjedise të posaçme ajrimi, siç parashikohet në kreun IV pika VI të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndalarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Gjithashtu në këto ambiente mungonte një dhomë e veçantë për kryerjen e vizitave mjekësore siç parashikohet në Kreun IV/IV, pika 3, të *Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndalarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore*.

Kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv dhe nuk kishte nyje të posaçme për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë

³⁶P.Verbal Intervistimi Sh.Hyseni

³⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.4, Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike³⁸.

Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht kushteve të këqija të këtyre dhomave, nga punonjësit e kësaj strukture bëhej një punë e mirë për mirëmbajtjen e tyre.

Kushtet e trajtimit

Në lidhje me trajtimin ushqimor nga ana e punonjësve u konfirmua fakti se të ndaluarit apo të arrestuarit trajtoheshin me ushqim nga struktura përkatëse e policisë.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit të dhomave të sigurisë³⁹, rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarde dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010,
 - Mënyra e plotësimit ishte korrekte.
- b) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit.
 - Ishte mbajtur në mënyrë korrekte.
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin, si edhe nuk ishin pasqyruar të gjithë personat
- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin
 - Ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- e) Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit i kontrollit në dhomat e sigurisë
 - Ishin mbajtur dy regjistra të veçantë, të cilët kishin mospërputhje të formatit me objektin,
 - Ishin plotësuar në mënyrë korrekte, në vazhdimësi dhe mbajtur pastër.
- f) Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të ndaluar.
- g) Dosje me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP. U gjet e rregullt

³⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.4 , Tiranë

³⁹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.4, Tiranë.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.11 prot, dt. 03.01.2011,
2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr. 09 prot, dt. 03.01.2011.
3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.08 prot, dt. 03.01.2011.
- 4.Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuaritnr. 7 prot, dt. 03.01.2011
- 5.Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.05 prot, dt.03.01.2011
6. Regjistër i i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.12 prot, dt.03.01.2011.
7. Regjistër i lëvizjes së të ndaluarve në Gjykatë nr.6 prot, dt.03.01.2011



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

h) Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.

Gjatë intervistës së tij përgjegjësi i dhomave të sigurisë n/komisar **Fetah DYRMISHI**, u shpreh se mangësitë e konsatuara vijnë më së shumti nga mungesa e infrastrukturës. Gjithashtu ai vlerësoi si problematikë mungesën e dhomës për kryerjen e vizitave mjekësore dhe mospasjen e ambienteve të përshtatshme për vendosjen e personave me probleme të shëndetit mendor ose nën efektin e alkoolit apo substancave psikotrope.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë strukturë kishte 1 dhomë për shoqërimin e personave⁴⁰.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal, si dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe nuk ishte e pajisur me orënditë e nevojshme siç parashikohet në Procedurat Standarte të Punës.

Kushtet higjeno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"⁴¹.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit⁴² rezultoi se:

- Formati nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarde të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë verifikimit rezultoi se, formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, por ai mbahej në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të.

U intervistua k/inspektor **Agron MEMA**⁴³, i cili u shpreh se ky formular plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe më pas bëhej plotësimi i regjistrin nga punonjësi i zyrës së informacionit.

⁴⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.4 , Tiranë

⁴¹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.4 , Tiranë

⁴² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë, Tiranë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.13, datë 03.01.2011.

⁴³P.Verbal Intervistimi A.Mema



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Në lidhje me orën e shoqërimit, e cila shënohet në këto formularë ai u shpreh se, si orë shoqërimi shënohet ora e mbërritjes në komisariat (ora e plotësimit të formularit të shoqërimit).

Kjo mënyrë veprimi bie në kundërshtim me *pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike"*.

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të rregjistrat ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat. Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

Komisariati i Policisë Nr.5

Dhomat e sigurisë:

Në këtë komisariat kishte 3 dhoma sigurie⁴⁴.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të ndaluar apo të arrestuar.

Infrastruktura

Secila prej dhomave të sigurisë kishte përmasa 265 x 186 cm dhe dritare 30 x 70 cm.

Duke qënë se këto janë ambiente të reja në përgjithësi gjendja e tyre ishte e mirë, por megjithatë nuk sigurohej ajrim dhe ndriçim i mjaftueshëm natyror, si edhe nuk kishte ambiente dhe nuk bëhej ajrimi i personave sipas Kreut IV paragrafi VI i Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Kushtet higjeno sanitare plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. Të Sig. Publike".⁴⁵, por mungonte nyja për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun VI/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike"

Kushtet e trajtimit

Në lidhje me trajtimin ushqimor nga ana e punonjësve u konfirmua fakti se ushqimi vjen me catering në bazë të kontratës së nënshkruar nga DPQ.

⁴⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.5, Tiranë

⁴⁵ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.5, Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit i cili mbahej në dhomat e sigurisë⁴⁶, rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010, ndërsa përsa i përket mënyrës së mbajtjes rezultoi të ishte korrekt.
- b) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit.
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin por ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë.
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin, si edhe nuk ishin pasqyruar të gjithë personat
- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit.
 - Ishin mbajtur dy regjistra të veçantë, të cilët kishin mospërputhje të formatit me objektin, por ishin plotësuar në mënyrë korrekte, në vazhdimësi dhe mbajtur pastër.
- e) Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit i kontrollit në dhomat e sigurisë.
 - Ishin mbajtur dy regjistra të veçantë, të cilët kishin mospërputhje të formatit me objektin, por ishin plotësuar në mënyrë korrekte, në vazhdimësi dhe mbajtur pastër.
- f) Dosje me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP. U gjet e rregullt
- h) Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.

Në mungesë të përgjegjës të dhomave të sigurisë, i cili ishte me raport shëndetësor grupi i inspektimit u shoqërua nga K/inspektor Lutfi Muça, i cili ushtronte këtë detyrë në momentin e inspektimit.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë strukturë kishte 2 dhoma për shoqërimin e personave⁴⁷.

Në momentin e inspektimit kishte 2 persona të shoqëruar.

Infrastruktura

- Dhoma e shoqërimit nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal, si dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

⁴⁶Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.5, Tiranë.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.14 prot, dt. 14.01.2011,
2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr. 19 prot, dt. 04.01.2011.
3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.25 prot, dt. 04.01.2011.
- 4.Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ nr.24 prot, dt. 04.01.2011
5. Regjistri i takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuaritnr.22 prot, dt. 04.01.2011
- 6.Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.13 prot, dt.04.01.2011
7. Regjistër i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.21 prot, dt.04.01.2011.
8. Libër I pranimit të ushqimit nr.20 prot, dt.04.01.2011

⁴⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.5, Tiranë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- Dhoma nuk ishte e pajisur me orëditë e nevojshme siç parashikohet në Procedurat Standarte të Punës.
- Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"⁴⁸.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit⁴⁹ rezultoi se:

- *Formati i regjistrimit nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarte të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2) të DPPSH.*
- *Kishte përdorim të kodeve policore në rubrikat: "Punonjësi i policisë që ka bërë shoqërimin" dhe "Kush e mori në dorëzim dhe e ndoqi problemin", në një kohë që në këtë rubrikë duhet shënuar emri dhe mbiemri i punonjësit të policisë.*
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë verifikimit rezultoi se, formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej pjesërisht nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe pjesërisht nga punonjësi i informacionit në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të.

U intervistua k/inspektor Lutfi MUÇA⁵⁰, i cili u shpreh se ky formular plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe më pas bëhej plotësimi i regjistrimit nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Në lidhje me orën e shoqërimit, e cila shënohet në këto formularë ai u shpreh se, si orë shoqërimi shënohet ora e mbërritjes në komisarjat (ora e plotësimit të formularit të shoqërimit).

Administrimi në këtë mënyrë i formularit "SH", nuk është korrekte, pasi ky formular duhet të mbahej në dy kopje, dhe administrimi duhej bërë sic është parashikuar në pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike".

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisarjat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrimit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret

⁴⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.5, Tiranë

⁴⁹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.5, Tiranë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.29, datë 04.01.2011.

⁵⁰ P.Verbal Intervistimi L.Muç



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat. Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë)

Komisariati i Policisë Nr.6

Ky komisariat nuk ka dhoma sigurie. Të gjithë personat e ndaluar/arrestuar nga kjo strukturë dergoheshin në ambientet e sigurisë së komisariatit të policisë nr.2 Tiranë.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë strukturë kishte 1 dhomë për shoqërimin e personave⁵¹.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit kishte përmasa 200 x 300 cm me dritare 15x15 cm dhe ndodhej në ambientet e jashtme duke qënë se infrastruktura e këtij komisariati është tejet e amortizuar dhe e papërshtatshme për të qenë e tillë.

Asnjë parametër i dhomës së shoqërimit të personave nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009.

Ambiente higjieno - sanitare nuk kishte.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit⁵² rezultoi se:

- Formati nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë verifikimit rezultoi se, formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, por ai mbahej në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të, gjë që bie në kundërshtim me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të

⁵¹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.6, Tiranë

⁵² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.2 , Tiranë, Tiranë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.20, datë 10.01.2011.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat.

Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua k/inspektor **Naim ILJAZI**⁵³, i cili u shpreh se ky formular plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimit dhe më pas bëhej plotësimi i regjistrit nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Në lidhje me orën e shoqërimit, e cila shënohet në këto formularë ai u shpreh se, si orë shoqërimi shënohet ora e mbërritjes në komisariat (ora e plotësimit të formularit të shoqërimit).

Komisariati i Policisë Kavajë

Dhomat e sigurisë:

Në këtë komisariat kishte 3 dhoma sigurie⁵⁴.

Në momentin e inspektimit në këto dhoma kishte 2 persona të ndaluar.

Infrastruktura

Secila prej dhomave të sigurisë kishte paradhomë ku ishin të vendosura paisjet hidro-sanitare dhe kishte përmasa 290 x 145 cm ndërsa ambienti i qëndrimit kishte përmasa 290 x 270 cm dhe dritare 145 x 90 cm, parametra të cilët garantojnë ajrim dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm, si edhe kishin paisjet e ËC siç parashikohet në Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"

Si problematikë u vërejt mungesa e shtretërve të cilët ishin zëvendësuar nga dyshekë të vendosur direkt në dysheme.

Gjithashtu nuk ishte bërë kategorizimi dhe dhoma e mjekut ishte e pa pajisur.

Kushtet higjeno sanitare plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".⁵⁵, por mungonte nyja për larjen e trupit, e cila ishte si ambient, por nuk ishte vënë në funksionim, siç parashikohet në Kreun VI/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike"

⁵³ P. Verbal Intervistimi N. Iljazi

⁵⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Kavajë

⁵⁵ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Kavajë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Kushtet e trajtimit

Në lidhje me trajtimin ushqimor nga ana e punonjësve u konfirmua fakti se ushqimi vjen me catering në bazë të kontratës së nënshkruar nga komisariati me një subjekt privat duke qënë se kjo strukturë është njësi finanaciare më vete⁵⁶.

Në lidhje me trajtimin u intervistuan personat E.M⁵⁷ dhe E.D⁵⁸ të dy madhorë. Personat u pyetën në lidhje me trajtimin nga ana e punonjësve të policisë në momentin e parë, kushtet e jetesës dhe trajtimin ushqimor dhe shëndetësor. Gjatë intervistimit personat nuk paraqitën rezervë apo ankesa në lidhje me trajtimin nga punonjësit e policisë apo trajtimin ushqimor, por ata u shprehën se deri në momentin e intervistimit nuk ishin vizituar nga mjeku.

Nga verifikimi i dokumentacionit (fashikujve) rezultoi se mungonte kartela shëndetësore dhe formulari i identifikimit me tre fotografi dhe kartela daktiloskopike.

Nga verifikimi i bërë rezultoi se sasia dhe cilësia e ushqimit ishte normale dhe respektohej orari i ngrënies.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit i cili mbahej në dhomat e sigurisë⁵⁹, rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar.
 - Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010, ndërsa për sa i përket mënyrës së mbajtjes rezultoi të ishte korrekt.
- b) - Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin por ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë.
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin, si edhe nuk ishin pasqyruar të gjithë personat

⁵⁶ Shkresë "Mbi dërgimin e detajimit të buxhetit për vitin 2011", nr.1320 prot, dt.26.11.2010 DPPSH, Pasqyrë e Detajimit të buxhetit, Kom.Pol Kavajë, rubrika 6021, zëri "Furnizime dhe shërbime me ushqim për mencat"

⁵⁷P.Verbal Intervistimi, shtetasi E.M

⁵⁸P.Verbal Intervistimi, shtetasi E.D

⁵⁹Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Kavajë.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.16/1 prot, dt. 03.01.2011,
2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr. 179 prot, dt. 30.09.2010.
3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.163/1 prot, dt. 30.07.2010.
- 4.Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhei takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuaritnr.8 prot, dt. 03.01.2011
5. Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.136 prot, dt.21.02.2011
6. Regjistër i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.178 prot, dt.30.09.2010.
7. Libër I pranimit të ushqimit nr.20 prot, dt.04.01.2011



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit ishte plotësuar në mënyrë korrekte, në vazhdimësi dhe mbajtur pastër.
- e) Regjistër i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit i kontrollit në dhomat e sigurisë
 - ishin mbajtur dy regjistra të veçantë, të cilët kishin mospërputhje të formatit me objektin, por ishin plotësuar në mënyrë korrekte, në vazhdimësi dhe mbajtur pastër.
- f) Dosje me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP. U gjet e rregullt
- g) Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë strukturë kishte 3 dhoma për shoqërimin e personave⁶⁰.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhomat e shoqërimit të personave në përgjithësi ishin në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, duke qënë se janë ambiente të reja. Këto dhoma kishin ndriçim dhe ajrim natyral të mjaftueshëm, por si problematikë paraqitet mobilimi i tyre duke qënë se ishin bosh, pa paisjet përkatëse siç parashikohet në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".

Kushtet higjeno sanitare plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"⁶¹.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit⁶²rezultoi se:

- Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë verifikimit rezultoi se, formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, por ai mbahej në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të, gjë që bie në kundërshtim me pikën D/5 të

⁶⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Kavajë

⁶¹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Kavajë

⁶² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Kavajë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.189, datë 31.12.2009.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat.

Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua k/inspektor **Dëfrim BAKU**⁶³, i cili u shpreh se ky formular plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe më pas bëhej plotësimi i regjistrit nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Në lidhje me orën e shoqërimit, e cila shënohet në këto formularë ai u shpreh se, si orë shoqërimi shënohet ora e mbërritjes në komisariat (ora e plotësimit të formularit të shoqërimit).

Për të vërtetuar faktet u bë verifikimi në sekretarinë e komisariatit ku rezultoi se formularët e shoqërimit nuk administroheshin nga kjo zyrë⁶⁴.

KONKLUZIONE

1. Ambientet e strukturave të DPQ Tirane, me përjashtim të Komisarariatit të Policisë nr.5 dhe Komisarariatit të Policisë Kavajë, nuk përmbushnin asnjë nga kushtet dhe kriteret për dhomat e sigurisë të parashikuar në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike" dhe Urdhër nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".
2. Në të gjitha strukturat mungonte nyja për larjen e trupit, siç parashikohet në Kreun VI/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".
3. Në fashikullin e personave të ndaluar/arrestuar (për ato struktura ku u gjetën persona të kësaj kategorie DPQ, Komisaritati i Policisë Nr.2, 3 dhe Kavajë), mungonte formulari i identifikimit me tre fotografi dhe kartela daktiloskopike.

⁶³P.Verbal Intervistimi D.Baku

⁶⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Kavajë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

4. Staf i mjekësor i DPQ-së nuk kryente vizitën mjekësore dhe regjistrimin e të gjithë personave të ndaluar/arrestuar në regjistrin e vizitave mjekësore në dhomat e sigurisë, brenda 24 orëve të para, siç parashikohet në Kreun VI/B, pika 5/d, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".
5. Regjistrat e personave të ndaluar apo arrestuar në të gjitha strukturat nuk ishin në përputhje me Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike" dhe Urdhrit nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", ndërsa regjistrat e tjerë në pjesën më të madhe ishin të përshtatur nga vetë punonjësit.
6. Në regjistrin e vizitave mjekësore dhe atë të sendeve personale nuk shënoheshin të gjithë personat.
7. Në komisaratin e Policisë nr.3 në një dhomë ndodheshin tre persona respektivisht; 1 me vendim të formës së prerë, 1 përdorues i lëndëve narkotike, 1 me probleme shëndetësore (nga një aksident i ndodhur). Ky i fundit paraqiti edhe pretendime për ushtrim dhune nga shefi i komisarimit në momentin e arrestimit.
8. Në komisaratin e policisë nr.6 nuk ka dhoma sigurie.
9. Në komisaratin nr.4, dhomat e sigurisë ndodhen në ambient nëntokësor.
10. Në komisaratin e Kavajës mungojnë shtretërit.
11. Infrastruktura e dhomave të shoqërimit në të gjitha strukturat nuk ishte në përputhje me kushtet e kriteret e përcaktuara në Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".
12. Regjistrat e personave të shoqëruar nuk ishin në përputhje me Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike" dhe Urdhrit nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
13. Në pjesën më të madhe të strukturave gjatë plotësimit të regjistrave të shoqërimit në rubrikat ku kërkohet emri i punonjësit që ka bërë shoqërimin, përdorshin kode policore, dhe në rubrikën arsyeja e shoqërimit u vërejt shpesh termi "verifikim", duke mos pasqyruar saktë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".
arsyen e shoqërimit, si edhe afate të gjata për kryerjen e veprimeve në këto raste.

14. Mënyra e plotësimit dhe administrimit të formularëve të shoqërimit nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".

DREJTORIA E POLICISE SE QARKUT DURRËS

D.P.Q.Durrës, është e strukturuar në 3 komisariate dhe 1 stacion policie.

Komisariati i Policisë Durrës.

Komisariati i Policisë Krujë.

Komisariati i Policisë Shijak.

Stacionit i Policise Fushe-Krujë.

Grupi i inspektimit fillimisht kontaktoi me Drejtorin e Policisë së Qarkut **Z.Aleks HAJDARI**, i cili bëri prezent situatën aktuale në dhomat e shoqërimit e ato të sigurisë të kësaj drejtorie.

Z. Hajdari sqaroi se dhoma shoqërimi ekzistonin në të gjithë komisaritet e Qarkut, kurse dhoma sigurie kishte vetëm në Komisaritin e policisë Durrës e Krujë.

Theksi u vu në faktin se kushtet në dhomat e sigurisë, megjithë masat e marra, ishte akoma larg standarteve të kërkuara.

Ndërsa dhomat e shoqërimit janë brenda kushteve normale. Në Kom.Pol.Durrës, dhomat e shoqërimit janë të rikonstruara dhe brenda standarteve⁶⁵. Një situatë e tillë është edhe në të gjithë komisaritet e tjera të këtij Qarku.

Në mënyrë periodike nga Drejtuesit e Policisë në Qark ushtrohet kontroll në dhomat e sigurisë në Komisaritet e Policisë ku ato ekzistojnë.

Në D.P.Q.Durrës trajtimi me ushqim i personave të ndaluar e arrestuar bëhet nga vete struktura përkatëse e policisë në përputhje me normën ushqimore të përcaktuar nga D.P.P.Shtetit. Kjo normë ushqimore ishte e ekspozuar në ambientet e dhomave të sigurisë. Nëçdo rast bëheshin blerjet sipas normës ditore në përputhje me nr. e personave që ishin në dhomat e ndalimit e arrestimit. Trajtimi Ushqimor përcaktohet zë më vete në buxhetin vjetor me të njëjtin emërtim (trajtim ushqimor për dhomat e sigurisë) dhe jepej në përputhje me rregullat që përcakton Kreu IV paragrafi i II i Urdhërit Nr 64 datë 25.01.2010 të D.P.P.Shtetit.

Nuk ka patur asnjë ankesë të ndonjë personi të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar për keqtrajtim fizik nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit në ambientet e sigurisë në D.P.Q.Durrës. Ky fakt u konfirmua si nga Drejtori i Policisë së Qarkut Durrës por dhe Strukturat e SH.K.B. në Qark që ishin në grupin e inspektimit.

⁶⁵Fotografi te dhomave te shoqerimit Kom.Pol.Durres.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar
apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të
Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".
Komisariati i Policisë Durrës.

Grupi i inspektimit kontaktoi me Shefin e Rendit e Sigurisë Publike në Kom.Pol.Durrës **Komisar Karafil XHOLI**.⁶⁶

Në intervistën e tij Z.Xholi bëri një panoramë të kushteve ekzistuese të dhomave të shoqërimit dhe ato të sigurisë.

Sipas Z. Xholi, kushtet e dhomave të sigurisë nuk janë në parametrat e duhur megjithë përpjekjet që janë bërë nga strukturat e policisë për të përmirësuar kushtet në këto dhoma.

Dhomat e sigurisë:

Në Komisariatin e policisë Durrës, ka 8 dhoma sigurie.

Nga kqyrja e këtyre dhomave konstatohet se nuk plotësojnë standartet e kërkuara si nga hapesira ashtu dhe nga infrastruktura dhe pajisjet.

Konstatohet se përmasat e dhomave të sigurisë në Komisariatin e Policisë Durrës janë, respektivisht: 2 dhoma me nga 8 m² dhe 6 dhoma me nga 6 m².

Kjo hapësirë, nuk plotëson kushtet që parashikohen në Urdhërin Nr 64 datë 25.01.2010 "Për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore", Kreu V pika II/1 dhe pika II/2, ku përcaktohet se normat dhe parametrat teknike të dhomave për një person të arrestuar apo ndaluar janë " Sip. e përgjithshme jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), me një lartësi jo më pak se 2.5 metra.

Në këtë ambiente nuk kishte mjedise të posaçme ajrimi, siç parashikohet në kreun IV pika VI të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Gjithashtu në këto ambiente mungon paradhoma sipas përcaktimit të Kreut V pika III, të urdhërit të sipërpërmendur.

Ambienti i qëndrimit brenda dhomave të sigurisë përbëhej vetëm nga një krevat hekuri.

Po ashtu, në këto ambiente, mungojnë të gjitha pajisjet e përcaktuara në kreun V, paragrafi III pika 2.

Trajtimi me Ushqim i personave në dhomat e Sigurisë bëhet nga vetë institucioni sipas normës së ushqimit të miratuar në Buxhetin e D.P.Qarkut Durrës, si fond i këtij Komisarati në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kreun IV paragrafi II i Urdhërit Nr 64 datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Duhet theksuar se në ambientet e dhomave të sigurisë ishin të afishuara në gjuhën shqipe dhe angleze të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar e arrestuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit që disponon përgjegjësi i dhomave të sigurisë, rezultoi se :

⁶⁶Proces verbal intervistimi



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- Regjistri i të arrestuarve në dhomat e sigurisë ishte sipas modelit të miratuar me urdhër të D.P.P Shtetit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të policisë së shtetit", (Lidhja Model nr 1) dhe Udhrorit nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike".

- Ekzistonte lista e personelit të shërbimit dhe atë ndihmës, që kanë të drejtë të futen në këto ambiente, miratuar nga Shefi i Komisarariatit.

- Po kështu ekzistonin Regjistri për takimin e të ndaluareve e arrestuarve me avokatin, me prokurorin, ai i vizitave mjeksore, regjistri i sendeve personale.

- Të gjithë këto regjistra ishin plotësuar e mbaheshin konform udhëzimit të lartpërmendur. Në vijim ato u fotokopjuan dhe u administruan me cilësinë e dokumentit bashkelidhur raportit.

Dhomat e shoqërimit:

Nga kqyrja e dhomave të shoqërimit në të gjithë komisarariatet e policisë së DPQ Durrës, rezulton se ato plotësojnë kushtet sipas përcaktimeve në pikën B paragrafi i I i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit që dispononte Zyra e Informacionit të D.P.Q Durrës, rezulton se:

- Në regjistrin për shtetasit e shoqëruar ishin të pasqyruara të gjithë rubrikat sipas procedurës standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike miratuar me Udhrin nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike", si dhe Urdhrit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit"

- Plotësimi i rubrikave të rregjistrit ishte korrekt.

- Gjatë verifikimit të këtij rregjistri, u konstatua se kishte filluar të praktikohej formulari "SH", që duhet të plotësohet nga personi që kryen shoqërimin. Ky formular mbahej në dy kopje dhe dorëzohej punonjësit të policisë të shërbimit të informacionit në sallën e drejtimit dhe të koordinimit, sic është parashikuar në procedurat standarte të punës.

- Konstatohet se është plotësuar rekomandimi i dhënë nga inspektimi i muajit tetor 2010, lidhur me Regjistrin e Shoqërimit të Personave dhe për Formularin "SH". U administrua kopje e njësuar e këtij regjistri për t'iu bashkelidhur raportit.

Komisariati i Policisë Shijak

Dhomat e shoqërimit:

Fillimisht, grupi i inspektimit mori kontakt me shefin e Komisarariatit K/Komisar Agron SULSHABANI.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Z. Sulshabani, shpjegoi dinamikën e punës që përballon ky komisarariat, duke vënë theksin në mungesën e mjeteve teknike dhe logjistike për rritjen e imazhit dhe performancës së kësaj strukture policore.

Në këtë komisarariat ekzistonin dy dhoma shoqërimi, të cilat përdoreshin për shoqërimin e personave të rritur meshkuj dhe personave të rritur femra.⁶⁷

Nga kqyrja e këtyre dhomave konstatohet se:

Pajisjet ishin në përputhje me standartet e kërkuara.

Mungon ambienti për shoqërimin e personave të mitur.

Mungonte paradhoma dhe tualeti brenda ambienteve të këtyre dhomave.

Këto mangësi bien ndesh me pikën C paragrafi i II i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit.

Gjatë kqyrjes së dokumentacionit që disponon zyra e informacionit të komisarariatit rezulton se:

Nga kqyrja e regjistrimit të shoqërimin të personave rezulton se formati i tij ishte konform standarteve të kërkuara. Kjo në zbatim të rekomandimit të dhënë nga Grupi i Inspektimit në Raportin e muajit Tetor 2010 (Regjistri ishte zëvendësuar).

Gjatë verifikimit u konstatua se ishte futur si praktikë pune, formulari "SH" në zbatim të rekomandimit të lënë nga inspektimi i kaluar.

Në këtë komisarariat nuk kishte dhoma sigurie, dhe personat e ndaluar apo të arrestuar dergoheshin në ambientet e dhomave të sigurisë të D.P.Q Durrës.

Komisariati i Policisë Krujë

Dhomat e sigurisë:

Në Komisariatin e Policisë Krujë ekzistojnë 19 dhoma sigurie, por vetëm 6 prej tyre janë në funksion.

Nga kqyrja e dhomave të sigurisë rezultoi se:

- Konstatohet se kushtet e ambienteve të dhomave të sigurisë nuk janë brenda standarteve të kërkuara.

Duhet theksuar se në krahasim me kushtet e konstatuara gjatë inspektimit të kaluar (viti 2010) ka një farë përmirësimi, si p.sh. krijimi i korridorit të sigurisë, pajisja e dhomave me krevat druri, lysterja e dhomave etj.

Nga kqyrja e rregjistrave që disponohen lidhur me Dhomat e Sigurisë, rezulton se janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kreun VIII paragrafi I i Urdhërit Nr 64 datë 25.01.2010 të D.P.Policisë së Shtetit.

⁶⁷Fotografi të dhomave të shoqërimin Kom.Pol.Shijak



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Rregjistri i ndalimit dhe arrestimit të personave, Rregjistri i dorëzimit të Sendeve Personale, Rregjistri i Pyetjes së të Ndaluarve apo Arrestuarve, Rregjistri i Vizitave Mjekësore, Rregjistri i Takimit me Avokatin, Rregjistri i Kontrollit të Dhomave të Paraburgimit, ekzistojnë, plotësohen dhe administrohen sipas Urdhrit të D.P.P Shtetit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".

Trajtimi me Ushqim i personave në dhomat e Sigurisë bëhet nga vete inmtitucioni sipas normës së ushqimit të miratuar në Buxhetin e D.P.Qarkut Durrës, si fond i këtij Komisariati në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kreun IV paragrafi II i Urdhërit Nr 64 datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Duhet theksuar se në ambientet e dhomave të sigurisë ishin të afishuara në gjuhen shqipe dhe angleze të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar e arrestuar.

Dhomat e shoqërimit:

Grupi i Inspektimit në fillim mori kontakt dhe intervistoi Shefin e Seksionit të Rendit e Sigurisë Publike Komisar Agron BRAHJA, i cili bëri të ditur dinamikën e punës në këtë Komisariat.⁶⁸

Në këtë komisariat, ekzistonin dy dhoma për shoqërimin e personave - një për të mitur dhe një për femra.

Nuk kishte dhomë shoqërimi për të rritur sic parashikohet në pikën C paragrafi i II i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurisë Publike" - Fotografite bashkëlidhur.⁶⁹

Nga kqyrja e rregjistrimit për personat e shoqëruar u konstatua se ai mbahej me korrektësi. Nga kqyrja e formularit "SH" që dispononte Zyra e Informacionit në atë moment, rezultoi se ky formular ishte i plotësuar në përputhje me Pikën D paragrafi i III i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurisë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit.

Stacioni i Policisë Fushë Krujë

Dhomat e shoqërimit:

Stacioni i Policisë Fushë-Krujë, është pjesë e Komisariatit të policisë Krujë.

Në këtë stacion policie ka 2 dhoma shoqërimi dhe nuk ka dhoma sigurie.

Të arrestuarit apo të ndaluarit dërgohen në dhomat e sigurisë së komisariatit të policisë Krujë.

⁶⁸Proces verbal intervistimi A.Brahja

⁶⁹ Fotografi dhomat e sigurisë Kom.Pol.Krujë.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Në këtë stacion policie grupi i inspektimit, kontaktoi me drejtuesin e tij Kryekomisar Z. Gëzim PJETERNIKAJ, i cili bëri një panoramë të punës që përballon stacioni i policisë që ai drejton, kushtet e punës dhe infrastrukturën teknike e logjistike.

Sipas z. Pjeternikaj, kushtet e punës dhe infrastruktura në këtë stacion policie ishte mjaft e keqe.

Dhomat e shoqërimit ishin në përputhje rregullat e përcaktuara në pikën C paragrafi i II i "Procedurave Standartë të Punës për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit. Fotografite bashkëlidhur.⁷⁰

Grupi i inspektimit kontrolloi dokumentacionin e dhomave të shoqërimit.

Nga kqyrja e regjistrit të shoqërimit të personave, rezulton se ai ishte mbajtur dhe plotësuar korrekt dhe konform standarteve të kërkuara.

Po ashtu edhe Formularit "SH" plotësohej dhe administrohej sipas përcaktimeve të bëra në pikën D paragrafi i III i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit. Fotografite bashkëlidhur.⁷¹.

KONKLUZIONE

1. Dhomat e sigurisë në D.P.Q.Durrës nuk plotësojnë standartet e përcaktuara në Aktet Ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Dhomat e shoqërimit të Personave në komisaritet e policisë së D.P.Q.Durrës plotësojnë standartet e kërkuara.
3. Në D.P.Q.Durrës, është reflektuar duke përmirësuar mënyrën e mbajtjes, plotësimit, dhe administrimit të dokumentacionit për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, sipas rekomandimeve të bëra nga Drejtoria e Inspektimit Sh.K.B. pas inspektimit të Muajit Tetor 2010.
4. Regjistrat përkatës plotësojnë të gjitha standartet e miratuara dhe administrohen nga personat përgjegjës me profesionalizëm e korrektësi.
5. Trajtimi ushqimor i personave të arrestuar/ndaluar bëhet sipas normave të miratuara nga vetë D.P.Qarkut nëbuxhetin vjetor të institucionit.
6. Nuk ka asnjë ankesë të paraqitur nga personat e shoqëruar, ndaluar ose arrestuar në drejtim të punonjësve të policisë për keqtrajtim ose shkelje të drejtash gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit ose sigurisë së kësaj Drejtorie.

⁷⁰ Fotografi dhomat e sigurise Kom.Pol.Kruje.

⁷¹ Fotografi dhomat e sigurise Kom.Pol.Kruje.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT ELBASAN

D.P.Qarkut Elbasan, është e strukturuar në 4 komisariate:

Komisariati i Policisë Elbasan

Komisariati i Policisë Gramsh

Komisariati i policisë Peqin

Komisariati i policisë Librazhd

Grupi i inspektimit në mungesë të Drejtorit të Policisë së Qarkut (për arsye objektive) mori kontakt me shefin e Komisarariatit të Policisë Elbasan Z. Ilir GJOÇI.

Gjatë intervistës, Z. Gjoci, bëri një panoramë të gjerë të kushteve ekzistuese në dhomat e shoqërimit dhe sigurisë.

Nga 4 komisaritet që ka DPQ Elbasan, vetëm komisariti i Policisë Elbasan, ka dhoma sigurie, ndërsa komisaritet e tjera kanë vetëm dhoma shoqërimi.

Funksionari i policisë bëri me dije se vazhdimisht nga ana e tij kryhen kontrole periodike në këto ambiente. Gjithashtu ai sqaroi se miraton çdo muaj listën e personave të cilët kanë të drejtën dhe detyrimin për t'u futur në këto ambiente si dhe Planet e Kontrollit Mijor që i paraqiten nga Shefi i Seksionit të Rendit e Sigurisë së Objekteve në Komisaritat.

Gjatë kohës që ai ushtron funksionet e tij në këtë strukturë policore, nuk ka patur asnjë incident me persona të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar, as ankesë për keqtrajtime fizike ndaj këtyre personave nga punonjës të policisë. Ky fakt u konfirmua dhe nga specialistët e SH.K.B-së në Qark që ishin pjesë e grupit të inspektimit.

Kushtet fizike në dhomat e sigurisë nuk i plotësojnë standartet e kërkuara, megjithë përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e tyre.⁷²

Trajtimi me ushqim bëhet sipas normave të përcaktuara nga D.P.P.Shtetit nga vetë D.P.Qarkut. Ka respektim rigoroz të normës ditore të ushqimit dhe kjo normë është e afishuar në ambientet e dhomave të sigurisë. Trajtimi Ushqimor përcaktohet si zë me vete në buxhetin vjetor me të njëjtin emërtim (trajtim ushqimor për dhomat e sigurisë) dhe jepej në përputhje me rregullat që përcakton Kreu IV paragrafi i II i Urdhërit Nr. 64 datë 25.01.2010 të D.P.P.Shtetit.

Komisariati i Policisë Elbasan

Dhomat e sigurisë:

Në Komisariatin e Policisë Elbasan ekzistojnë 20 dhoma sigurie, por vetëm 6 prej tyre janë në funksion.

⁷²Fotografi dhoma shoqërimi e sigurimi ne Kom.Pol.Elbasan.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Nga kqyrja dhe verifikimi në vend i këtyre dhomave, rezulton se ato nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara me Urdhërin Nr. 64 datë 25.01.2010 "Për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore" Kreu V pika 2.1 dhe pika 2.2, ku përcaktohet se përmasat e dhomave të sigurisë duhet të jenë 10 m². Në rastin konkret dhomat e sigurisë që ishin në funksionim, kishin sipërfaqe 8 m² secila.

Gjithashtu, në këto ambiente mungon paradhoma, sipas përcaktimit të pikës 3 të Kreut V të urdherit të sipërpemendur.

Problem mbeten dhomat e ndalimit e arrestimit të cilat kërkojnë nderhyrje urgjente. Infrastruktura dhe kushtet higjieno-sanitare të dhomave të sigurisë, janë larg standarteve të kërkuara. Megjithatë është siguruar uji 24 ore përseri ekziston vetëm një ambinet dushi i përbashkët.

Në të gjitha ambientet e dhomave të sigurisë ishin të afishuar të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar e arrestuar.

Në vijim në prani të përgjegjesit të Dhomave të paraburgimit Z. Shefqet BEQIRI, u krye verifikimi i dokumentacionit dhe administrimi i njësive me origjinalin për këto dokumentacion.

Verifikimi iu nështruan:

- Regjistri për shtetasit e ndaluar, Regjistri i Marrjes në Pyetje të Personave të Ndaluar e Arrestuar; Regjistri i Vizitave Mjekësore; Regjistri i dorezimit të sendeve personale; Regjistri i takimit të të ndaluarëve me mbrojtësin; Regjistri i Kontrollit të Dhomave të Paraburgimit (Sigurisë).⁷³

Në bazë të verifikimeve të kryera rezulton se këto rregjistra mbaheshin, plotësoheshin dhe administroheshin konform rregullave.

Dhomat e shoqërimit:

Në Kom. Pol. Elbasan ekzistojnë 3 dhoma shoqërimi: një për të rritur, një për femra dhe një për persona të mitur.

Grupi i inspektimit intervistoi Shefin e Rendit të Sigurisë së Objekteve në Kom. Pol. Elbasan Komisar Leonidh ZAIMI ⁷⁴.

Z. Zaimi theksoi se dhomat e shoqërimit. Verifikimi u dokumentua me fotografi. Nga kqyrja e dhomave të shoqërimit konstatohet se kushtet në këto ambiente janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën C paragrafi i II i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P. Policisë së Shtetit.

Gjithashtu nga shefi i Seksionit të Rendit të Sigurisë së Objekteve në Kom. Pol. na u vu në dispozicion dhe Regjistri i Personave të Shoqëruar si dhe Formularët "SH" që ekzistojnë në atë moment në Zyrën e Informacionit.

⁷³Procesverbal për marrjen e të dhënave e dokumentacionit gjatë inspektimit Sh. Beqiri

⁷⁴Procesverbal intervistimi L. Zaimi



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Ky dokumentacion ishte në përputhje me urdhërin e D.P.P Shtetit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", (Lidhja Model nr 1) dhe Udhrit nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".

Këto regjitra ishin mbajtur, plotësuar dhe administruar konform Urdhërit të D.P.P Shtetit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", (Lidhja Model nr 1) dhe Udhrit nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike"

Komisariati i Policisë Peqin.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë komisarjat ka 3 dhoma shoqërimi dhe nuk ka dhoma sigurie.

Të arrestuarit apo të ndaluarit dërgohen në dhomat e sigurisë së komisarjatisë të policisë Elbasan.

Në këtë Komisarjat u kontaktua Shefi i Seksionit të Rendit e Sigurisë Publike Komisar Agim HAJDARI⁷⁵

Dhomat e shoqërimit të personave janë të kategorizuara: për të rritur, për femra dhe për të mitur.

Këto dhoma janë brenda standarteve të kërkuara, ashtu siç përcaktohet në Pikësn C Paragrafi II i "Procedurave Standarte të Punës Për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr .1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit, si dhe në aktet ligjore e nenligjore e konventat ndërkombëtare për trajtimin e këtyre personave.

Nga kqyrja e këtyre dhomave, rezulton se:

- sipërfaqja e tyre është mbi 10 m2.
- Kanë ndricim natyral dhe ajrim në parametrat optimal.
- dhomat janë pajisur me të gjitha pajisjet normale.
- kanë tualet dhe dushe të veçanta
- kanë ujë të rrjedhshëm në ambientet e brendshme
- kanë të afishuara në format të madh të drejtat e personave të arrestuar/ndaluar shoqëruar, në gjuhën shqipe e angleze .

Nga kqyrja e dokumentacionit që disponohej për personat e shoqëruar rezulton se rregjistri mbahej në përputhje me urdhërin e D.P.P Shtetit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të Dhënave për Personat e Shoqëruar, Ndaluar e Arrestuar, në Strukturat Vendore të Policisë së Shtetit", (Lidhja Model nr 1) dhe Udhrit nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për Miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".

Gjithashtu edhe Formulari "SH" që ekzistonin në atë moment në Zyrën e Informacionit, mbahej në mënyrë korrekte.

⁷⁵Proceverbal Intervistimi A.Hajdari.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar
apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të
Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".
Komisariati i Policisë Gramsh.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë komisarjat ka dhoma shoqërimi dhe nuk ka dhoma sigurie.
Të arrestuarit apo të ndaluarit dërgohen në dhomat e sigurisë së komisarjatisë të policisë Elbasan.

Grupi i inspektimit kontaktoi me shefin e këtij Komisarjati, Kryekomisar **Xhovalin MARTINCAMAJ**.

Gjatë bashkëbisedimit me të ai theksoi se në Komisarjat ekzistojnë 4 dhoma shoqërimi, për femra, për të mitur dhe dy dhoma për persona të tjerë.
Këto dhoma nuk plotësojnë kushtet optimale përse i përket infrastrukturës.

Në intervistën e tij Shefi i Seksionit të Rendit e Sigurisë Publike në Komisarjat, Komisar Gezim Braho, sqaroi se për mungesë të fondeve kushtet janë të papërshtatshme, dhe megjithë përpjekjet e kërkesat tona të vazhdueshme nuk kemi arritur ti përmirësojmë përveç një lyerje të re dhe hapjes së dritareve për ndriçim.

Nga kqyrja e ambienteve të shoqërimit, konstatohet se kushtet në këto ambiente nuk janë në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën C paragrafi i II i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit.

Nga kqyrja e Regjistrimit të Personave të Shoqëruar në ambientet e Komisarjatisë të Policisë dhe formularët "SH", rezulton se ishin plotësuar në përputhje me urdhërin e D.P.P Shtetit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", (Lidhja Model nr 1) dhe Udhërit nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".

Fotokopje e dokumentacionit u administrua së bashku me fotografitë e dhomave të shoqërimit.⁷⁶

Komisariati i Policisë Librazhd.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë komisarjat ka dhoma shoqërimi dhe nuk ka dhoma sigurie.
Të arrestuarit apo të ndaluarit dërgohen në dhomat e sigurisë së komisarjatisë të policisë Elbasan.

Në komisarjatin e Policisë Librazhd u kontaktuar shefi i Komisarjatisë **z.Sulejman KALAJA**, si dhe u intervistua Shefi i Seksionit të Rendit e Sigurisë Publike, Komisar **Bilal MJESHTRI**.⁷⁷

⁷⁶Procesverbal për administrimin e dokumentacionit dhe fotografi të dhomave të shoqërimit Kom.Pol.Gramsh.

⁷⁷Procesverbal intervistimi B.Mjeshtri.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Gjatë intervistës së tij, Z. Mjeshtri, shpjegoi kushtet aktuale në ambientet e shoqërimit në këtë komisarariat.

Ekzistojnë 3 dhoma shoqërimi, të cilat ishin të kompletuara brenda normave e standarteve të kërkuara.

Megjithatë, i vetmi problem që ekziston sipas tij, është mungesa e tualeteve për secilin ambient veçmas.

Në ambientet e dhomave janë afishuar të drejtat e personave të shoqëruar në gjuhen shqipe e angleze.

Nga kqyrja e këtyre ambienteve, konstatohet se ato janë në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën C paragrafi i II i "Procedurave Standarte të Punës për Rendin e Sigurinë Publike" miratuar me Urdhërin Nr 1417 datë 11.12.2009 të D.P.Policisë së Shtetit.

Në vijim këto dhoma u fotografuan.⁷⁸

Gjatë kqyrjes së dokumentacionit - Rregjistri për Shoqërimin e personave në Komisarariat dhe formularët "SH".⁷⁹, u konstatua se ky dokumentacion ishte në përputhje me urdhërin e D.P.P Shtetit nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", (Lidhja Model nr 1) dhe Udhrit nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".

KONKLUZIONE

1. Në D.P.Qarku Elbasan gjendja e administrimi i dokumentacionit (Regjistrave) është i unifikuar e në përputhje me procedurat Standarte të Punës si dhe modeleve të miratuara nga D.P.P.Shtetit.
2. Dhomat e shoqërimit të Personave në D.P.Q. Elbasan, plotësojnë standartet e kërkuara.
3. Dhomat e Sigurisë së Personave në D.P.Q.Elbasan nuk plotësojnë standartet e kërkuara.
4. Trajtimi ushqimor i kësaj kategorie personash bëhet sipas normave të miratuara nga vetë D.P.Qarkut në buxhetin vjetor.
5. Në D.P.Qarku Elbasan nuk ka patur asnjë rast të ankesës për ushtrim dhune dhe keqtrajime nga personat e shoqëruar, ndaluar ose arrestuar në drejtim të punonjësve të policisë.

⁷⁸Fotografi te dhomave te shoqerimit te Kom.Pol.Librazhd.

⁷⁹Procesverbal per marrjen e te dhenave e dokumentacionit .



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

DREJTORIA E POLICISË QARKUT KORÇË

Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë është strukturuar në 4 Komisariate;

Komisariati i Policisë Korçë

Komisariati i Policisë Devoll

Komisariati i Policisë Ersekë

Komisariati i Policisë Pogradec

Grupi i Inspektimit në fillim mori kontakt me Drejtorin e Policisë së Qarkut Korçë, **Z. Bernard ÇAUSHI**, i cili bëri një ekspozë të gjithë punës dhe veprimtarisë së Policisë së Shtetit në këtë Qark, duke vënë theksin në procedurat që ndiqen për trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Në ambjentet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë, nuk kishte dhoma shoqërimi, ndalimi dhe arrestimi.

Personat e shoqëruar, dërgoheshin në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Korçë, ndërsa personat e ndaluar dhe arrestuar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Pogradec.

Komisariati i Policisë Korçë

Dhomat e sigurisë.

Komisariati i Policisë Korçë i ishte nënshtruar një rikonstruksioni, projekti i të cilit daton në muajin gusht 2009. Pjesë e këtij rikonstruksioni ka qenë dhe ndërhyrja dhe rregullimi i kushteve infastrukturore të dhomave të sigurisë në këtë Komisariat.

Pavarësisht rikonstruksionit dhe plotësimit të shumicës së kushteve të dhomave të sigurisë siç parashikon procedura standarte e punës dhe manuali i trajtimit të personave të ndaluar dhe arrestuar, këto dhoma nuk ishin marrë në dorëzim sipas kreut V, pikës 3 të manualit të trajtimit të personave të ndaluar dhe arrestuar, i cili parashikon që çdo dhome sigurie pas rikonstruksionit duhet të merret në dorëzim nga një komision i cili vlerëson nëse i plotëson ose jo kushtet. Këto dhoma nuk ishin marrë në dorëzim nga komisarati i Policisë Korçë dhe pse kanë kaluar rreth 6 muaj që ka mbaruar rikonstruksioni. Kjo situatë justifikohet me faktin që projekti i rikonstruksionit është bërë para miratimit të procedurave standarte të punës dhe rrjedhimisht kushtet aktuale pas rikonstruksionit nuk janë në përputhje të plotë me ato kushte që parashikohen në procedurat standarte të punës dhe në manualin e trajtimit të personave të ndaluar dhe arrestuar.

Gjithashtu dhe për këtë problem u konstatua që nuk ishte njoftuar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ose grupit të inspektimit nuk ju vu në dispozicion një shkresë mbi bazën e të cilës të vërtetohej një pohim i tillë.

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Personat e ndaluar dhe arrestuar nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Korçë dërgoheshin në Komisariatin e Policisë Pogradec, pasi dhomat e sigurisë në



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

ambjentet e Komisarariatit të Policisë Korçë, nuk përmbushnin kushtet dhe standartet e kërkuara.

Praktika për dërgimin e një personi të arrestuar ose ndaluar nga Komisariami i Policisë Korçë në Komisariatin e Policisë Pogradec konsistonte me nxjerrjen e Autorizimit të Shefit të Komisarariatit, urdhër – shëbimin dhe procesverbalin mbi dorëzimin e personit të ndaluar ose arrestuar.

Kjo praktikë rezultoi në përputhje me ligjin dhe procedurat standarte të punës, por theksojmë faktin që procedura standarte e punës parashikon vetëm praktikën e shoqërimit të personit të arrestuar ose të ndaluar nga dhomat e sigurisë në gjykatë dhe jo nga një komisarariat në një tjetër për shkak të mungesës së kushteve të dhomave të sigurise, siç u justifikua nga punonjësit D.P.Q Korçë.

Grupi inpektimit konstatoi se, procedura për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar nga komisariami i Policisë Korçë për në Komisarariatitn e Policisë Pogradec, nuk është e normuar dhe e rregulluar me asnjë akt. Për më tepër nuk është iniciuar asnjë shkresë apo njoftim nga D.P.Q Korçë, për ekzistencën e këtij problemi.

Dhomat e shoqërimit;

Në këtë komisarariat ekzistonin dy dhoma shoqërimi, të cilat përdorehin për shoqërimin e personave të rritur meshkuj dhe personave të rritur femra.

Nuk kishte ambjent të posaçëm (dhomë) për shoqërimin e personave të mitur, në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar", të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike.

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Gjatë kqyrjes rezultoi që;

- Këto dhoma ndodheshin brenda komisarariatit të policisë Korçë.
- Kishin hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin e personave të shoqëruar.
- Nuk kishin të gjitha orënditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriget.
- Nuk ishin të lyera
- Kishin ndricim të mjaftueshëm.
- Kishte abazhurë të cilët për nga mënyra e vendosjes mund të krijonin mundësi vetvrasje nga personat e shoqëruar.
- Dritaret nuk ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Kishte vetem dy tualete, relativisht funksionale, mungonte tualeti për të miturit.
- Në mur mungonin të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e te dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Grupi i inspektimit, gjatë verifikimit në dhomat e shoqërimit intervistoi Znj. **Zhaneta QANIU**⁸⁰ në cilësinë e personit të shoqëruar. Gjatë intervistimit Znj. Qaniu na bëri të ditur që nuk kishte asnjë pretendim dhe i ishin garantuar të gjithë të drejtat nga ana e Policisë së Shtetit, gjatë procesit të shoqërimit në komisariat.

Procedurat e shoqërimit të personave

Punonjësi i Policisë që bënte shoqërimin, pasi plotësonte formularin "SH", sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në këtë formular, ja dorëzonte specialistit të shërbimit të informacionit. Specialisti i shërbimit të informacionit së bashku me punonjësin e policisë që bënte shoqërimin pasqyronin të dhënat në regjistrin e personave të shoqëruar.

Mbajtja e personave të shoqëruar kryhej deri në verifikimin dhe zgjidhjen e çështjes për të cilën është kryer shoqërimi, por jo më shumë se 10 orë.

Kjo praktikë pune rezultoi korrekte dhe konform ligjit.

Në varësi të dinamikës dhe rrezikshmërisë së personave të ndryshëm, *personat e shoqëruar mbaheshin shpesh herë dhe nëpër korridore dhe zyra, gjë e cila vjen në kundërshtim me procedurat standarte të punës.*

Grupi i inspektimit, kqyri regjistrin e shoqërimit të personave ⁸¹, pranë zyrës së informacionit të Komisarariatit të Policisë Korçë, nga ku konstatoi se:

- Nuk ishin të pasqyruara të gjithë rubrikat sipas Urdhërit Nr. 1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhërit Nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2), dhe konkretisht;
- Rubrika e njoftimit të familjarëve ishte e paplotësuar
- Gabime të shumta në rubrika të ndryshme
- Rubrika e orarit të daljes së personit të shoqëruar, nuk vihet data, duke lënë shkak për abuzim në përllogaritjen e afatit prej 10 orësh.

Gjithashtu, nga kqyrja e regjistrit të shoqërimit, në mënyrën sesi janë plotësuar rubrikat rezultoi se, plotësimi bëhet jo me seriozitetin e veprimtarisë që pasqyron. Nga njëra datë në tjetrën lihet hapësirë boshe, nuk mbyllet me numër rendor ditor kundrejt nënshkrimit që bënë punonjësi që mban regjistrin.

Një problem shqetësues që u konstatua, ishte mos trajtimi me ushqim i personave të shoqëruar, brenda afatit 10 orësh që mund të qëndronin në dhomat e shoqërimit, pasi nuk është e parashikuar në asnjë akt ligjor dhe nënligjor që rregullon procedurat për trajtimin e personave të shoqëruar.

⁸⁰ Proc-verb intervistimi Zh. Qaniu (e shoqëruar)

⁸¹ Rregj nr. 41, datë 04.10.2010



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Komisariati i Policisë Devoll

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Në lidhje me zbatimin e procedurave për ndalimin dhe arrestimin e personave, ndiqej e njëjta praktike pune si në Komisaratin e Policisë Korçë.

Personat e ndaluar dhe arrestuar në mungesë të dhomave të sigurisë në këtë komisarati, dërgoheshin në Komisaratin e Policisë Pogradec.

Gjatë verifikimit u konstatua që, ekzistonte e njëjta problematike, pasi nuk kishte një akt të miratuar, i cili parashikonte dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar nga Komisarati i Policisë Devoll në Komisaratin e Policisë Pogradec.

U administrua një praktikë shoqërimi i një personi të ndaluar, e cila nuk ishte e azhornuar në terminologji, pasi përdorej akoma termi "i Paraburgosur", term i cili nuk ekziston më, pas administrimit të institucionit të paraburgimit nga Ministria e Drejtësisë.

- Nuk mbahej regjistri i personave të ndaluar dhe arrestuar, gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 2, e cila parashikon mbajtjen e një regjistri të tillë nga të gjithë komisaritet pavarësisht që nuk kanë dhoma sigurie.

- Kushtet infrastrukturore në Komisaratin e Policisë Devoll ishin në nivele minimale, gjë e cila sillte një vështirësi në kryerjen e detyrave.

Procedurat e shoqërimit të personave

Në këte komisarati grupi inspektimit mori kontakt me shefin e rendit dhe sigurisë publike **Z.Dashnor TOSKA** me gradë N/Komisar, cili na bëri të ditur procedurat që zbatoheshin për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1417, datë 11.12.2009, në lidhje me shoqërimin e personave, dhe Urdhrit Nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" rezultoi se:

- Formulari "SH", që plotësohet nga punonjesi i policisë që bën shoqërimin, plotësohej vetëm në një kopje, në kundërshtim me kreun V, shkronja D, pika 2, të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, e cila parashikon që formulari "SH" duhet të jetë në dy kopje.

- Pasqyrimi i të dhënave në regjistrë bëhej nga përgjegjësi i sallës së operative dhe jo nga personi që kryen shoqërimin.

Nga kqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar nr.16.datë 25.02.2011, rezultoi që:

- Përdorimi i kodeve policore në rubrikën e personave që bëjnë shoqërimin dhe në rubrikën e personit që punoi për zgjidhjen e problemit, në kundërshtim me Kreun V,



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

shkronja D, pika 1, të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike.

- Në disa raste në rubriken e orës dhe datës së lënies së lirë të personit të shoqëruar, shkruhet vetëm ora, në kundërshtim me Kreun V, shkronja D, pika 1, të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike.

Një problem shqetësues në këtë komisariat ishte mungesa e dhomave të shoqërimit. Personat që shoqëroheshin mbaheshin nëpër zyrat e specialisteve që punonin për zgjidhjen e problemit, *gjë e cila bie në kundërshtim me procedurat standarte të punës, Kreu V, shkronja B, pika 1.*

Komisariati i Policisë Ersekë

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Në lidhje me zbatimin e procedurave për ndalimin dhe arrestimin e personave, rezultoi që, ndiqej e njëjta praktikë pune si në komisariatet e lartpërmendur.

Personat e ndaluar dhe arrestuar, në mungesë të dhomave të sigurisë në këtë komisariat, dërgoheshin në Komisaratin e Policisë Pogradec.

Gjatë verifikimit u konstatua që ekzistonte e njëjta problematike, pasi nuk kishte një akt të miratuar, i cili parashikonte dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar nga Komisarati i Policisë Ersekë në Komisaratin e Policisë Pogradec.

Gjithashtu, u konstatua që nuk mbahej regjistri i personave të ndaluar dhe arrestuar, gjë që binte në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të policisë së shtetit", pika 2, e cila parashikon mbajtjen e një regjistri të tillë nga të gjithë komisariatet pavarësisht që nuk kanë dhoma sigurie.

Procedurat e shoqërimit të personave

Në këte komisariat grupi inspektimit mori kontakt me shefin e rendit dhe sigurisë publike **Z.Luan BUTKA** me gradë N/Komisar, i cili na bëri të ditur procedurat që zbatoheshin për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Gjate verifikimit të zbatimit të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, në lidhje me shoqërimin e personave rezultoi se:

- Formulari "SH", që plotësohet nga punonjesi i policisë që bën shoqërimin plotësohej vetëm në një kopje, në kundërshtim me kreun V, shkronja D, pika 2, e procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, e cila parashikon që formulari "SH" duhet të jetë në dy kopje.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- Pasqyrimi i të dhënave në regjistrë bëhej nga përgjegjësi i sallës operative dhe jo nga personi që kryen shoqërimin.

Pas kqyrjes së regjistrit të personave të shoqëruar rezultoi se;

- Ishte i plotësuar korrekt.

Dhomat e shoqërimit:

Në këtë komisariat ekzistonin dy dhoma shoqërimi, të cilat përdoreshin për shoqërimin e personave të rritur meshkuj dhe personave të rritur femra.

Nuk kishte ambjent të posaçëm (dhomë) për shoqërimin e personave të mitur, sic parashikohet në pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar", në procedurat standarte të punës.

Gjatë kqyrjes rezultoi se;

- Këto dhoma ndodheshin brenda komisariatit të Policisë.
- Kishin hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin e personave të shoqëruar.
- Nuk kishin të gjitha orëditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar.
- Nuk ishin të lyera
- Kishin ndricim të mjaftueshëm
- Dritaret ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Nuk kishte tualete.
- Në mur mungonin afishet me të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane, gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 të DPPSH "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Komisariati i Policisë Pogradec

Dhomat e Sigurisë:

Në komisariatit të Policisë Pogradec kishte 6 dhoma sigurie, të cilat ndodheshin në një godinë jashtë ndërtesës së komisariatit.

Këto dhoma përballonin gjithë dinamikën e DPQ Korçë për trajtimin dhe akomodimin e personave të ndaluar dhe arrestuar.

Dhomat e sigurisë, *nuk ishin të ndara për meshkuj, femra dhe të mitur.*

Nga kqyrja e kushteve të këtyre dhomave rezultoi që;

Nuk ishin në përputhje me procedurat standarte të punës, kreu IV, shkronja A dhe me Manualin "Për rregullat e Trajtimin dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, kreu V, pika 1 dhe 2, konkretisht;

- Nuk kishin sipërfaqe të mjaftueshme.
- Nuk kishin paradhomë.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- Nuk kishin krevate.
- Ndriçimi nuk ishte i mjaftueshëm.
- Mungesa e pajisjeve për kryejën e nevojave personale.
- Nuk kishin buton zileje apo sinjali për kontakt me punonjësën e shërbimit
- Tualetet ishin totalisht jashtë standartit.
- Korridori i dhomave të sigurisë , nuk ishte sipas përmasave të miratuara 1.5 meter.
- Mungonin fikset e zjarrit.
- Mungonte dhoma e takimit me avokatin, prokurorin, Avokatin e Popullit, etj.
- Gjithashtu mungonte dhoma e mjekut, për kryerjen e vizitave dhe kontrollove mjeksore.
- Në mur nuk ishin të afishuara të drejtat dhe detyrimet e personave të ndaluar dhe arrestuar në gjuhen angleze dhe italiane, sic parashikohet në Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Trajtimi i personave të ndaluar dhe arrestuar

Lidhur me trajtimin e personave të ndaluar dhe arrestuar, grupi inspektimit intervistoi **Z. Zef LLESHI**⁸², në cilësinë e personit të ndaluar. Z. Lleshi ju bënë pyetje në lidhje me kushtet infrastrukturore, garantimin e të drejtave proceduriale, e drejta e përfaqësuesit ligjor, e njohjes me shkakun e ndalimit, e njoftimit të familjarëve, e trajtimit shëndetësor, e trajtimit ushqimor etj.

Gjatë shpjegimeve Z. Lleshi, nuk paraqiti asnjë ankese apo pretendim.

Nje problem tjetër që u verifikua, ishte trajtimi ushqimor i personave të ndaluar dhe arrestuar, gjatë periudhës që akomodohen në dhomat e sigurisë.

Konkretisht, Drejtoria e Policisë Qarkut Korçë, në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2011, kishte përcaktuar objektin e prokurimit "Furnizime dhe shërbime me ushqim" me vlerë 125.000 leke, me procedurë prokurimi "Blerje me vlera të vogla".

Nga praktika e administruar rezultoi që, më datë 22.03.2011, ka dalë Urdhri i Prokurimit Nr. 216 "Për blerjet e vogla", miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, për blerjen e artikujve ushqimor. Bashkëlidhur Urdhërit ishin tre oferta nga tre operatorë ekonomikë të ndryshëm.

Në këtë praktike prokurimi rezultuan këto mangësi;

- Mungonte përlllogaritja e fondit limit.
- Mungonte urdhri i ngritjes së komisionit për blerjet e vogla, i cili ngrihet në fillim të çdo viti kalendarik.
- Mungonin procesverbalet e testimit të tregut.
- Mungonin fatuarat tatimore.

⁸²Proc. Intervistimi Z. Lleshi person i ndaluar



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Të gjitha këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" dhe akeve nënligjore në zbatim të tij.

Për sa i përket kushteve, normës së ushqimit, infrastrukturës së gatimit dhe shërbimit të ushqimit rezultoi që;

Në katin e parë të godinës ku ndodheshin dhomat e sigurisë, ndodhej një kuzhinë e vogël ku gatuhej ushqimi për personat e ndaluar dhe arrestuar. Ushqimi përgatitej nga punonjësja e mirëmbatjes ajo dhe kuzhiniera **Znj.Mahmudie MERXHA**⁸³. Në varësi të kërkesës së përgjegjësit të dhomave të sigurisë, gatuhej ushqim për aq persona të ndaluar dhe arrestuar që ndodheshin në dhomat e sigurisë. *Norma e miratuar e ushqimit ishte 300 lekësh në ditë.*

Grupi i inspektimit, konkludon se një normë e tillë ushqimi është e paplotë.

Përsa i përket kushteve dhe infrastrukturës ku gatuhej ushqimi, duhet theksuar se ishin në nivele shumë të këqija. Kuzhina nuk plotësonte asnjë standart higjieno-sanitar.

Dokumentacioni

Gjatë kqyrjes dhe verifikimit të dokumentacionit që plotësohet dhe administrohen në dhomat e sigurisë, rezultoi që;

- Regjistri për evidentimin e personave të ndaluar dhe arrestuar Nr.29, datë 17.03.2011, ishte jashtë formatit, përdorej formati i regjistrit të personave të shoqëruar.
- Regjistri për sendet personale të ndaluarve dhe arrestuarve Nr.188, datë 09.03.2008, nuk kishte të pasqyruar asnjë procesverbal kontrolli për sendet personale të personave të ndaluar dhe arrestuar.
- Regjistri Nr.189, datë 07.01.2007 i marrjes së pyetjeve nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, avokatët dhe përfaqësuesit e avokatit të popullit etj, ishte i përshtatuar.
- Mungonte regjistri i vizitave mjekësore
- Libri i marrjes së dorëzimeve shërbimit, ishte i rregullt
- Fashikujt (dosjet) personale për çdo të ndaluar dhe arrestuar me kopje të dokumenteve të tyre, rezultuan korrekt.
- Lista e personelit të shërbimit dhe ndihmës që kanë të drejtë të futen në ambientet e dhomave të sigurisë, ishte e rregullt

Nuk kishte një akt që të provonte një model të miratuar të këtyre rregjistrave apo dokumentacioni.

Procedurat e shoqërimit të personave

Në këte komisarjat grupi inspektimit u fokusua gjithashtu në verifikimin e zbatimit të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, në lidhje me

⁸³Proc. Verbal marrje të dhënash M.Rexha



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

shoqërimin e personave, si dhe Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".

Pas verifikimit rezultoi që, formulari "SH", që plotësohet nga punonjësi i policisë që bën shoqërimin, plotësohej vetëm në një kopje, në kundërshtim me kreun V, shkronja D, pika 2, e procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, e cila parashikon që formulari "SH" duhet të jetë në dy kopje.

Pasqyrimi i të dhënave në regjistrë bëhej nga përgjegjësi i sallës operative dhe jo nga personi që kryen shoqërimin sic parashikojnë procedurat standarte të punës.

Pas kqyrjes së regjistrit të personave të shoqëruar Nr.31, datë 30.03.2011 rezultoi që;

- Protokollimi i regjistrit mbante datën 30.03.2011, ndërsa pasqyrimi i të dhënave ishte që nga data 25.03.2011.
- Në rubrikën "pamja e jashtme e personit të shoqëruar" nuk ishte pasqyruar asnjë e dhënë.
- Përdoreshin Kode Policore

Dhomat e shoqërimit;

Në këtë komisarjat ekszitonte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila përdorej për tre kategoritë e personave të rritur meshkuj, personave të rritur femra dhe personave të mitur, *në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar" të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike.*

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Gjate kqyrjes rezultoi që;

- Kjo dhomë ndodhej brenda komisarjatisë të Policisë Pogradec.
- Kishte hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin e personave të shoqëruar.
- *Nuk kishte të gjitha orënditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin tavolinat.*
- *Nuk ishte e lyer.*
- Kishin ndriçim të mjaftueshëm, natyral dhe artificial.
- *Tualetet jasht çdo standarti*
- *Në mur nuk ishin të afishuara të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane, sic parashikohet në Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.*

KONKLUZIONE

1. Shumë punonjës të kësaj strukture nuk kishin njohuri të mjaftueshme dhe nuk zbatonin Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

2. Regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave në të gjithë Drejtorinë e Policisë Qarkut Korçë, nuk ishin të unifikuar dhe në përputhje me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.
3. Pasqyrimi i të dhënave në regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave nuk bëhej në përputhje me nenin 103 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
4. Kushtet në dhomat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave nuk ishin në përputhje me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe me Manualin Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010.
5. Trajtimi me ushqim i personave të shoqëruar nuk është parashikuar në anjë akt ligjor apo nënligjor që rregullon veprimtarinë për këto kategori personash. Trajtimi me ushqim dhe infrastruktura e gatimit të ushqimit për personat e ndaluar dhe arrestuar ishte në kushte shumë të keqja.
6. Nuk kishte një akt të miratuar për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar, në Komisaritin e Policisë Pogradec, në shkelje të plotë të procedurës.

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT BERAT

Drejtoria e Policisë Berat është e strukturuar në 3 Komisariate;

Komisari i Policisë Berat

Komisariati i Policisë Kuçovë

Komisariati i Policisë Skrapar

Grupi i Inspektimit në fillim mori kontakt me Drejtorin e Policisë së Qarkut Berat, Z. **Altin QATO**, i cili bëri një ekspozë të gjithë punës dhe veprimtarisë së Policisë së Shtetit në këtë qark dhe konkretisht në lidhje me procedurat që ndiqeshin për trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Në të gjithë strukturat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat, nuk kishte dhoma ndalimi apo arrestimi .

Të ndaluarit dhe arrestuarit dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisaritit të Policisë Lushnjë.

Ndërsa, dhoma shoqërimi kishte në të tre komisaritet e policisë së kësaj Drejtorie.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Më pas, u intervistua Shefi i Komisarariatit të Policisë Berat, Kryekomisar **Dashamir BENDAJ**⁸⁴.

Zoti Bendaj, shpjegoi procedurat që ndiqeshin praktikisht për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Ai ngriti shqetësimin e kushteve të dhomave të shoqërimit të cilat nuk ishin në përputhje me standartet e kërkuara, për shkak të mungesës së fondeve.

Sipas zotit Bendaj, problemi i mungesës së dhomave të sigurisë ishte ngritur shpesh si shqetësim nga Drejtoria e Policisë Qarkut Berat, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, por nuk kishte gjetur zgjidhje.

Nga Sektori i Programimit dhe Logjistikës në D.P.Q.Berat, ishte përgatitur dhe një preventiv i detajuar që në vitin 2009, për rikonstruksionin e D.P.Q. Berat dhe rrjedhimisht dhe për krijimin e ambjenteve për personat e ndaluar dhe arrestuar, i cili ishte dërguar në D.P.P. Shtetit, por akoma nuk ishte lëvruar fondi.

Deri në këto momente nuk ishte kthyer asnjë përgjigje në lidhje me këtë investim dhe aktualisht të gjithë personat e ndaluar dhe arrestuar nga Komisarariatet e Policisë Berat, Kuçove, Skrapar dhe sektorët në Drejtori, dërgoheshin në Komisariatin e Policisë Lushnjë.

Trajtimi i këtyre personave në Komisariatin e Policisë Lushnjë, ka një kosto të madhe ekonomike pasi kërkon angazhimin e një numri të konsiderueshëm të punonjësve të policisë, automjeteve dhe karburantit.

Një problem tjetër që na u parashtrua dhe u konfirmua dhe nga grupi inspektimit, ishte kapja e personave të kërkuar nga policia, të cilët janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë. Akomodimi i këtyre personave në dhomat e sigurisë zgjat deri në 10 ditë, kohë e cila duhet të kthejë përgjigje Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për dërgimin e personave në Institucionet e vuatjes së dënimit. *Vlerësojmë që kjo praktikë duhet të rishikohet.*

Komisariati i Policisë Berat

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të personave

Në zbatim të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike miratuar me Udhrrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike si dhe Manualit "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, personat e ndaluar dhe arrestuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të cilët akuzohen për kryerjen e një veprë penale sipas përcaktimeve të K.Proc. Penale dhe Kodit Penal, dërgohen në dhomat e sigurimit, deri në shqyrtimin e masës së

⁸⁴Proç. Intervistimi D. Bendaj



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

sigurimit nga gjykata dhe personat e dënuar në mungesë me vendim të formës së prerë.

Konkretisht, në Komisariatin e Policisë Berat, personat e ndaluar dhe arrestuar dërgoheshin në Komisariatin e Policisë Lushnjë, pasi siç trajtuam dhe më lart nuk kishte dhoma sigurie.

Praktika për dërgimin e një personi të arrestuar ose ndaluar konsistonte në nxjerrjen e Autorizimit të Shefit të Komisarariatit, Urdhër – Shërbimit dhe procesverbalit mbi dorëzimin e personit të ndaluar ose arrestuar.

Kjo praktikë rezultoi në përputhje me ligjin dhe procedurat standarte të punës, por theksojme faktin që procedura standarte e punës parashikon vetëm praktiken e shoqërimit të personit të arrestuar ose të ndaluar nga dhomat e sigurisë në gjykatë dhe jo nga një komisarjat në një tjetër, për shkak të mungesës së dhomave të sigurisë.

Kjo procedurë dërgimi dhe akomodimi i personave të ndaluar dhe arrestuar nga Komisarjati i Policisë Berat, në Komisariatin e Policisë Lushnjë, ishte rregulluar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1298, datë 16.11.2009 "Për ruatjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të ndaluar dhe arrestuar te Drejtorisë së Policisë Berat në Komisariatin e Policisë Lushnjë".

Nga kqyrja e regjistrat Nr. 55, datë 20.02.2011 të personave të ndaluar dhe arrestuar, rezultoi se ishte mbajtur në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 1).

Dhomat e shoqërimit.

Kqyrja e dhomave të shoqërimit;

Në këtë komisarjat ekszitonin dy dhoma shoqërimi, të cilat përdorehin për shoqërimin e personave të rritur meshkuj dhe personave të rritur femra. *Nuk kishte ambjent të posaçëm (dhomë) për shoqërimin e personave të mitur, në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar" të procedurave standarte të punës.*

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Gjatë kqyrjes rezultoi se;

- Këto dhoma nuk ndodheshin brenda komisarariatit të Policisë Berat.
- Nuk kishin sipërfaqe të mjaftueshme.
- Nuk kishin të gjitha orënditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriket dhe tavolinat, ishte vetëm një stol druri me skelet metalik.
- Nuk ishin të lyera.
- Ndriçimi ishte artificial me një llampë elektrike të vendosur në mur mbi dyert e dhomave të shoqërimit.
- Ndriçimi natyral ishte i kufizuar për shkak të përmasave të vogla të dritareve.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- Dritaret nuk ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Tualetet ishin 15 – 20 metër larg godinës së ambjenteve të shoqërimit, në një godinë tjetër.

Në mur mungonin të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane *në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.*

Procedurat e shoqërimit të personave

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, personat e shoqëruar për arsye të ndryshme shoqëroheshin në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Berat.

Punonjësi i Policisë që bënte shoqërimin, pasi plotësonte formularin "SH", sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në këtë formular, ja dorëzonte specialistit të shërbimit të informacionit. Specialisti i shërbimit të informacionit së bashku me punonjësin e policisë që ka bërë shoqërimin pasqyronin të dhënat në regjistrin e personave të shoqëruar.

Mbajtja e personave të shoqëruar kryhej deri në verifikimin dhe zgjidhjen e çështjes për të cilën është kryer shoqërimi, por jo më shumë se 10 orë.

Kjo praktikë pune rezultoi korrekte dhe konform ligjit.

Grupi i inspektimit, kqyri rregjistrin e shoqërimit të personave ⁸⁵, pranë zyrës së informacionit të Komisarariatit të Policisë Berat, nga ku konstatoi se:

- Nuk ishin të pasqyruara të gjithë rubrikat sipas procedurës standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike miratuar me Udhërin Nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike", si dhe Udhërit Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2), dhe konkretisht;
- Mungon rubrika e njoftimit të familjarëve
- Mungon rubrika e pamjes së jashtme të personit të shoqëruar

Nje problem shqetësues që u konstatua, ishte mos trajtimi me ushqim i personave të shoqëruar, brenda afatit 10 orësh që mund të qëndronin në dhomat e shoqërimit, pasi nuk është e parashikuar në asnjë akt ligjor dhe nënligjor që rregullon procedurat për trajtimin e personave të shoqëruar.

Komisariati i Policisë Kuçovë

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të personave

⁸⁵Rregj nr. 17, datë 29.01.10.2009



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Të arrestuarit apo të ndaluarit nga strukturat policore të komisariatit Kucovë, dërgoheshin në dhomat e sigurisë së Komisarariatit të Policisë Lushnjë.

Lidhur me dërgimin e tyre në dhomat e sigurisë së Kom.Pol.Lushnjë, dhe dokumentacionin që mbahej, ndiqej e njëjta praktike pune si në Komisariatin e Policisë Berat.

Gjatë kqyrjes së regjistrit Nr. 17, datë 20.05.2010 të personave të ndaluar dhe arrestuar, *rezultoi se kishte korigjime, për të cilat nuk ishte mbajtur procesverbal.*

Procedurat e shoqërimit të personave

Në këtë komisariat grupi inspektimit mori kontakt me shefin e rendit dhe sigurisë publike **Z.Fatmir KARAMANI** me gradë N/Komisar, cili na bëri të ditur procedurat që zbatoheshin për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1417, datë 11.12.2009, në lidhje me shoqërimin e personave, rezultoi që, formulari "SH", që plotësohet nga punonjësi i policisë që bën shoqërimin nuk praktikohet fare, në kundërshtim me kreun V, shkronja D, pika 2, të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, e cila parashikon përdorimin e formularit "SH".

Gjatë kqyrjes së regjistrit të personave të shoqëruar nr.18.datë 20.05.2011, rezultoi që;
- *Ishte i përshtatur dhe jo në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2).*

Kqyrja e dhomave të shoqërimit;

Në këtë komisariat ekzistonte vetem një dhomë shoqërimi, e cila përdorej për shoqërimin e personave të rritur meshkuj, personave të rritur femra dhe për të mitur, *në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar" të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike.*

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Gjatë kqyrjes së dhomës së shoqërimit rezultoi që;

- Kjo dhomë ndodhej brenda komisariatit të Policisë Kuçovë.
- Nuk kishte sipërfaqe të mjaftueshme.
- Nuk kishte të gjitha orenditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriket dhe tavolinat.
- Nuk ishte e lyer.
- Dritaret nuk ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Tualalet jashtë standartit.

Në mur mungonin të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Komisariati i Policisë Skrapar

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të personave

Të arrestuarit apo të ndaluarit nga strukturat policore të komisarariatit Skrapar, dërgoheshin në dhomat e sigurisë së Komisarariatit të Policisë Lushnjë.

Lidhur me dërgimin e tyre në dhomat e sigurisë së Kom.Pol.Lushnje, dhe dokumentacionin që mbahej, ndiqej e njëjta praktike pune si në Komisariatin e Policisë Berat.

Gjatë kqyrjes së regjistrit Nr. 22, 2011 i personave të ndaluar dhe arrestuar, rezultoi që;

- Ishte në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", (Lidhja Nr.1).

Procedurat e shoqërimit të personave

Në këtë komisarariat grupi inspektimit mori kontakt me shefin e rendit dhe sigurisë publike **Z.Migjen LAJTHIA** me gradë N/Komisar, i cili na bëri të ditur procedurat që zbatoheshin për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave lidhur me shoqërimin e personave, rezultoi se *ishin konform procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike dhe UrdhritNr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e te dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".*

Nga kqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar nr. 21, viti 2011 rezultoi që;

- Ishte i plotësuar korrekt, në përputhje me Urdhrit Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e te dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", (lidhja model nr 2).

Kqyrja e dhomave të shoqërimit;

Në këtë komisarariat ekszitonte një dhomë shoqërimi, e cilaj përdorej për shoqërimin e personave të rritur meshkuj. Nuk kishte ambjent të posaçëm (dhomë) për shoqërimin e personave të rritur femra dhe të mitur, në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar" të procedurave standarte të punës.

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Gjatë kqyrjes rezultoi që;

- Kjo dhomë ndodhej brenda komisarariatit të Policisë Skrapar.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- Nuk kishin sipërfaqe të mjaftueshme.
- Orendite për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, si karriget dhe tavolinat ishin të amortizuara.
- Nuk ishin të lyera.
- Ndriçimi natyral ishte i mjaftueshëm.
- Dritaret ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Tualetet ishin larg ambjenteve të shoqërimit jashtë standartit.

Në mur mungonin të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

KONKLUZIONE

1. Shumë punonjës policie të kësaj strukture nuk kishin njohuri të mjaftueshme dhe nuk zbatonin Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.
2. Regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave në të gjithë Drejtorinë e Policisë Qarkut Berat, nuk ishin të unifikuar dhe në përputhje me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
3. Pasqyrimi i të dhënave në regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave nuk bëhej në përputhje me nenin 103 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
4. Nuk kishte dhoma sigurie në të gjithë qarkun e Beratit.
5. Kushtet në dhomat e shoqërimit, nuk ishin në përputhje me "Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike" dhe "Manualin Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore".



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

DREJTORIA POLICISË SË QARKUT LEZHË

Drejtoria e Policisë Lezhë është e strukturuar në 3 Komisariate;

Komisari i Policisë Lezhë

Komisariati i Policisë Rreshen

Komisariati i Policisë Laç

Në ambjentet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, nuk kishte dhoma shoqërimi, ndalimi dhe arrestimi.

Personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar shoqëroheshin në ambjentet e dhomave të shoqërimit dhe në ambjentet e dhomave të sigurisë, në Komisariatin e Policisë Lezhë.

Komisariati i Policisë Lezhë

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Në komisaratin e Policisë Lezhë, personat e ndaluar dhe arrestuar akomodoheshin dhe trajtoheshin në dhomat e sigurisë brenda këtij Komisarati.

Gjatë kqyrjes dhe verifikimit të dokumentacionit që plotësohet dhe administrohen në dhomat e sigurisë siç përcaktojnë procedurat standarte të punës, kreu IV, shkronja B, pika 3, rezultoi që;

- Regjistri për evidentimin e personave të ndaluar dhe arrestuar Nr. 61, datë 25.03.2011, rezultoi i rregullt, si nga forma ashtu dhe nga përmbatja.
- Regjistri për sendet personale të ndaluarve dhe arrestuarve Nr. 6, datë 03.01.2011, rezultoi i rregullt, si nga forma ashtu dhe nga përmbatja.
- Regjistri Nr. 8, datë 30.01.2011 i marrjes së pyetjeve nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, avokatet dhe përfaqësuesit e avokatit të popullit etj, rezultoi i rregullt, si nga forma ashtu dhe nga përmbatja.
- Regjistri i vizitave mjekësore, Nr. 4, datë 02.01.2011, rezultoi i rregullt si nga forma ashtu dhe nga përmbatja.
- Libri i marrjes së dorëzimit shërbimit, Nr. 5, datë 02.01.2011, rezultoi i rregullt, si nga forma ashtu dhe nga përmbatja.
- Fashikujt (dosjet) personale për çdo të ndaluar dhe arrestuar me kopje të dokumenteve të tyre, rezultuan korrekt.
- Lista e personelit të shërbimit dhe ndihmës që kanë të drejtë të futen në ambjentet e dhomave të sigurisë, ishte e rregullt.
- Dosjet për administrimin e procesverbaleve të dorëzimit të ndaluarve dhe arrestuarve në institucionet e paraburgimit, të dorëzimit të sendeve personale si dhe urdhrat për transferim apo shoqërim në rastet e veprimeve hetimore etj, rezultuan korrekte.

Vlerësojmë mënyrën e mbajtjes, administrimit dhe plotësimit të regjistrave të mësipërm, nga ana e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Dhomat e Sigurisë:

Në komisariatet e Policisë Lezhë kishte 4 dhoma sigurie, (meshkuj, femra dhe të mitur), 1 dhomë takimesh me avokatët, prokurorët etj, e cila shërbente dhe për veprime hetimore dhe një dhomë e mjekut për vizitat mjekësore.

Këto dhoma përballonin gjithë dinamikën e qarkut Lezhë për trajtimin dhe akomodimin e personave të ndaluar dhe arrestuar.

Gjatë kqyrjes së kushteve të dhomave të sigurisë, rezultoi se;

- Kishin sipërfaqen e mjaftueshme 10 m 2.
- Kishin paradhomë e pajisur me zgarë hekuri me seksion 25 mm .
- Krevatët ishin prej hekuri, me dyshekë dhe batanije.
- Ndriçimi ishte i mjaftueshëm si ai artificial ashtu dhe ai natyral.
- Pajisjet për kryerjen e nevojave personale ishin në vendin e duhur dhe sipas standartit.
- Pajisjet higjieno sanitare ishin të rregullta të vendosura në paradhomë, sic përcakton proc. stand. punës.
- Dhomat ishin të pajisura me buton zileje apo sinjali për kontakt me punonjës të shërbimit.
- Dera kryesore e hyrjes në paradhomë ishte prej metali, por nuk ishte e veshur me elemente fibre apo druri. Dritarja e kësaj dërraje e cila shërben për kryerje vëzhgimi dhe kontrolli ndaj të ndaluarit/arrestuarit, nuk kishte përmasat 40 cm x 40 cm.
- Mungonte sistemi i ngrohjes.
- Tualetet ishin të rregullt dhe në përputhje me standartet.
- Korridori jashtë dhomave të sigurisë ishte më pak se 1.5 m.
- Në korridor kishte aparat telefoni dhe fikse zjarri

Në murin e korridorit ku ndodhen dhomat e sigurisë ishin të afishuara të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Kqyrja e dhomës së marrjes në pyetje nga avokati, prokurori, takimi vizita etj;

- Pas kqyrjes rezultoi e rregullt dhe në përputhje me Manualin "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, kreu V, pika 6.

Kqyrja e dhomës për kontrollin e vizitave mjekësore;

Nga kqyrja e kësaj dhome rezultoi e rregullt dhe në përputhje me Manualin "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, kreu V, pika 7.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Trajtimi i personave të ndaluar dhe arrestuar;

Në zbatim të të drejtave dhe lirive që ju garantohen personave të ndaluar dhe arrestuar, grupi inspektimit intervistoi **Z. Almarin MARINAJ**⁸⁶, në cilësinë e personit të ndaluar.

Z. MARINAJ ju bënë pyetje në lidhje me kushtet infrastrukturore, garantimin e të drejtave procedurale, e drejta e përfaqësuesit ligjor, e njohjes me shkakun e ndalimit, e njoftimit të familjareve, e trajtimit shëndësor, trajtimit ushqimor etj.

Gjatë shpjegimeve dhe parashtrimeve që bëri Z. MARINAJ, nuk u paraqit ndonje ankese dhe pretendim.

Një problem tjetër që u verifikua ishte trajtimi ushqimor i personave të ndaluar dhe arrestuar, gjatë periudhës që akomodohen në dhomat e sigurisë.

Te arrestuarit apo te ndaluarit trajtoheshin me ushqim, ku, për sigurimin e ushqimit, ishte kontratuar një shoqëri private e cila garantonte ushqimin sipas kërkesave të D.P.Q. Lezhë, në varesi të numrit të personave të ndaluar dhe arrestuar.

Në gjykimin e grupit të inspektimit, norma e ushqimit prej 300 lekesh në ditë është e pamjaftueshme.

Drejtoria e Policisë Qarkut Lezhë, në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2011, kishte përcaktuar objektin e prokurimit "Furnizime dhe shërbime me ushqim" me vlerë 333.333 lekë, me procedurë prokurimi "Blerje me vlera të vogla".

Nga praktika e administruar rezultoi që, më datë 28.02.2011, ka dalë Urdhri i Prokurimit Nr. 2 "Për blerjet e vogla", miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, për blerjen e artikujve ushqimor. Bashkëlidhur Urdhrit ishin kërkesa për blerje mallrash apo kryerje shërbimesh, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin 2011, procesverbal i trajtimit me ushqim të të ndaluarve dhe arrestuarve si dhe kontrata e shërbimit të ushqimit lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor D.P.Q Lezhë dhe Operatorit Ekonomik "Junik".

Në këtë praktike prokurimi rezultuan këto mangësi;

- Mungonte urdhri i ngritjes së komisionit për blerjet e vogla, i cili ngrihet në fillim të çdo viti kalendarik, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Procedurat e shoqërimit të personave

Gjate intervistës me Shefin e Rendit dhe Sigurisë Publike në Kom. Pol. Lezhë, **Z. Astrit PASHOLLARI**⁸⁷, u bë prezent njohja dhe zbatimi i procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, Urdhri nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi

⁸⁶Proç. Intervistimi A. Marinaj

⁸⁷Proç. Intervistimi A. Pashollari



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", si dhe Manuali "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010.

Z. Pashollari shpjegoi gjithashtu, se, në bazë të raport kontrollit të Drejtorisë së Inspektimit të SH.K.B-së, të muajit dhjetor 2010, nga strukturat e Rendit dhe Sigurisë Publike të këtij komisarati, janë marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë raport.

Punonjësi i Policisë që bënte shoqërimin e personit, pasi plotësonte formularin "SH", sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në këtë formular, ja dorëzonte specialistit të shërbimit të informacionit. Specialisti i shërbimit të informacionit së bashku me punonjësin e policisë që ka bërë shoqërimin pasqyronin të dhënat në Regjistrin e personave të shoqëruar.

Mbajtja e personave të shoqëruar kryhej deri në verifikimin dhe zgjidhjen e çështjes për të cilën është kryer shoqërimi, por jo më shumë se 10 orë.

Kjo praktike punë rezultoi korrekte dhe konform ligjit.

Grupi i inspektimit, kqyri regjistrin Nr. 60, datë 24.03.2011 të shoqërimit të personave ⁸⁸, pranë zyrës së informacionit të Komisarariatit të Policisë Lezhë, nga ku konstatoi se :

- Ishte korrekt në përputhje Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2),

Një problem shqetësues që u konstatua, ishte mos trajtimi me ushqim i personave të shoqëruar, brenda afatit 10 orësh që mund të qëndronin në dhomat e shoqërimit, pasi nuk është e parashikuar në asnjë akt ligjor dhe nënligjor që rregullon procedurat për trajtimin e personave të shoqëruar.

Dhomat e shoqërimit;

Në këtë komisarariat ekzistonin 3 dhoma shoqërimi, të cilat përdorehin për shoqërimin e personave të rritur meshkuj, personave të rritur femra dhe të miturve, ***në përputhje me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar", të proc. stand. punes.***

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Gjatë kqyrjes së këtyre dhomave rezultoi se;

- Këto dhoma ndodheshin brenda komisarariatit të policisë Lezhë
- Kishin sipërfaqe të mjaftueshme
- ***Nuk kishin të gjitha orënditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriget dhe tavolinat***
- ***Nuk ishin të lyera***
- Ndricimi natyral dhe artificial ishte i plotë

⁸⁸ Rregj nr. 60, datë 24.03.2011



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- Dritaret ishin të siguruara për parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Tualetet ishin brenda dhomave dhe në përputhje me proc. stand. punës

Në murin e korridorit ku ndodhen dhomat e shoqërimit ishin të afishuara të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Mund të theksojme se këto dhoma përmbushnin 90 % të standarteve të miratuara.

Komisariati i Policisë Rrëshen

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Në komisaratin Rrëshen nuk kishte dhoma sigurie.

Personat e ndaluar dhe arrestuar, në mungesë të dhomave të sigurisë në këtë komisarati, dërgoheshin në Komisaratin e Policisë Lezhë.

Praktika për dërgimin e një personi të arrestuar ose ndaluar nga Komisarati i Policisë Rrëshen në Komisaratin e Policisë Lezhë, konsistonte me nxjerrjen e Autorizimit të Shefit të Komisaratisë, urdher – shëbimit dhe procesverbalit mbi dorëzimin e personit të ndaluar ose arrestuar.

Kjo praktikë rezultoi në përputhje me ligjin dhe procedurat standarte të punës, por theksojmë faktin që procedura standarte e punës parashikon vetëm praktikën e shoqërimit të personit të arrestuar ose të ndaluar nga dhomat e sigurisë në gjykatë dhe jo nga një komisarati në një tjetër për shkak të mungesës së kushteve të dhomave të sigurisë.

Grupi inspektimit konstatoi se, procedura për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar nga komisarati i Policisë Rrëshen për në Komisaratin e Policisë Lezhë, nuk është e normuar dhe e rregulluar me asnjë akt.

Gjithashtu, mungonte regjistri i personave të ndaluar dhe arrestuar, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 2.

Procedurat e shoqërimit të personave

Në këtë komisarati grupi inspektimit mori kontakt me shefin e komisaratisë **Z.Astrit DEMOLLARI** me gradë K/Komisar, i cili na bëri të ditur procedurat që zbatoheshin për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar. Ai informoi mbi



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

problematikën e punës që përballon komisariati, si dhe për kushtet e punës, të cilat nuk plotësonin standartet minimale.

Gjatë verifikimit të kryer, rezulton se zbatimi i procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1417, datë 11.12.2009, në lidhje me shoqërimin e personave, bëhej në *rregull*.

Nga kqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar Nr. 83, datë 15.10.2009, rezultoi që;

- Ishte i përshtatur dhe jo në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2).

Dhomat e shoqërimit;

Në këtë komisariat kishte 2 dhoma shoqërimi, të cila përdoreshin për shoqërimin e personave të rritur meshkuj, personave të rritur femra, nuk kishte dhomë për të miturit, në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar" të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike.

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Gjatë kqyrjes rezultoi që;

- Këto dhoma ndodheshin brenda komisariatit të Policisë Rrëshen
- Nuk kishin sipërfaqe të mjaftueshme
- Nuk kishin të gjitha orënditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriget dhe tavolinat
- Nuk ishin të lyera
- Dritaret nuk ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Çelsat dhe prizat elektrike ishin të hapura, duke lënë shkak për kryerjen e vetvrasjeve nga personat e shoqëruar.
- Tualeti jashtë standartit.

Në mur mungonin të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Komisariati i Policisë Laç

Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Në komisariatën e policisë Laç, nuk kishte dhoma sigurie.

Personat e ndaluar dhe arrestuar, në mungesë të dhomave të sigurisë në këtë komisariat, dërgoheshin në Komisariatën e Policisë Lezhë.

Procedura për ndalimin dhe arrestimin e personave, ishte e njëjte me atë të ndjekur nga komisariati i Policisë Rrëshen.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Praktika e dërgimit të një personi të arrestuar ose ndaluar nga Komisariati i Policisë Kurbin, në Komisariatit e Policisë Lezhë, konsistonte me nxjerrjen e Autorizimit të Shefit të Komisariatit, urdhër – shërbimit dhe procesverbalit mbi dorëzimin e personit të ndaluar ose arrestuar.

Kjo praktikë rezultoi në përputhje me ligjin dhe procedurat standarte të punës, por theksojmë faktin që procedura standarte e punës parashikon vetëm praktikën e shoqërimit të personit të arrestuar ose të ndaluar nga dhomat e sigurisë në gjykatë dhe jo nga një komisarjat në një tjetër për shkak të mungesës së kushteve të dhomave të sigurisë.

Grupi inspektimit konstatoi se, procedura për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar nga komisarjati i Policisë Kurbin për në Komisarjatin e Policisë Lezhë, nuk është e normuar dhe e rregulluar me asnjë akt.

Mungonte regjistri i personave të ndaluar dhe arrestuar, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika2.

Procedurat e shoqërimit të personave

Në këtë komisarjat grupi inspektimit mori kontakt me shefin e Komisarjatisë **Z.Ndue DOÇI**, me gradë K/Komisar dhe me shefin e rendit dhe sigurisë publike **Z.Agron HAJDARMATAJ**⁸⁹ me gradë N/Komisar, të cilët na bënë të ditur procedurat që zbatoheshin për personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave të punës për rendin dhe sigurinë publike, ne lidhje me shoqërimin e personave, rezultoi që ishin konform procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, dhe Urdhrit Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".

Nga kqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar Nr. 89, datë 13.10.2009 rezultoi që;
- Ishte i përshtatur dhe jo në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2).

Dhomat e shoqërimit;

Në këtë komisarjat ekzitonin dy dhoma shoqërimi, të cilat përdoreshin për shoqërimin e personave të rritur meshkuj dhe personave të rritur femra. *Nuk kishte ambjent të posaçëm (dhomë) për shoqërimin e personave të mitur, në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar", të proc. stand. punës.*

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

⁸⁹Proc. Intervistimi A. Hajdarmataj



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Gjatë kqyrjes së këtyre dhomave rezultoi që;

- Këto dhoma ndodheshin brenda komisariatit të Policisë Kurbin.
- Nuk kishin sipërfaqe të mjaftueshme.
- Nuk kishin të gjitha orënditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriget dhe tavolinat.
- Nuk ishin të lyera.
- Ndriçimi ishte artificial me një llampë elektrike të vendosur në mur.
- Ndriçimi natyral ishte i kufizuar për shkak të përmasave të vogla të dritareve.
- Tualetet rreth 15 metër larg godinës së ambjenteve të shoqërimit në një godinë tjetër.
- Jashtë standartit.

Në mur nuk ishin afishuar të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

KONKLUZIONE

1. Disa nga punonjësit e kësaj strukture nuk kishin njohuri të mjaftueshme dhe nuk zbatonin Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.
2. Regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave në të gjithë Drejtorinë e Policisë Qarkut Lezhë, nuk ishin të unifikuar dhe në përputhje me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike. (Komisariati i Policisë Rrëshen dhe Komisariati i Policisë Kurbin)
3. Pasqyrimi i të dhënave në regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave nuk bëhej në përputhje me nenin 103 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit". (Komisariati i Policisë Rrëshen dhe Komisariati i Policisë Kurbin)
4. Kushtet në dhomat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave nuk ishin në përputhje me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe me Manualin Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010.
5. Trajtimi me ushqim i personave të shoqëruar nuk është parashikuar në anjë akt ligjor apo nënligjor që rregullon veprimtarinë për këto kategori personash



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

6. Nuk kishte një akt të miratuar për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar, nga komisaritet e tjera të DPQ në Komisaritin e Policisë Lezhë, kjo, në shkelje të plotë e të procedurës.

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT SHKODËR

Drejtoria e Policisë Shkodër është strukturuar në 3 Komisariate;

Komisari i Policisë Shkodër

Komisariati i Policisë Malesi e Madhe

Komisariati i Policisë Pukë

Grupi i Inspektimit në fillim mori kontakt me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër, **Z. Arjan BOZHAI**, i cili bëri një ekspozë të gjithë punës dhe veprimtarisë së Policisë së Shtetit në këtë qark.

Në ambjentet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, nuk kishte dhoma shoqërimi, ndalimi dhe arrestimi. Personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në ambjentet e dhomave të shoqërimit dhe në ambjentet e dhomave të sigurisë në Komisaritin e Policisë Shkodër.

Komisariati i Policisë Shkodër

a. Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Procedurat për ndalimin dhe arrestimin e personave përcaktojnë normat, kushtet dhe standartet për ruajtjen, sigurimin e trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar gjatë qëndrimit në ambjentet e dhomave të sigurisë të komisariateve të policisë, si dhe garantimin e respektimit të drejtave kushtetuese e ligjore të këtyre personave, deri në shqyrtimin e vendosjen e masës së sigurimit nga organet e gjykatës.

Në zbatim të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike si dhe Manualit "Për rregullat e Trajtimin dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, personat e ndaluar dhe arrestuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të cilët akuzohen për kryerjen e një veprë penale sipas përcaktimeve të K.Proc. Penale dhe Kodit penal, dërgohen në dhomat e sigurimit, deri në shqyrtimin e masës së sigurimit nga gjykata dhe personat e dënuar me mungesë me vendim të formës së prerë.

Pranimi i të arrestuarit ose ndaluarit në ambjentet e dhomave të sigurimit bëhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurimit kundrejt dokumentacionit të mëposhtëm;



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

1. Për te ndaluarin/arrestuarin

- Proces verbalin e arrestimit në flagrancë apo urdhrin e ndalimit të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurori, ose procesverbali për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për caktimin e masës së arrestit, si dhe kopje të vendimit gjyqësor.

- Procesverbalin e kontrollit personal së bashku me sendet personale që i janë gjetur gjatë kontrollit.

- Nje dokument zyrtar identifikimi.

2. Për të dënuarit në mungesë me vendim gjykate te formes së prerë

- Vendimi i formës së prerë të gjykatës për dënimin me burgim të përsosur në mungesë

- Kopje të Urdhrit të Prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal.

- Procesverbali i ekzekutimit të urdhrin të prokurorit.

- Procesverbal për kontrollin personal dhe sendet personale.

- Një dokument identifikimi zyrtar.

Konkretisht në komisaratin e Policisë Shkodër personat e ndaluar dhe arrestuar akomodoheshin dhe trajtoheshin në dhomat e sigurisë brenda këtij Komisarati.

Gjatë kqyrjes dhe verifikimit të dokumentacionit që plotësohet dhe administrohen në dhomat e sigurisë siç përcaktojnë procedurat standarte të punës kreu IV, Shkronja B, pika 3, rezultoi që;

- Regjistri për evidentimin e personave të ndaluar dhe arrestuar Nr.14, datë 05.01.2010, rezultoi i përshtatur nga forma, por nuk ishte korrekt në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të policisë së shtetit" (Lidhja Model nr 1)
- Regjistri për sendet personale të ndaluarve dhe arrestuarve Nr.36/2011, rezultoi i rregullt nga forma dhe regjistroheshin vetëm personat që kishin sende personale me vete.
- Regjistri Nr. 89/2011, i marrjes së pyetjeve nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, avokatët dhe përfaqësuesit e avokatit të popullit etj, rezultoi i rregullt, si nga forma ashtu dhe nga përmbatja.
- Regjistri i vizitave mjekësore, nr.87/2011 rezultoi i rregullt si nga forma ashtu dhe nga përmbatja. Vlen për tu theksuar se personat e gjendur në momentin e inspektimit nuk ishin të pasqyruar në regjistër.
- Libri i marrjes së dorëzimit shërbimit, Nr. 5, date 02.01.2011, rezultoi i rregullt, si nga forma ashtu dhe nga përmbatja.
- Fashikujt (dosjet) personale për çdo të ndaluar dhe arrestuar me kopje të dokumenteve të tyre, rezultuan korrekt.
- Lista e personelit të shërbimit dhe ndihmës që kanë të drejtë të futen në ambjentet e dhomave të sigurisë, ishte e rregullt
- Dosjet për administrimin e procesverbaleve të dorëzimit të ndaluarve dhe arrestuarve në institucionet e paraburgimit, të dorëzimit të sendeve



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".
personale si dhe urdhrat për transferim apo shoqërim në rastet e veprimeve hetimore etj, rezultuan korrekte.

Dhomat e Sigurisë:

Dhoma sigurie quhen ato ambiente të Drejtorive/Komisariateve të policisë që shërbejnë për mbajtjen, sigurimin e trajtimin e personave të ndaluar dhe arrestuar, deri në përcaktimin e masës së sigurimit nga gjykata.

Për të funksionuar si të tilla dhe sipas përcaktimit, dhomat e sigurisë duhet të plotësojnë disa kushte dhe standarte të miratuara në procedurat standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike dhe në Manualin "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010.

Gjatë intervistës, përgjegjësi i dhomave të sigurisë **Z. Ruzhdi BAJRAKURTI**⁹⁰, bëri një pasqyrim të procesit të akomodimit të një të ndaluar/arrestuari në dhomat e sigurisë në momentin e mbërritjes.

Kqyrja e dhomave të sigurisë:

Në komisaratin e Policisë Shkodër kishte 14 dhoma sigurie, por vetëm 3 dhoma ishin në funksionim (meshkuj, femra, të mitur), 1 dhomë takimesh me avokatët, prokurorët etj, e cila shërbente dhe për veprime hetimore.

Këto dhoma përballonin gjithë dinamiken e qarkut Shkodër për trajtimin dhe akomodimin e personave të ndaluar dhe arrestuar.

Pas kqyrjes fizike të kushteve të dhomave të sigurisë në përputhje me procedurat standarte të punës, kreu IV, shkronja A dhe me Manualin "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, kreu V, pika 1, 2, 3, 4 dhe 5 rezultoi që;

- Kishin sipërfaqen e mjaftueshme 10 m²
- Nuk kishin paradhomë të paisur me zgarë hekuri me seksion 25 mm
- Nuk kishin krevatet por vetëm dyshekë dhe batanije
- Ndriçimi artificial ishte i mjaftueshëm ndërsa ai natyral nuk ishte si pasojë e dritareve të vogla.
- Pajisjet për kryerjen e nevojave personale nuk ishin të vendosura në dhomë
- Pajisjet higjieno sanitare ishin të rregullta por jo të vendosura në paradhomë, siç përcakton proc. stand. punës.
- Dhomat nuk ishin të pajisura me buton zileje apo sinjali për kontakt me punonjësin e shërbimit.
- Dera kryesore e hyrjes në dhomë ishte prej metali, dhe ishte e veshur me elemente fibre apo druri.
- Mungonte sistemi i ngrohjes.
- Tualetet ishin të rregullt dhe në përputhje me standartet.

⁹⁰Proç. Intervistimi R. Bajrakurti



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Në murin e korridorit ku ndodhen dhomat e sigurisë ndodheshin të afishuara të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhen shqipe, por jo në gjuhën angleze dhe italiane, jo në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Kqyrja e dhomës së marrjes në pyetje nga avokati, prokurori, takimi vizita etj;
- Pas kqyrjes rezultoi e rregullt dhe në përputhje me manualin kreu V, pika 6

Trajtimi i personave të ndaluar dhe arrestuar

Trajtimi i personave të ndaluar dhe arrestuar në dhomat e sigurisë të komisariateve, bëhet i paanshëm, i njëjlojtë dhe i barabartë, pa diskriminim për shkak të ngjyrës, racës, etnisë, gjuhës, fesë, gjinisë etj.

Trajtimi i tyre duhet të jetë në përputhje të plotë me standartet e përcaktuara në Konventat Europiane, OKB-së, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti atyre që ju privohet liria.

Në zbatim të të drejtave dhe lirive që ju garantohen personave të ndaluar dhe të arrestuar, grupi inspektimit intervistoi **Z. Aleksander PALOKA**⁹¹, në cilësinë e personit të ndaluar.

Z. PALOKA ju bënë pyetje në lidhje me kushtet infrastrukturore, garantimin e të drejtave procedurale, e drejta e përfaqësuesit ligjor, e njohjes me shkakun e ndalimit, e njoftimit të familjarëve, e trajtimit shëndetësor, e trajtimit ushqimor etj.

Gjatë shpjegimeve dhe parashtrimeve që bëri Z. PALOKA, nuk u evidentua asnjë pretendim nga ana e tij.

Një problem tjetër që u verifikua ishte trajtimi ushqimor i personave të ndaluar dhe arrestuar, gjatë periudhës që akomodohen në dhomat e sigurisë.

Në zbatim të kreut III, të Manualit "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, personat e ndaluar dhe arrestuar duhet të trajtohen me ushqim tre vakte sipas normave të miratuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Konkretisht në Drejtorinë e Policisë Qakut Shkodër, në regjistrin parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2011, kishte përcaktuar objektin e prokurimit "Furnizime dhe shërbime me ushqim" me vlerë 250.000 lekë, me procedurë prokurimi "Blerje me vlera të vogla".

⁹¹Proç. Intervistimi A.Paloka



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Nga praktika e administruar rezultoi që, më datë 21.03.2011, ka dalë Urdhri i Prokurimit Nr. 13 "Për blerjet e vogla", miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor, për blerjen e artikujve ushqimor. Bashkëlidhur Urdhrit ishin kërkesa për blerje mallrash apo kryerje shërbimesh, regjistri i pranimi të prokurimeve për periudhën Prill-Maj-Qershor 2011, procesverbal i trajtimit me ushqim të të ndaluarve dhe arrestuarve.

Në këtë praktikë prokurimi rezultuan këto mangësi;

- Mungonte përlllogaritja e fondit limit.
- Mungonin procesverbalet e testimit të tregut.
- Mungonin fatuarat tatimore.

Të gjitha këto në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij.

Për sa i kushteve, normës dhe infrastrukturës së gatimit dhe shërbimit të ushqimit rezultoi që trajtimi me ushqim bëhej nga kuzhina e Komisarariatit.

b. Procedurat e shoqërimit të personave

Gjatë intervistës me Shefin e Rendit dhe Sigurisë Publike në Kom. Pol. Shkodër, **Z. Blerim LAÇI**, u bë prezent procedura që ndiqej nga strukturat policore për shoqërimin e personave, si dhe dokumentacioni që përpilohej prej tyre.

Punonjësi i Policisë që bënte shoqërimin pasi plotësonte formularin "SH", sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në këtë formular ja dorëzonte specialistit të shërbimit të informacionit. Specialisti i shërbimit të informacionit së bashku me punonjësin e policisë që ka bërë shoqërimin pasqyronin të dhënat në Regjistrin e Personave të Shoqëruar.

Mbajtja e personave të shoqëruar kryhej deri në verifikimin dhe zgjidhjen e çështjes për të cilën është kryer shoqërimi, por jo më shumë se 10 orë.

Kjo praktikë pune rezultoi korrekte dhe konform ligjit.

Grupi i inspektimit, kqyri regjistrin Nr. 28/2011 të shoqërimit të personave ⁹², pranë zyrës së informacionit të Komisarariatit të Policisë Shkodër, nga ku konstatoi se:

- Nuk ishte korrekt në përputhje Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2),

Një problem shqetësues që u konstatua, ishte mos trajtimi me ushqim i personave të shoqëruar, brenda afatit 10 orësh që mund të qëndronin në dhomat e shoqërimit, pasi nuk është e parashikuar në asnjë akt ligjor dhe nënligjor që rregullon procedurat për trajtimin e personave të shoqëruar.

Kqyrja e dhomave të shoqërimit;

Në këtë komisarariat ekzistonte një dhomë shoqërimi, e cila përdorej për shoqërimin e personave të rritur meshkuj dhe personave të rritur femra, *nuk është në përputhje me*

⁹²Rregj nr. 28/2011



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar", të procedurave standarte të punës.

Gjithashtu në këtë komisariat ekzistonin dhe 2 dhoma të cilat përdoreshin për veprime speciale hetimore.

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Për një trajtim dinjitoz e njerëzor mjediset ku mbahen këta persona duhet të plotësojnë disa kushte, *siç përcaktojnë procedurat standarte të punës, kreu V, shkronja B.*

Gjatë kqyrjes rezultoi që;

- Kjo dhomë ndodhej brenda komisariatit të policisë Shkodër
- Kishte sipërfaqe të mjaftueshme
- Nuk kishte të gjitha orënditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriget dhe tavolinat
- Nuk ishin të lyera
- Ndriçimi ishte i mjaftueshëm
- Ndriçimi natyral nuk ishte i plotë
- Dritaret ishin të siguruara për parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Tualetet ishin brenda dhomave dhe në përputhje me proc. stand. punës

Në dhomën e shoqërimit ndodheshin të afishuara të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën shqipe, por jo në gjuhën angleze dhe italiane, jo plotësisht në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.

Komisariati i Policisë Malësi e Madhe

a. Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Në lidhje me zbatimin e procedurave për ndalimin dhe arrestimin e personave, në përputhje me procedurat standarte të punës, me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" si dhe Manualit "Për rregullat e Trajtitit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, rezultoi që, Personat e ndaluar dhe arrestuar në mungesë të dhomave të sigurisë në këtë komisariat, dërgoheshin në Komisaratin e Policisë Shkodër .

Praktika për dërgimin e një personi të arrestuar ose ndaluar nga Komisarati i Policisë Malësi e Madhe në Komisaratin e Policisë Shkodër konsistonte me nxjerrjen e Autorizimit të Shefit të Komisaratis, urdhër – shëbimit dhe procesverbalit mbi dorëzimin e personit të ndaluar ose arrestuar.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Kjo praktikë rezultoi në përputhje me ligjin dhe procedurat standarte të punës, por theksojmë faktin që procedura standarte e punës parashikon vetëm praktikën e shoqërimit të personit të arrestuar ose të ndaluar nga dhomat e sigurisë në gjykatë dhe jo nga një komisariat në një tjetër për shkak të mungesës së kushteve të dhomave të sigurisë.

Grupi inspektimit konstatoi se, procedura për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar nga komisariati i Policisë Malësi e Madhe për në Komisaratin e Policisë Shkodër, nuk është e normuar dhe e rregulluar me asnjë akt.

Regjistri për evidentimin e personave të ndaluar dhe arrestuar Nr.19, datë 23.09.2009, rezultoi i përshtatur nga forma, nuk ishte korrekt në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 1).

b. Procedurat e shoqërimit të personave

Në këtë komisariat grupi inspektimit mori kontakt me Shefin e seksionit për rendin dhe sigurinë publike **Z. Gjelo XHANAJ** me gradë Komisar, i cili na bëri të ditur procedurat që zbatoheshin për personat e shoqëruar. Ai na informoi mbi problematikën e punës si dhe për kushtet e punës, të cilat nuk plotësonin standartet minimale.

Gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1417, datë 11.12.2009, në lidhje me shoqërimin e personave, *rezultuan të rregullta*.

Pas kqyrjes së regjistrit të personave të shoqëruar Nr. 18, datë 23.09.2009, rezultoi që;
- Ishte i përshtatur dhe jo në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2).

Kqyrja e dhomave të shoqërimit

Në këtë komisariat ekzistonte vetëm një dhomë shoqërimi, e cila përdorej për shoqërimin e personave të rritur meshkuj, personave të rritur femra dhe për të mitur, *në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar" të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike*.

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Për një trajtim dinjitoz e njerëzor mjediset ku mbahen këta persona duhet të plotësojnë disa kushte, *siç përcaktojnë procedurat standarte të punës, kreu V, shkronja B*,

Gjatë kqyrjes rezultoi që;

- Kjo dhomë ndodhej brenda komisariatit të policisë M. e Madhe



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport “Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European”.

- Nuk kishte sipërfaqe të mjaftueshme
- Ishin orenditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar
- Nuk ishte e lyster
- Dritaret ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
- Tualeti shumë larg dhomës së shoqërimit.

Në mur mungonin të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 “Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit”, pika 11.

Komisariati i Policisë Pukë

a. Procedurat e ndalimit dhe arrestimit të Personave

Në lidhje me zbatimin e procedurave për ndalimin dhe arrestimin e personave, në përputhje me procedurat standarte të punës, me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 “Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit” si dhe Manualit “Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010. Personat e ndaluar dhe arrestuar në mungesë të dhomave të sigurisë në këtë komisariat, dërgoheshin në Komisarlatin e Policisë Shkodër.

Praktika për dërgimin e një personi të arrestuar ose ndaluar nga Komisarlatin i Policisë Pukë në Komisarlatin e Policisë Shkodër konsistonte me nxjerrjen e Autorizimit të Shefit të Komisarlatit, urdhër – shëbimit dhe procesverbalit mbi dorëzimin e personit të ndaluar ose arrestuar.

Kjo praktikë rezultoi në përputhje me ligjin dhe procedurat standarte të punës, por theksojmë faktin që procedura standarte e punës parashikon vetëm praktikën e shoqërimit të personit të arrestuar ose të ndaluar nga dhomat e sigurisë në gjykatë dhe jo nga një komisariat në një tjetër për shkak të mungesës së kushteve të dhomave të sigurisë.

Grupi inspektimit konstatoi se, procedura për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar nga komisariati i Policisë Malsi e Madhe për në Komisarlatin e Policisë Shkodër, nuk është e normuar dhe e rregulluar me asnjë akt.

Regjistri për evidentimin e personave të ndaluar dhe arrestuar Nr.53, datë 22.09.2009, rezultoi i përshtatur nga forma, nuk ishte korrekt në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 “Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit” (Lidhja Model nr 1).



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

b. Procedurat e shoqërimit të personave;

Gjatë verifikimit të zbatimit të procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1417, datë 11.12.2009, në lidhje me shoqërimin e personave, rezultoi që nuk ishin konform procedurave standarte të punës për rendin dhe sigurinë publike, dhe Urdhërit Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".

Pas kqyrjes së regjistrit të personave të shoqëruar nr.54, datë 22.09.2009 rezultoi që;
- Ishte i përshtatur dhe jo në përputhje me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja Model nr 2).

Kqyrja e dhomave të shoqërimit;

Në këtë komisarariat ekzistonte një dhomë shoqërimi, e cila përdorej për shoqërimin e personave të rritur meshkuj. *Nuk kishte ambjent të posaçëm (dhomë) për shoqërimin e personave të mitur dhe femra, në kundërshtim me pikën 2, shkronja b e kreut V "Trajtimi i personave të shoqëruar"*

Kushtet e dhomave të shoqërimit;

Për një trajtim dinjitoz e njerëzor mjediset ku mbahen këta persona duhet të plotësojnë disa kushte, *siç përcaktojnë procedurat standarte të punës, kreu V, shkronja B.*

Gjate kqyrjes rezultoi që;

- Kjo dhomë ndodheshin brenda komisarariatit të policisë Pukë
- Kjo dhoma nuk kishin sipërfaqe të mjaftueshme
- Nuk kishin të gjitha orenditë e nevojshme për specialistët e policisë dhe personat e shoqëruar, mungonin karriget dhe tavolinat.
- Ndriçimi ishte artificial me një llampë elektrike të vendosur ne mur
- Ndriçimi natyral ishte i kufizuar për shkak të përmasave të vogla të dritareve.
- Të pa lyera
- Tualetet jashtë standartit.

Në mur mungonin të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar në gjuhën angleze dhe italiane në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", pika 11.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

KONKLUZIONE

1. Shumë punonjës të kësaj strukture nuk kishin njohuri të mjaftueshme dhe nuk zbatonin Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.
2. Rregjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave në të gjithë Drejtorinë e Policisë Qarkut Shkodër, nuk ishin të unifikuar dhe në përputhje me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.
3. Pasqyrimi i të dhënave në regjistrat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave nuk bëhej në përputhje me nenin 103 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe Urdhrin Nr. 506, datë 06.05.2010 " Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
4. Kushtet në dhomat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave nuk ishin në përputhje me Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe me Manualin Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010.
5. Trajtimi me ushqim i personave të shoqëruar nuk është parashikuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor që rregullon veprimtarinë për këto kategori personash. Trajtimi me ushqim dhe infrastruktura e gatimit të ushqimit i personave të ndaluar dhe arrestuar nuk ishte në përputhje me standartet.
6. Nuk kishte një akt të miratuar për dërgimin e personave të ndaluar dhe arrestuar, në Komisaritin e Policisë Shkodër, në shkelje të plotë të procedurës.

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT, VLORË

Drejtoria e Policisë Qarkut Vlorë është e strukturuar në 3 komisariate,

Komisariati i Policisë Vlorë

Komisariati i Policisë Sarandë

Komisariati i Policisë Delvinë

Nga strukturat e DPQ, Vlorë, Komisariti i Policisë Vlorë, dhe Komisariti i Policisë Sarandë, kanë ambiente shoqërimi dhe dhoma sigurie, ndërsa Komisariti i Policisë Delvinë, ka vetëm ambiente shoqërimi.

Komisariati i Policisë Vlorë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Për personat e ndaluar apo arrestuar

Në këtë komisariat gjenden 3 dhoma sigurie⁹³ por aktualisht në funksionim janë vetëm dy prej tyre, të cilat përdoren për tre kategoritë (meshkuj, femra, të mitur).

Dhomat nuk ishin të kategorizuara.

Në momentin e inspektimit në këto dhoma ndodheshin 2 persona të ndaluar, njëri prej të cilëve i mitur.

Infrastruktura

Nga verifikimi dhe kqyrja e dhomave të sigurisë, rezulton se kushtet dhe parametrat e tyre, nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në "Procedurat Standarte të Punës për Departamentin e Sigurisë Publike" dhe "Manualin për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar, respektivisht me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH, dhe konkretisht :

- Nuk kishin sipërfaqen (hapësirën) e duhur -10m².
- Nuk kishin paradhomë.
- Nuk kishte ndriçim natyral të mjaftueshëm.
- Kushtet e jetesës në ambientin e qëndrimit ishin nën standardet minimum, kishte lagështi në mure, ajri ishte i rënduar, batanijet ishin të papastra.
- Nuk kishte shtretër dhe mjete ngrohës
- Muret ishin të papastra, me shkrime e zhgarravina në to.
- Kushtet higjeno-sanitare nuk plotësonin normat minimale.
- Nuk kishte dhomë të veçantë takimi me avokatët për personat e ndaluar apo arrestuar, i cili kryhej në korridor.
- Nuk kishte ambient për mbajtjen e sendeve personale të të ndaluarve apo arrestuarve.
- Nuk kishte ambient për mbajtjen e dokumentacionit të dhomave të sigurisë.
- Nuk kishte fikse zjarri.

Kushtet higjeno-sanitare nuk plotësonin kushtet minimale, pasi tualeti ishte kolektiv dhe nuk kishte nyje të posaçme për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH.

Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht kushteve të këqija të këtyre dhomave, nga punonjësit e kësaj strukture bëhej një punë e mirë për mirëmbajtjen e tyre.

Kushtet e trajtimit

Të ndaluarit/arrestuarit nuk trajtoheshin me ushqim nga struktura policore, gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 Kreu III, pika I/10, të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH, ku thuhet se: "Të ndaluarit/arrestuarit kanë të drejtë të trajtohen me ushqim 3 herë në ditë".

⁹³ Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave.SH.B



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Lidhur me këtë fakt, përgjegjësi i dhomave të sigurisë u shpreh se të ndaluarit/arrestuarit⁹⁴ trajtoheshin me ushqim nga familjarët e tyre.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit që mbahej në dhomat e sigurisë⁹⁵ rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Nuk ishin të shënuara datat (data e lirimit, transferimit) për personat që transferoheshin në burgje, por vetëm për personat që lirohen.
- b) Libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit dhe evidentimit të kontrolleve në dhomat e sigurisë dhe lënies të detyrave.
 - Plotësuar në mënyrë korrekte dhe sistematike
- c) Regjistri i Sendeve Personale të të ndaluar/arrestuar
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin (i adaptuar)
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat pavarësisht pasjes ose jo të sendeve personale
- d) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë,
 - Nuk ishin regjistruar të gjithë personat.
- e) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët dhe Avokatët,
 - Nuk ishte plotësuar në mënyrë korrekte, pasi në disa raste nuk shënohej ora e hyrjes dhe e daljes.
- f) Lista e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë u gjet e rregullt por nuk ishte e afishuar.

Të gjithë regjistrat e mësipërm nuk ishin protokolluar sipas rregullave pasi nuk shënohej data, por vetëm viti i protokollimit.

Nga verifikimi i kryer rezulton se njëri prej të ndaluarve ndodhej në dhomat e sigurisë që më datë 17.03.2011 dhe vazhdonte të qëndronte deri më datën 05.04.2011, pasi akoma nuk ishin kryer procedurat e transferimit nga DPB, gjë e cila bie në kundërshtim me Kreun II/VIII pika 1 të Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 të DPPSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit (fashikujve) të personave të ndaluar/arrestuar rezulton se ai mbahej në rregull. Në fashikull krahas dokumenteve të tjerë gjendej edhe formulari i identifikimit me dy fotografi.

Grupi i inspektimit vëren se mbajtja e formularit normohet me dy akte nënligjore që përcaktojnë rregullat dhe procedurat në lidhje me personat e ndaluar apo arrestuar, por midis këtyre akteve ka kontradiktë sa i përket numrit dhe tipit të fotografive në formularin e identifikimit, dhe konkretisht:

- Në Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 Kreu IV/B, pika 5/d, përcaktohet se në formular duhet të jenë 3 fotografi (profil në të dy anët dhe pamja ballore-bust)

- Ndërsa në urdhrin nr.64, datë 25.01.2010, Kreu II/V, pika 1 përcaktohet se në këtë formular duhet të jenë 2 fotografi.

⁹⁴ Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" SH.B

⁹⁵ Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" SH.B



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport “Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European”.

Për shoqërimin e personave

Në këtë komisariat ishin në funksionim 2 dhoma për shoqërimin e personave për tre kategoritë - meshkuj, femra, dhe të mitur, por dhomat ishin të pa kategorizuara.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Infrastruktura

Nga kqyrja në vend e dhomave të shoqërimit rezultoi se:

Dhomat e shoqërimit⁹⁶ të personave kishin hapësirë të mjaftueshme, ajrim normal dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Përgjithësisht paisja me orendi e këtyre dhomave ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009.

Konstatohet se, njëra nga dhomat nuk ishte e paisur me orendi (tavolinë, stola etj).

Kushtet higjeno sanitare plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH “Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike”.

Dokumentacioni

Në vijim, u verifikua dokumentacioni⁹⁷ lidhur me personat e shoqëruar që ndodhej në zyrën e informacionit të Kom. Policisë Vlorë.

Nga kqyrja e regjistrit i cili, në mënyrën sesi janë plotësuar rubrikat rezultoi se;

- Formati nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
- Nuk pasqyrohej qartë arsyeja e shoqërimit
- Regjistri ishte i plotësuar me numra rendor por për çdo datë fillonte nga numri një.
- Kishte hapësira boshe nga njëra datë në tjetrën duke lënë një shkak evident për abuzim.

Në disa raste në rubrikën “arsyeja e shoqërimit”, nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftohej vetëm me fjalën “verifikim”, gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2), të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Formulari “SH”(formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, në përputhje me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 “Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike”

⁹⁶ Proc-Verb “Përmbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit” G.P.

⁹⁷ Proc-Verb “Përmbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit” G.P



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport “Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian”.

Konstatohet se Fomulari “Sh” pas kryerjes së procedurave nuk arshivohej në sekretari, por mbahej në zyrën e Shefit të Seksionit të Rendit, gjë që bie në kundërshtim me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009.

Në lidhje me këtë fakt specialisti i informacionit, **Gëzim POLLOGATI**⁹⁸u shpreh se kjo procedurë ndiqet për shkak të një praktike të mëparshme pune.

Komisariati i Policisë Sarandë

Për personat e ndaluar apo arrestuar

Në Komisaratin e Policisë, Sarandë ka 1 dhomë sigurie⁹⁹.

Në momentin e inspektimit në dhomën e sigurisë ndodhej një person i ndaluar¹⁰⁰.

Infrastruktura

Infrastruktura e dhomës së sigurisë nuk plotësonte parametrat e sigurisë dhe të trajtimit human të personave të ndaluar apo arrestuar në përputhje me me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 “Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike”

Nga kqyrja në vend e kësaj dhome rezulton se:

- Nuk kishte sipërfaqen (hapësirën) e duhur -10m².
- Nuk kishin paradhomë.
- Nuk kishte ndriçim natyral të mjaftueshëm.
- Kushtet e jetesës në ambientin e qëndrimit ishin nën standardet minimum, Ajri ishte i rënduar, batanijet ishin të papastra.
- Muret ishin të papastra, me shkrime e zhgarravina në to.
- Kushtet higjeno-sanitare nuk plotësonin normat minimale.
- Nuk kishte ambient për mbajtjen e sendeve personale të të ndaluarve apo arrestuarve.
- Nuk kishte ngrohës kalorifer
- Nuk kishte fikëse zjarri.

Në këtë komisarariat nuk kishte mjek, dhe veprimet në lidhje me vizitat mjekësore për personat e ndaluar apo arrestuar kryheshin në Spitalin Rajonal, Sarandë.

Kushtet higjeno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv dhe nuk kishte nyje të posaçme për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009.

Kushtet e trajtimit

⁹⁸ Proc-Verb “Përmbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit” G.P

⁹⁹ Proc-Verb “Përmbledhjen e të dhënave.E.K

¹⁰⁰ Proc-Verb Intervistimi D.F



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Në lidhje me trajtimin u intervistua personi D.F¹⁰¹ i cili ishte ndaluar më datë 29.03.2011 dhe ishte në pritje të marrjes së masës së sigurisë nga gjykata.

I ndaluari u pyet në lidhje me trajtimin nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të ndalimit, kushtet e jetesës dhe trajtimin ushqimor dhe shëndetësor.

Gjatë intervistimit i ndaluari nuk paraqiti ankesë në lidhje me trajtimin nga punonjësit e policisë të komisariatit apo trajtimin ushqimor dhe ambientin ku ndodhej.

Trajtimi ushqimor për të ndaluarit/arrestuarit bëhej nga struktura përkatëse e policisë. Trajtimi ushqimor ishte parashikuar si zë me vete "për shërbime me ushqim", në buxhetin e komisariatit, dhe ishte lidhur marrëveshja përkatëse me mención e IEVP, Sarandë.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit ¹⁰² të dhomave të sigurisë, rezulton se ai nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike", ku, në kreun IV/B pika 3, përcaktohen qartë dokumentat që duhet të plotësohen dhe administrohen në dhomat e sigurisë, dhe konkretisht:

Dokumentacioni i dhomës së sigurisë përbëhej vetëm nga një regjistër "Regjistri i personave të ndaluar apo arrestuar".

Nga kqyrja e këtij regjistri vërehen këto mangësi;

- Format i regjistrit nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarte të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2) të DPPSH.
- Kishte përdorim të kodeve policore në rubrikën: "Personi kush e bëri ndalimin", në një kohë që në këtë rubrikë duhet shënuar emri dhe mbiemri i punonjësit të policisë.

Nuk kishte përgjigjës të dhomave të sigurisë dhe mbajtja e dokumentacionit bëhej nga K/insp. Engjell KREKU (specialist i zyrës së informacionit)¹⁰³.

Për shoqërimin e personave

Komisariati i Policisë Sarandë kishte 1 dhomë për shoqërimin e personave për tre kategoritë (meshkuj, femra, dhe të mitur)¹⁰⁴.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

¹⁰¹P.Verbal Intervistimi, personai D.F

¹⁰² Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" E.K

¹⁰³ Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" E.K

¹⁰⁴ Proc-Verb Intervistimi V.B



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Infrastruktura

Infrastruktura e dhomave të shoqërimit nuk plotësonte parametrat në përputhje me me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike".

Nga verifikimi në vend i dhomës së shoqërimit rezultoi se:

- Nuk siguronte ajrim normal
- Nuk kishte ndriçim natyral të mjaftueshëm
- Nuk ishte e paisur me orendi (tavolinë, stola etj).
- Nuk kishte dhomë intervistimi për personat e shoqëruar.
- Muret ishin të papastra, me shkrime e zhgarravina në to.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit¹⁰⁵ rezultoi se;

- Format i nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 të DPPSH.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Komisariati i Policisë Delvinë

Komisariati i Policisë Delvinë kishte ambiente vetëm për shoqërimin e personave (3 dhoma) të cilat përdoreshin për tre kategoritë (femra, meshkuj dhe të mitur).

Në këtë komisarikat nuk kishte dhoma sigurie.

Të ndaluarit apo të arrestuarit, dërgoheshin në Komisarikat e Policisë, Sarandë.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Për shoqërimin e personave:

Infrastruktura

Dhomat e shoqërimit nuk plotësonin kushtet që përcaktohen në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike".

Nga verifikimi në vend i dhomës së shoqërimit rezultoi se:

- Nuk siguronte ajrim normal
- Nuk kishte ndriçim natyral të mjaftueshëm
- Nuk ishte e pajisur me orendi (tavolinë, stola etj).
- Nuk kishte dhomë intervistimi për personat e shoqëruar.
- Muret ishin të papastra, me shkrime e zhgarravina në to.

¹⁰⁵Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" E.K



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, pasi kishte vetëm një tualet i cili ishte i papastër, i palyer.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit¹⁰⁶ rezultoi se:

- Formati i regjistrat nuk ishte në përputhje me Procedurat Standarde të Punës dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2) të DPPSH.
- Kishte përdorim të kodeve policore në rubrikat: "Punonjësi i policisë që ka bërë shoqërimin" dhe "Kush e mori në dorëzim dhe e ndoqi problemin", në një kohë që në këtë rubrikë duhet shënuar emri dhe mbiemri i punonjësit të policisë.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

KONKLUZIONE

1. Nuk ishte bërë kategorizimi i dhomave (të Shoqërimit, të Ndalim/ Arrestimit) në Kom Pol, Vlorë dhe Kom.Pol.Sarandë për të tre kategoritë, meshkuj, femra dhe të mitur, në bazë të karakteristikave për secilën kategori personash, siç parashikohet në Kreun VI/ A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009.
2. Regjistrat e personave të shoqëruar nuk ishin në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike" dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010
3. Ambientet e dhomave të sigurisë në Komisariatit e Policisë Vlorë dhe Sarandë nuk përmbushnin asnjë nga kushtet dhe kriteret të parashikuar në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 64, datë 25.01.2010 të DPPSH.
4. Ambientet e shoqërimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë nuk përmbushnin kushtet e parashikuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH
5. Dhomat e sigurisë në Kom.Pol.Vlorë dhe Sarandë dhe ambientet e shoqërimit në Kom.Pol.Sarandë dhe Delvinë, nuk plotësojnë kushtet higjieno - sanitare sipas urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike.

¹⁰⁶ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave" B.I



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

6. Nuk kishte ambiente pune për punonjësit e policisë që shërbejnë në dhomat e sigurisë, si dhe ambient për mbajtjen e sendeve të personave të ndaluar.
7. Nuk kishte dhomë për takimin e avokatëve me personat e ndaluar.
8. Në Kom.Pol. Vlorë personat e ndaluar/arrestuar nuk trajtoheshin me ushqim nga ana e kësaj strukture, kjo, në kundërshtim me Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 Kreu III, pika I/10, të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.
9. Në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar të Kom.Pol. Vlorës nuk ishte plotësuar data e daljes për të gjithë personat nga dhomat e sigurisë.
10. Në Komisariatit e Policisë Sarandë mungonte dokumentacioni i dhomave të sigurisë.
11. Mënyra e plotësimit dhe administrimit të formularëve të shoqërimit në D.P.Q. Fier nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".
12. Nuk kishte përgjegjës të dhomave të sigurisë në Komisariatit e Policisë Sarandë

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT, GJIROKASTËR

Drejtoria e Policisë Qarkut Gjirokastrë është e strukturuar në 3 komisariate,

Komisariati i Policisë Gjirokastrë

Komisariati i Policisë Tepelenë

Komisariati i Policisë Përmet

Nga strukturat e DPQ Gjirokastrë, Komisarati i Policisë Gjirokastrë, ka ambiente shoqërimi dhe dhoma sigurie, ndërsa Komisarati i Policisë Tepelenë dhe Përmet kanë vetëm ambiente shoqërimi.

Komisariati i Policisë Gjirokastrë

Për personat e ndaluar apo arrestuar.

Në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë ka 8 dhoma sigurie të cilat përdoren për tre kategoritë e personave të ndaluar apo arrestuar (meshkuj, femra dhe te mitur), *por ato nuk ishin të kategorizuara.*



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Në momentin e inspektimit në këto ambiente kishte 4 persona të ndaluar¹⁰⁷.

Infrastruktura

Dhomat e sigurisë përdoreshin për tre kategoritë e personave të ndaluar apo arrestuar (meshkuj, femra, të mitur),.

Nga verifikimi në vend i dhomave të sigurisë rezulton se:

- Ambientet e dhomave të sigurisë ishin të reja, me sipërfaqe të mjaftueshme (ambient qëndrimi, paradhomë), të paisura me tualet, shtretër, ngrohje qendrore dhe mbaheshin pastër.

Megjithatë konstatohen disa mangësi si:

- Dhomat nuk ishin të kategorizuara (meshkuj, femra, të mitur).
- Pranë çdo dhome në korridor nuk kishte të vendosura dy fiksa zjarri me ujë ku do të përdoren vetëm për këtë qëllim nga punonjësi i policisë por kishte vetëm sistem qëndror automatik MKZ (mbrojtje kundra zjarrit).
- Çelësi i ndriçimit të dhomave ndodhej brenda në paradhomë.
- Dhoma ku sipas tyre përdorej për femra ishte me një çelës ku për mbajtjen e të ndaluarve apo arrestuarve femra dhomat sigurohen me dy brava apo dryna, çelësat e të cilave mbahen nga dy punonjës policie (njëri të jetë femër).
- Mungesa e një butoni zileje apo sinjali tek dhomat me qëllim që të dëgjohet nga punonjësi i shërbimit sa herë që përdoret nga i arrestuari/ndaluari kur ka nevojë për ndihmë.
- Ndarja e ambientin e qëndrimit (dhoma) dhe në paradhomë ishte bërë nëpërmjet një zgare me shufra hekuri, të cilat ishin vendosur në pozicionin vertikal dhe horizontal, në një kohë që nuk duhet të ketë shufra hekuri horizontale, ashtu siç përcaktohet në Kreun V/II, pika 1/d të Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 "Manualin për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore" të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.

Kushtet e trajtimit

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim nga struktura përkatëse e policisë. Trajtimi ushqimor ishte parashikuar si zë më vete në buxhetin e Komisarariatit.

Në lidhje me trajtimin u intervistua personi i ndaluar A.V¹⁰⁸ madhor, i cili ishte në pritje të caktimit të masës së sigurisë nga gjykata.

Gjatë intervistimit i ndaluari nuk paraqiti ankesë në lidhje me trajtimin nga punonjësit e policisë të komisarariatit apo trajtimin ushqimor dhe ambientin ku ndodhej.

Dokumentacioni

¹⁰⁷Proc-Verb Intervistimi me të ndaluarin A.V

¹⁰⁸P.Verbal Intervistimi, personi A.V



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Nga verifikimi i dokumentacionit¹⁰⁹ që mbahej për personat e ndaluar/arrestuar rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Ishte plotësuar dhe mbajtur në rregull
 - Kishte persona të mbajtur mbi një javë në dhomat e sigurisë, në pritje të transferimit të tyre në IEVP.
- b) Libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit
 - I adaptuar dhe jashtë standarteve
 - Ishte plotësuar në mënyrë korrekte dhe sistematike.
- c) Regjistri i sendeve personale
 - I adaptuar dhe jashtë standarteve
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat pavarësisht pasjes ose mospasjes së sendeve personale.
- d) Libri i vizitave mjekësore në Dhomat e Sigurisë
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat e ndaluar/ arrestuar.
- e) Regjistri i marrjes në pyetje nga prokurorët, ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- f) Regjistri i takimit me avokatët, ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- g) Dosja me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP, u gjet e rregullt.
- h) Lista e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë, u gjet e rregullt.

Nga verifikimi i dokumentacionit (fashikujve) për 4 personat e ndaluar rezultoi se 2 prej tyre ishin përfunduar ndërsa 2 të tjerët ishin duke u plotësuar dhe ishin në përputhje me "Procedurat Standarte të Punës së Policisë së Shtetit" si dhe këto persona u gjetën të regjistruar në të gjithë dokumentacionin e dhomave të sigurisë.

Për shoqërimin e personave:

Në Komisariatit e Policisë Gjrokastrë ka një dhomë shoqërimi për tre kategoritë e personave (meshkuj, femra, dhe të mitur).

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Infrastruktura

Ambienti për personat e shoqëruar nuk plotësonte kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".

Nga verifikimi në vend i dhomës së shoqërimit rezultoi se:

- Nuk kishte dhomë intervistimi për personat e shoqëruar
- Nuk ishte e paisur me orëndi (tavolinë, stola etj).

Nga verifikimet e bëra rezulton se në ambientet e shoqërimit të Kom.Pol.Gjrokastrë, për shkak të ngarkesës dhe dinamikës së punës (situata problematike e kultivimit të lëndëve narkotike dhe aktiviteti në PKKK), në momente të caktuara, shoqërohen një numër i konsiderueshëm personash.

¹⁰⁹Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" N.K



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Grupi i inspektimit konstaton se ekzistenca e një dhomë shoqërimi nuk përballon fluksin e të shoqëruarve dhe detyron strukturën policore, t'i akomodojë në ambiente të tjera të papërshtatshme.

Ambienti për personat e shoqëruar nuk plotësonte kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit¹¹⁰ lidhur me personat e shoqëruar i cili ndodhej në Zyrën e informacionit, rezultoi se:

Nga kqyrja e regjistrit rezultoi se:

- Formati nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" (Lidhja nr.2) dhe Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, pasi mungonin rubrikat "pamje e jashtme e personit të shoqëruar dhe shenja të veçanta", "vendi dhe zyra ku është shoqëruar".
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftohej vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506.

Formulari "SH" (formulari i shoqërimit), mbaheshin nga punonjësit që kryenin shoqërimin dhe në momentin e inspektimit mënyra e administrimit të tyre nuk ishte në përputhje me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike", ku parashikohet: *"Në rastet kur punonjësi i policisë i strukturës respektive gjykon se me personin e shoqëruar nuk do të kryhen veprime të tjera, bën plotësimet përkatëse në formularin model "SH" duke vepruar si më poshtë :*

- *"Nëse për personin e shoqëruar ekziston një praktikë e mëparshme, një kopje të formularit ja bashkëngjit kësaj praktike, kurse kopjen tjetër e dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore.*
- *Nëse për personin e shoqëruar nuk ekziston praktikë e mëparshme, të dy kopjet e formularit i dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore".*

Komisariati i Policisë Tepelenë

Në këtë komisarjat nuk ka dhoma sigurie. Të ndaluar apo arrestuar dërgoheshin në Komisarjatin e Policisë, Gjirokastrë.

Në Komisarjatin e Policisë Tepelenë ka një dhomë shoqërimi ¹¹¹ (ndërtesë më vete) për tre kategoritë e personave (meshkuj, femra, dhe të mitur).

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Për shoqërimin e personave:

¹¹⁰ Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" H.C

¹¹¹ Proc-Verb "Intervistimi. GJ.SH



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Infrastruktura

Dhoma për shoqërimin e personave kishte hapësirë dhe ajrim normal, si dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm por:

Ambienti për personat e shoqëruar nuk plotësonte kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".

Disa nga këto mangësi të saj ishin:

- Kishte vetëm një dhomë, ku vendoseshin të tre kategoritë e personave - meshkuj, femra dhe të mitur.
- Nuk kishte dhomë intervistimi për personat e shoqëruar
- Nuk ishte e paisur me orendi (tavolinë, stola etj).
- Kushtet higjieno sanitare nuk ishin normale, kishte mure të dëmtuara me suvatime të rëna.
- Brenda në këtë dhomë kishte kablllo energjie të çveshur.
- Tualeti që përdorej për personat e shoqëruar ishte jashtë kësaj.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit që ndodhej në zyrën e informacionit¹¹² dhe nga kqyrja e regjistrit rezultoi se:

- Format i nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 të DPPSH.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- Në rubrikën "Punonjësi i policisë që punoi për zgjidhjen e çështjes" ishin përdorur kode policore në një kohë që kërkohet emër mbiemër i punonjësit përkatës.
- Formulari i shoqërimit nuk mbahej.
- Në regjistrin e personave të shoqëruar shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat.

Komisariati i Policisë Përmet

Komisariati i Policisë Përmet ka dy dhoma shoqërimi në një ndërtesë më vete jashtë godinës së komisaritit.

Në këtë komisariat nuk kishte dhoma sigurie.

¹¹²Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" Xh. S



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Personat e ndaluar apo arrestuar dërgoheshin në Komisaratin e Policisë, Gjirokastër¹¹³.

Në momentin e inspektimit nuk u gjet asnjë person i shoqëruar.

Për shoqërimin e personave:

Infrastruktura

Ambienti për personat e shoqëruar nuk plotësonte kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike" dhe konkretisht:

- Nuk kishte dhomë intervistimi për personat e shoqëruar
- Nuk ishte e paisur me orendi (tavinë, stola etj).
- Tualeti që përdorej për personat e shoqëruar ishte jashtë kësaj ndërtese.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit që ndodhej në zyrën e informacionit¹¹⁴ dhe nga kqyrja e regjistrit rezultoi se:

- Formati nuk ishte në përputhje me me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (lidhja nr.2) "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit" pasi mungonin disa rubrika.
- Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftohej vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506.
- Në regjistrin e personave të shoqëruar shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisaratin dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisaratin.
- Formulari i shoqërimit nuk mbahej.

KONKLUZIONE

1. Nuk ishte bërë kategorizimi i dhomave të ndalim/arrestimit në Kom.Pol. Gjirokastër për të tre kategoritë, meshkuj, femra dhe të mitur, në bazë të karakteristikave për secilën kategori personash, siç parashikohet në Kreun VI/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009
2. Ambientet e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë Gjirokastër nuk plotësonin të gjitha kushtet dhe kriteret të parashikuar në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave

¹¹³Proc-Verb Intervistimi I.S

¹¹⁴Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" B.Z



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian",

Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike" dhe Urdhër nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore.

3. Ambientet e shoqërimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut nuk përmbushnin kushtet dhe kriteret për dhomat e sigurisë të parashikuar në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike".
4. Nuk plotësonte kushtet higjieno - sanitare, ambienti i shoqërimit në Kom.Pol.Tepelenë dhe Përmet, sipas urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike.
5. Mënyra e plotësimit dhe administrimit të formularëve të shoqërimit në D.P.Q. Fier nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike.
6. Regjistrat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nuk ishin në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike" dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", ku pjesa më e madhe e tyre ishin të përshtatur nga vetë punonjësit.

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT, FIER

Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier është e strukturuar në 3 komisariate:

Komisariati i Policisë Fier

Komisariati i Policisë Lushnjë

Komisariati i Policisë Mallakastër

Grupi i inspektimit mori kontakt me Drejtorin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Fier, Drejtues **Mërgim HOXHA**, i cili bëri prezent kushtet aktuale të dhomave të sigurisë, trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar, si dhe problemet që dalin gjatë dinamikës së përditshme të punës.

Nga strukturat e DPQ, Fier, Komisariati i Policisë Fie dhe Komisariati i Policisë Lushnje, kanë ambiente shoqërimi dhe dhoma sigurie, ndërsa Komisariati i Policisë Mallakstër, ka vetëm ambiente shoqërimi.

Komisariati i Policisë Fier.

Për personat e ndaluar apo arrestuar



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Në këtë strukturë kishte 6 dhoma sigurie për personat e ndaluar apo arrestuar, të cilat përdoreshin për të tre kategoritë e personave (meshkuj, femra dhe te mitur), por nuk ishin të kategorizuara.

Në momentin e inspektimit në këto ambiente kishte një person të ndaluar.

Infrastruktura

Nga inspektimi i kryer në dhomat e sigurisë rezultoi që secila prej tyre kishte hapësirë dhe ajrim normal, ndriçim natyral të mjaftueshëm, si dhe pajisjet e duhura sipas kërkesave të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009.

Konstatohen këto mangësi:

- Dy dhoma kishin nga dy shtretër, ku përgjithësisht ndërtohen dhe funksionojnë për çdo person të ndarë më vete.

Kishte sistem qëndror automatik MKZ (mbrojtje kundra zjarrit), por ky sistem nuk ishte në përputhje me Kreun IV/A, pika 5/c të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, ku parashikohet se pranë çdo dhome në korridor të jenë të vendosura dy fiksa zjarri me ujë dhe do të përdoren vetëm për këtë qëllim nga punonjësi i policisë. Kushtet higjieno-sanitare në përgjithësi plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, në Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhërin nr.64, datë 25.01.2010 të DPPSH, por duhet theksuar se si nyje për larjen e trupit, përdorej paradhoma e njëres prej dhomave të sigurisë.

Kushtet e trajtimit

Në lidhje me trajtimin u intervistua i ndaluar E.T¹¹⁵ madhorë, i cili ishte në pritje të caktimit të masës së sigurimit nga gjykata. I ndaluar u pyet në lidhje me trajtimin nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të ndalimit, kushtet e jetesës dhe trajtimin ushqimor dhe shëndetësor.

Gjatë intervistimit i ndaluarit nuk paraqiti ankesa në lidhje me trajtimin nga punonjësit e policisë.

I ndaluar trajtohej me ushqim nga struktura përkatëse e policisë.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit që mbahej në dhomat e sigurisë¹¹⁶ rezultoi se:

- a) Regjistëri i personave të ndaluar/arrestuar
 - Ishte mbajtur në rregull
 - Kishte persona të mbajtur më shumë se një javë në këtë ambient ku ishte dhënë dhe vendimi për to, por pritej konfirmimi i pranimi të tyre nga burgjet pasi këto të fundit nuk kishin vënde.

¹¹⁵P.Verbal Intervistimi, personai E.T

¹¹⁶ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave" B.S



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- b) Libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit dhe evidentimit të kontrolleve në dhomat e sigurisë dhe lënies të detyrave ishte plotësuar në mënyrë korrekte dhe sistematike.
- c) Regjistri i sendeve personale për ndaluarit/rrestuarit (Libër i vjetër, i përshtatur), përgjithësisht ishte plotësuar në mënyrë korrekte, por duhet theksuar që nuk ishin pasqyruar të gjithë personat pavarësisht pasjes ose mospasjes së sendeve personale
- d) Regjistri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, (i adaptuar) nuk ishin pasqyruar qartë personat pasi kishte persona të regjistruar disa herë ku sipas tij regjistroheshin sa herë vizitoheshin dhe ishte e pamundur që të shihej nëse ishin vizituar të gjithë personat.
- e) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët dhe Avokatët (jashtë standarteve dhe i vjetër), përgjithësisht ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- f) Dosje me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP. U gjet e rregullt.
- g) Lista e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit (fashikullit) për personat e ndaluar/arrestuar, rezultoi se ishte plotësuar konform procedurave standarte të punës.

Nga intervistimi që patëm në lidhje me trajtimin e personit të ndaluar (**i ndaluar me datë 01.04.2011**), i ndaluari u shpreh gjatë intervistimit, *se ishte vizituar nga mjeku me datë 04.04.2011 ndërsa në regjistrin e vizitave personi në fjalë ishte regjistruar më datë 02.04.2011*.

Grupi i inspektimit, pa dashur të hetojë nëse të ndaluarit janë kontrolluar apo vizituar nga mjeku, kjo edhe për shkak se ata nuk kishin ankesa, tërheq vëmendjen që vizita mjekësore të mos neglizhohet dhe të kryhet që në momentin e parë të ndalimit apo arrestimit të personit, siç parashikohet në Procedurat Standarte të Punës së Departamentit të Sigurisë Publike", Kap IV/C/1, miratuar me Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.

Për shoqërimin e personave.

Në DPQ, Fier ka 4 dhoma për shoqërimin e personave të cilat përdoren për tre kategoritë - meshkuj, femra, dhe të mitur, (të pa kategorizuara).

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Infrastruktura

Nga inspektimi i kryer, rezulton se Dhomat e Shoqërimit të Personave në përgjithësi ishin në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009¹¹⁷.

Ambientet ishin të reja, kishin ajrim normal dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm. Kushtet higjeno sanitare plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të

¹¹⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave"



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike

Konstatohen këto mangësi:

- Dhomat ishin të paisura me kolltuqe për personat e shoqëruar, por ishin të amortizuara.
- Dritarja e njëjës prej dhomave të shoqërimit ishte me xhama të thyer.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në Zyrën e Informacionit¹¹⁸ në lidhje me personat e shoqëruar, rezultoi se:

- Format i regjistrit ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
- Nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftohej vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr. 506, datë 06.05.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- Formulari "SH" (formulari i shoqërimit), plotësohej nga punonjësi që kryente shoqërimin dhe punonjësi i informacionit, por ai mbahej në një kopje, e cila administrohej nga OPGJ-të, gjë që bie në kundërshtim me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike" ku parashikohet: "Në rastet kur punonjësi i policisë i strukturës respektive gjykon se me personin e shoqëruar nuk do të kryhen veprime të tjera, bën plotësimet përkatëse në formularin model "SH" duke vepruar si më poshtë:
 - "Nëse për personin e shoqëruar ekziston një praktikë e mëparshme, një kopje të formularit ja bashkëngjit kësaj praktike, kurse kopjen tjetër e dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore.
 - Nëse për personin e shoqëruar nuk ekziston praktikë e mëparshme, të dy kopjet e formularit i dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore".

- Regjistri nuk ishte i plotësuar me numra rendor,
- Lënia e hapësira bosh në regjistrin për personat e shoqëruar.

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në

këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisariat.

Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

¹¹⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave"



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar
apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të
Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".
Komisariati i Policisë Lushnjë

Për personat e ndaluar apo arrestuar

Në këtë komisarikat ishin në funksionim 5 dhoma sigurie.

Në momentin e inspektimit në këto dhoma gjendeshin 4 persona të ndaluar/arrestuar.

Infrastruktura

Dhomat e sigurisë gjendeshin nën tokë (në bodrum), dhe përdoreshin për të tre kategoritë (meshkuj, femra, të mitur), por ishin të pa kategorizuara.

Në ambientet e dhomave të sigurisë së Kom.Pol.Lushnjë, që prej nëntorit 2009 vendoseshin edhe personat e ndaluar/arrestuar nga DPQ, Berat.

Për këtë arsye, ashtu siç konfirmon edhe përgjegjësi i dhomave të sigurisë, herë pas here dhomat e sigurisë mbipopullohen.

Nga verifikimi dhe kqyrja e dhomave të sigurisë, rezulton se kushtet dhe parametrat e tyre, nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 kap IV/A, dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.

Nga kqyrja¹¹⁹ e dhomave të ndalimit apo arrestimit rezultoi se:

- Nuk kishin hapësirën e duhur (10m²).
- Nuk kishin paradhomë.
- Dyshemeja prej dërrase ishte e prishur.
- Tavani ishte me suva të rënë.
- Nuk kishte ndriçim natyral të mjaftueshëm.
- Kushtet e jetesës në ambientin e qëndrimit ishin nën standardet minimum, kishte lagështi në mure, ajri ishte i rënduar, batanijet ishin të papastra.
- Nuk kishte shtretër dhe mjete ngrohës
- Nuk kishte fikëse zjarri
- Kushtet higjeno-sanitare nuk plotësonin normat minimale.
- Tualeti ishte kolektiv dhe që përbën shkak evident për përhapjen e sëmundjeve infektive. Madje ky ambient përdorej edhe si nyje për larjen e trupit, kushte të cilat nuk janë në përputhje me Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të DPPSH.

Kushtet e trajtimit

Grupi i inspektimit intervistoi një prej të ndaluarve lidhur me trajtimin e tij, nga ana e punonjësve të policisë, që në momentin e parë të ndalimit, si edhe kushtet e jetesës, trajtimin ushqimor dhe shëndetësor.

¹¹⁹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave" A.G



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Gjatë intervistimit i ndaluarit nuk paraqiti ankesë në lidhje me trajtimin nga punonjësit e policisë, kushtet e jetesës apo trajtimin shëndetësor.

Në lidhje me trajtimin ushqimor të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin nga struktura policore.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit që mbahej në dhomat e sigurisë¹²⁰ rezultoi se:

- a) Kishte 2 regjistra për personat e ndaluar dhe arrestuar:
 - regjistër i personave të ndaluar/arrestuar, Lushnjë
 - regjistër i personave të ndaluar/arrestuar(hyrje- dalje),DPQ,Berat

Regjistrat ishin mbajtur dhe plotësuar në rregull.

Nga verifikimi në këto regjistra rezulton se në disa raste persona të ndaluar apo arrestuar ishin mbajtur në këto dhoma për ditë të tëra (mbi një javë) edhe pas caktimit të masës së sigurimit nga gjykata, gjë e cila bie në kundërshtim me Kreun II/VIII pika 1 të Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 të DPPSH.

I pyetur rreth këtij fakti përgjegjësi i dhomave të sigurisë shpjegoi se kjo situatë vjen për shkak të zvarritjeve të procedurave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve.

- b) Libri i marrjes e dorëzimit të shërbimit dhe evidentimit të kontrolleve në dhomat e sigurisë dhe lënies së detyrave -ishte plotësuar në mënyrë korrekte dhe sistematike
- c) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit.
 - Ishte format i vjetër dhe i amortizuar.
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat pavarësisht pasjes ose jo të sendeve personale.
- d) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nuk ishin regjistruar të gjithë personat
- e) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët dhe Avokatët - *ishte plotësuar në mënyrë korrekte.*
- f) Fashikujt e të arrestuarve/ndaluarve ishin mbajtur në rregull.

Për shoqërimin e personave

Në Komisarlatin e Policisë kishte një dhomë shoqërimi.

Në momentin e inspektimit nuk kishte person të shoqëruar.

Infrastruktura

Nga verifikimi në vend i kësaj dhome shoqërimi rezultoi se:

Asnjë parametër i dhomës së shoqërimit të personave nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009, më saktësisht ajo ishte një dhomë ndërtesë më vete, me mure suvatimi të rëna, ndërtesë e vjetër, (jashtë çdo standarti, nuk plotësonte asnjë kriter për personat e shoqëruar).

¹²⁰ Proc-Verb "Përmbledhjen e të dhënave" insp. A.G



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Kushtet higjeno-sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"¹²¹.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit¹²² rezultoi se:

Formati ishte në përputhje me procedurat Standarde dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 por:

Në disa raste në rubrikën "arsyeja e shoqërimit", nuk pasqyrohej arsyeja konkrete e shoqërimit, por mjaftohej vetëm me fjalën "verifikim", gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja Model nr.2), të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Komisariati i Policisë Mallakastër

Ky komisarjat kishte ambiente vetëm për shoqërimin e personave dhe nuk kishte dhoma sigurie.

Personat e ndaluar apo arrestuar dërgoheshin në Komisarjatin e Policisë, Fier.

Për shoqërimin e personave

Në Komisarjatin e Policisë Mallakastër kishte 1 dhomë për shoqërimin e personave. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit të personave kishte hapësirë të mjaftueshme, ndriçim natyral të mjaftueshëm e ajrim normal, në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009.

Nga kqyrja e këtyre dhomave konstatohet se:

- Dhoma kishte 3 kolltuqe dhe një tavolinë, por ato ishin të amortizuara.
- Tualeti ishte jashtë ambienteve të shoqërimit, kushte të cilat nuk janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kreun V/B pika 1 të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit¹²³ rezultoi se:

Formati i regjistrimit ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 por:

¹²¹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave"

¹²² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave" F.H

¹²³ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit", Zyra e Informacionit, Kom.Pol.Fier



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- Nuk ishte plotësuar rubrika (ora e daljes) për të gjithë personat.
- Në këtë libër shënohej data dhe ora e hyrjes në komisariat të personave të shoqëruar dhe jo ora në momentin e shoqërimit.

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua Insp. Fiqiri HOXHALLARI¹²⁴, i cili u shpreh se të shoqëruarit regjistroheshin në regjistrin përkatës, ndërsa formulari i shoqërimit nuk plotësohej.

Kjo mënyrë procedimi me personat e shoqëruar nuk është në përputhje me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike"

KONKLUZIONE

1. Nuk ishte bërë kategorizimi i dhomave (të Shoqërimit, të Ndalim/ Arrestimit) në Kom.Pol. Qarkut për të tre kategoritë, meshkuj, femra dhe të mitur, në bazë të karakteristikave për secilën kategori personash, siç parashikohet në Kreun VI/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009.
2. Ambientet e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë Lushnjë nuk përmbushnin asnjë nga kushtet dhe kriteret të parashikuar në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të Sigurisë Publike" dhe Urdhër nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"
3. Në Komisaratin e Policisë Fier, nyja për larjen e trupit nuk ishte në përputhje me Kreun VI/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike", pasi ishte përshtatur në një dhomë sigurie.
4. Infrastruktura e dhomave të shoqërimit dhe kushtet higjeno-sanitare në Komisaratin e Policisë Lushnjë dhe Mallakastër, nuk ishin në përputhje me kushtet e kriteret e përcaktuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".
5. Nga intervistimi i një personi i cili ishte ndaluar më datë 01.04.2011 u shpreh që ishte vizituar nga mjeku me datë 04.04.2011, ndërsa vizita mjekësore dhe regjistrimi i personit të ndaluar/arrestuar në regjistrin e vizitave mjekësore në dhomat e sigurisë, ishte shënuar me datë 02.04.2011.

¹²⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit", F.Hoxhallari



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

6. Mënyra e plotësimit dhe administrimit të formularëve të shoqërimit në D.P.Q. Fier nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike".
7. Regjistrat e personave të ndaluar apo arrestuar në të gjitha strukturat nuk ishin në përputhje me Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike" dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit", ku pjesa më e madhe e tyre ishin të përshtatur nga vetë punonjësit.

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT, DIBËR

Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër është e strukturuar në 3 Komisariate:

Komisariati Policisë Dibër

Komisariati i Policisë Bulqizë

Komisariati Policisë Burrel

Grupi i inspektimit mori kontakt me Drejtorin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Dibër, Drejtues **Artan HASANAJ**¹²⁵, i cili bëri prezent kushtet aktuale të dhomave të sigurisë, trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar, si dhe problemet që dalin gjatë dinamikës së përditshme të punës.

Komisariatet e DPQ, Dibër kanë ambiente shoqërimi dhe dhoma sigurie, me përjashtim të Komisarariatit të Policisë Bulqizë.

Të ndaluarit apo arrestuarit trajtohen më ushqim nga strukturat përkatëse të policisë.

Ushqimi për personat e ndaluar apo arrestuar gatuhet në kuzhinën e komisariateve përkatëse.

Në lidhje me trajtimin ushqimor të personave të ndaluar apo arrestuar, z.Hasanaj u shpreh se në buxhetin e komisarariatit, për vitin 2011, është parashikuar si zë i veçantë, trajtimi ushqimor në masën 170.000 lek për garantimin e të cilit nuk është lidhur një kontratë shërbimi (catering) me subjekt privat për shkak të mungesës së interesit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Në bazë të Urdhërit nr. 2342, dt. 10.11.2009 të Drejtorit të DPQ, Dibër, është ngritur grupi i punës, i cili ka përcaktuar nevojat për rikonstruksionin e godinës së DPQ Dibër dhe Komisarariatit të Policisë, Dibër duke përfshirë edhe dhomat e sigurisë.

Pavarësisht kërkesave të përsëritura për realizimin e këtij investimi, në buxhetin e vitit 2010 dhe 2011 nuk është parashikuar asnjë fond për investime.

¹²⁵Proc-Verb intervistimi A.Hasanaj



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".
Komisariati i Policisë Dibër

Për personat e ndaluar apo arrestuar:

Në Komisarlatin e Policisë Dibër, ka 14 dhoma dhoma sigurie të cilat përdoren për të tre kategoritë (meshkuj, femra,) të kategorizuara¹²⁶, ndërsa të miturit dërgoheshin në ambientet e DPQ Tiranë.

Në momentin e inspektimit në këto ambiente nuk kishte asnjë person të ndaluar apo arrestuar.

Infrastruktura

Secila prej dhomave të sigurisë kishte përmasa 220 x 140 cm dhe dritare 30 x 60 cm të cilat nuk plotësojnë normat dhe parametrat teknikë (jetësorë dhe të sigurisë) që janë: Sip. e përgjithshme për një person jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), siç parashikohet në kreun V pika II, III dhe IV të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Në dhoma nuk sigurohej ajrim normal dhe ndriçim i mjaftueshëm natyral, si dhe nuk bëhej ajrimi i të ndaluarve apo arrestuarve siç parashikon Kreu IV paragrafi VI i Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"

Po ashtu, kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv, kishte njeje të posaçme për larjen e trupit por nuk plotësonte kushtet ashtu siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike"¹²⁷.

Kushtet e trajtimit

Nga verifikimi i kryer rezulton se:

- Të ndaluarit apo arrestuarit trajtohen me ushqim nga struktura përkatëse e policisë në bazë të numrit të personave në dhomat e sigurisë. Ushqimi gatuhej në kuzhinën e komisarariatit, pasi nuk ka një kontratë shërbimi (catering) me subjekt privat për shkak të mungesës së interesit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Në strukturën organike të DPQ Dibër nuk ka mjek.

Shërbimi shëndetësor për të ndaluarit apo arrestuarit, ofrohej nga Spitali Rajonal, Peshkopi.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacioni në dhomat e sigurisë¹²⁸, rezultoi se:

¹²⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Diber

¹²⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Diber



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarde dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
 - Ishte mbajtur në rregull.
- b) Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit,
 - Ishte plotësuar në mënyrë korrekte dhe mbajtur pastër.
- c) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nuk ishin pasqyruar të gjithë personat pavarësisht pasjes ose mospasjes së sendeve personale.
- d) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë nuk ishin pasqyruar të gjithë personat e ndaluar apo arrestuar.
- e) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- f) Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.
- g) Dosja me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP, u gjet e rregullt.
- h) Fashikuj – nuk kishte persona të nd/arrest.

Gjatë intervistës përgjegjës i dhomave të sigurisë inspektor **Ismail Lala**¹²⁹u shpreh se ambientet e dhomave të sigurisë në Komisariatit e Policisë Diber, ishin ambiente plotësisht të papërshtatshme dhe që kërkonin ndërhyrje të menjëhershme për të ndryshuar kushtet e trajtimit, sigurisë dhe ato higjieno-sanitare.

Për shoqërimin e personave:

Në këtë komisarjat ka një dhomë për shoqërimin e personave e cila përdorej për tre kategoritë (meshkuj, femra, të mitur)¹³⁰.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit të personave nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal si edhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Në këtë dhomë nuk kishte paisje dhe orendi në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009.

Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"¹³¹.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.3 prot, dt. 05.01.2011,

2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.2 prot, dt. 03.01.2011.

3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.3 prot, dt. 03.01.2011.

4. Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.14 prot, dt. 09.03.2011.

5. Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit nr.6 prot, dt. 03.01.2011

¹²⁹P.Verbal Intervistimi I.Lala

¹³⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Diber

¹³¹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Diber



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit¹³² rezultoi se:

Nga kqyrja e regjistrit:

- Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja nr.2).
- Në disa raste në rubrikën arsyeja e shoqërimit nuk pasqyrohej qartë arsyeja e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me termin "verifikim".

Formulari "SH" (formulari i shoqërimit);

- Nuk mbahej në dy kopje,
- Nuk administrohej nga sekretaria.

Kjo mënyrë veprimi është në kundërshtim me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 "Për miratimin e Procedurave Standarte të Departamentit të sigurisë publike" ku parashikohet: "Në rastet kur punonjësi i policisë i strukturës respektive gjykon se me personin e shoqëruar nuk do të kryhen veprime të tjera, bën plotësimet përkatëse në formularin model "SH" duke vepruar si më poshtë:

- "Nëse për personin e shoqëruar ekziston një praktikë e mëparshme, një kopje të formularit ja bashkëngjit kësaj praktike, kurse kopjen tjetër e dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore.
- Nëse për personin e shoqëruar nuk ekziston praktikë e mëparshme, të dy kopjet e formularit i dorëzon në sekretari/arkivin e strukturës së policisë vendore".

Komisariati i Policisë Mat

Për personat e ndaluar apo arrestuar:

Në Komisaratin e Policisë, Mat, ka 12 dhoma sigurie prej të cilave në funksionim janë 11¹³³ për meshkuj e 1 për femra, ndërsa të miturit dërgoheshin në ambientet e DPQ Tiranë.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të ndaluar apo arrestuar.

Infrastruktura

Secila prej dhomave të sigurisë kishte përmasa 230 x 220 cm dhe dritare 30 x 60 cm të cilat nuk plotësojnë normat dhe parametrat teknikë (jetësorë dhe të sigurisë) që janë: Sip. e përgjithshme për një person jo më pak se 10 m² e cila ndahet në ambient

¹³² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Diber / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.10, datë 03.01.2011.

¹³³ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Komisarati Burrel



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

qëndrimi (6 m²) dhe paradhomë (4 m²), siç parashikohet në kreun V pika II, III dhe IV të Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Në dhoma nuk sigurohej ajrim normal dhe ndriçim i mjaftueshëm natyral, si edhe nuk bëhej ajrimi i të ndaluarve apo arrestuarve, sipas Kreut IV paragrafi VI i Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Po ashtu, kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv, kishte nje të posaçme për larjen e trupit, por që nuk plotësonte kushtet ashtu siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike"¹³⁴.

Kushtet e trajtimit

Nga verifikimi i kryer rezulton se:

- Të ndaluarit apo arrestuarit trajtohen me ushqim nga struktura përkatëse e policisë të numrit të personave në dhomat e sigurisë. Ushqimi gatuhej në kuzhinën e komisariatit, pasi nuk ka një kontratë shërbimi (catering) me subjekt privat për shkak të mungesës së interesit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacioni në dhomat e sigurisë¹³⁵, rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
 - Ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- b) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin,
 - Ishte plotësuar në rregull.
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë.
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin,
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat.

¹³⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Dibër

¹³⁵ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Burrel.

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.41 prot, dt. 16.08.2007,
2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.66 prot, dt. 23.09.2010.
3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.61 prot, dt. 16.08.2010.
4. Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.49 prot, dt. 05.01.2011.
5. Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuari nr.41 prot, dt. 31.03.2008
6. Regjistër i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.44 prot, dt.29.05.2008.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit - ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- e) Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit - ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- f) Libër i kontrollit në dhomat e sigurisë ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- g) Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.
- h) Dosja me proces-verbale të dorëzimit të personave në IEVP, u gjet e rregullt.
- i) Fashikuj – nuk kishte persona të nd/arrest.

Për shoqërimin e personave:

Në këtë strukturë ka 1 dhomë për shoqërimin e personave¹³⁶.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

Të miturit transportoheshin në DPQ Tiranë.

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit të personave nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal si edhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Në këtë dhomë nuk kishte paisje dhe orendi në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009.

Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"¹³⁷.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit¹³⁸ rezultoi se:

- Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
- Në disa raste në rubrikën arsyeja e shoqërimit nuk pasqyrohej qartë arsyeja e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me termin "verifikim".
- Kishte korrigjime të shpeshta të cilat e vështirësonin leximin ose e bënin shkrimin të palexueshëm.

Formulari "SH" (formulari i shoqërimit);

- Nuk mbahej në dy kopje,
- Nuk administrohej nga sekretaria .

Në lidhje me formularët e shoqërimit u intervistua inspektor Sulejman Alistafa¹³⁹, i cili u shpreh se formulari i shoqërimit plotësohej nga punonjësi që ka kryer shoqërimin dhe më pas bëhej plotësimi i regjistrit nga punonjësi i zyrës së informacionit.

¹³⁶ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Burrel

¹³⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Burrel

¹³⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Burrel Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.9, datë 16.09.2010.

¹³⁹ P.Verbal Intervistimi S.Alistafa



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Vlen të theksohet se në formularin e shoqërimit shënohej ora e mbërritjes së personit të shoqëruar në komisarariat dhe jo ajo e shoqërimit të tij nga strukturat e policisë së shtetit. Ky veprim, nuk është korrekt, pasi duke patur parasysh vetë rubrikën përkatëse të regjistrimit ku figuron "ora e shoqërimit", punonjësi i policisë duhet të pasqyrojë në këtë rubrikë si orë shoqërimi, orën, në momentin kur personi merret nga policia, dhe jo atë të mbërritjes në komisarariat.

Pavarësisht largësisë apo ndalesave gjatë rrugës për në komisarariat të të shoqëruarve, nuk duhet cënuar afati ligjor i shoqërimit (10 orë).

Komisariati Policisë Bulqizë.

Në këtë komisarariat kishte 6 dhoma sigurie dhe shoqërimi, por asnjëra prej tyre nuk është në funksionim.

Nga kqyrja e këtyre dhomave u konstatua se ishin jashtë çdo kriteri teknik të parashikuara në Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH dhe Urdhërin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH

Personat e ndaluar ose arrestuar dërgoheshin në ambientet e Komisarariatit të Policisë Dibër.

Personat e shoqëruar intervistoheshin nga ana e punonjësve në zyrat e tyre që linin për të dëshiruar.

Gjatë intervistës shefi i komisarariatit k/komisar **Alfred NOMANI**, u shpreh se jo vetëm dhomat e sigurisë, por edhe gjithë godina e komisarariatit është jashtë çdo kriteri teknik. Kjo situatë është bërë prezent në strukturat eprorë që prej dy vjetësh.

KONKLUZIONE

1. Ambientet e shoqërimit të personave në Kom. Pol Dibër dhe Mat nuk ishin në përputhje me Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH.
2. Regjistri i personave të shoqëruar në Kom. Pol Dibër dhe Mat nuk ishte në përputhje me Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhërin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja nr.2) të DPPSH
3. Formulari i shoqërimit nuk mbahej dhe nuk administrohej në përputhje me me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH.
4. Plotësimi i regjistrimit të shoqërimit të personave në Kom.Pol. Dibër dhe Kom.Pol. Mat nuk pasqyronte në mënyrë të qartë arsyen e shoqërimit.
5. Dhomat e sigurisë në Kom.Pol. Bulqizë ishin jashtë funksionit për shkak të amortizimit total të tyre. Po ashtu edhe godina e komisarariatit brenda të cilës ishin këto dhoma ishte tejet e amortizuar dhe në prag shembjeje.
6. Në Kom.Pol.Bulqizë nuk kryheshin procedura për personat e shoqëruar.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

7. Dhomat e sigurisë në Kom.Pol Dibër dhe Kom.Pol Mat nuk ishin në përputhje me Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 dhe Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.
8. Regjistri i personave të ndaluar dhe arrestuar nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja nr.1) të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH.
9. Në organikën e DPQ, Dibër mungon pozicioni i mjekut.

DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT, KUKËS

Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës është e strukturuar nga 3 Komisariate:

Komisariati i Policisë Kukës,

Komisariati Policisë Has

Komisariati Policisë Tropojë.

Grupi i inspektimit kontaktoi Drejtorin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Kukës Drejtues **Sadri RAMCAJ**, i cili bëri prezent kushtet aktuale të dhomave të sigurisë, trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar, si dhe problemet që dalin gjatë dinamikës së përditshme të punës.

Gjatë intervistës z. Ramcaj u shpreh se për vitin 2010 nga ana DPPSH, është prokuruar rikonstruksioni i plotë i ambienteve të DPQ Kukës dhe Komisarariatit Kukës dhe aktualisht punimet për rikonstruksionin e plotë, përfshirë edhe dhomat e sigurisë janë në përfundim. Data e dorëzimit të objektit është 11.05.2011.

Komisariatet e DPQ, Kukës, kanë ambiente shoqërimi dhe dhoma sigurie, me përjashtim të Komisarariatit të Policisë Has.

Të ndaluarit apo arrestuarit trajtohen më ushqim nga strukturat përkatëse të policisë.

Në lidhje me trajtimin ushqimor të personave të ndaluar apo arrestuar, z.Ramcaj, u shpreh se në buxhetin e komisarariatit, për vitin 2011, është parashikuar si zë i veçantë, trajtimi ushqimor në masën 110. 000 lek, për garantimin e të cilit nuk është lidhur një kontratë shërbimi (catering) me subjekt privat për shkak të mungesës së interesit nga ana e operatorëve ekonomikë. Ushqimi për personat e ndaluar apo arrestuar gatuhet në kuzhinën e komisariateve përkatëse.

Komisariati i Policisë Kukës.

Për personat e ndaluar apo arrestuar:



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Në Komisariatit e Policisë, Kukës ka 4 dhoma sigurie të cilat përdoren për dy kategoritë (meshkuj, femra,) të cilat nuk ishin të kategorizuara¹⁴⁰.

Në momentin e inspektimit në këto ambiente kishte 1 person të arrestuar.

Infrastruktura

Secila prej dhomave të sigurisë kishte përmasa 220 x 140 cm dhe dritare 30 x 60 cm dhe asnjë parametër nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Në dhoma nuk sigurohej ajrim normal dhe ndriçim i mjaftueshëm natyral, si dhe nuk bëhej ajrimi i të ndaluarve apo arrestuarve siç parashikon Kreu IV paragrafi VI i Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"

Po ashtu, kushtet higjieno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv, nuk kishte nyje të posaçme për larjen e trupit, siç parashikohet në Kreun IV / A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike".

Duhet theksuar se dhomat e sigurisë ishin në rikonstrukcion në prag të dorëzimit nga operatori ekonomik i kontraktuar nga DPPSH.

Pavarësisht punës së mirë të bërë nga subjekti i kontraktuar, nga kqyrja e këtyre dhomave u konstatua se disa nga kushtet teknike, jetësore dhe të sigurisë që parashikon Urdhëri nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH dhe Urdhri nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH, nuk ishin respektuar si psh:

Vendosja e prizave elektrike në ambientet e qëndrimit, nyjet e larjes së trupit, etj.

Kushtet e trajtimit

Nga verifikimi i kryer rezultoi se:

Të ndaluarit apo arrestuarit trajtohen me ushqim nga struktura përkatëse e policisë në bazë të numrit të personave në dhomat e sigurisë. Ushqimi gatuhet në kuzhinën e komisarariatit, pasi nuk ka një kontratë shërbimi (catering) me subjekt privat për shkak të mungesës së interesit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Në strukturën organike të DPQ Kukës nuk ka mjek.

Shërbimi shëndetësor për të ndaluarit apo arrestuarit, ofrohet nga Spitali Rajonal, Kukës.

Gjatë intervistës i arrestuari N.T, nuk paraqiti ndonjë ankesë lidhur me trajtimin nga punonjësit e policisë, trajtimin ushqimor dhe atë shëndetësor.

¹⁴⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Kukes



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Dokumentacioni

U verifikua dokumentacioni i cili mbahej në dhomat e sigurisë¹⁴¹, në përfundim të të cilit rezultoi se:

- Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar - Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010. Përsa i përket mënyrës së mbajtjes rezultoi të ishte mbajtur në rregull.
- Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte dhe mbajtur pastër.
- Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nuk ishin pasqyruar të gjithë personat pavarësisht pasjes ose mospasjes së sendeve personale, por për aq sa ishte plotësuar, ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë nuk ishin pasqyruar të gjithë personat
- Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit, ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- Regjistër i pranimit të ushqimit nga familjarët , nuk parashikohet nga procedurat standarde, për t'u administruar nga dhomat e sigurisë, por përdorej në rastet kur me rekomandim të mjekut personi kishte nevojë për trajtim të diferencuar ushqimor.
- Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.

Për shoqërimin e personave:

Në këtë strukturë ka një dhomë shoqërimi¹⁴².

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit të personave nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal si edhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Në këtë dhomë nuk kishte paisje dhe orendi në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009.

Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"¹⁴³.

Dokumentacioni

¹⁴¹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Kukës

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.8 prot, dt. 03.01.2011,

2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.6 prot, dt. 03.01.2011.

3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.16 prot, dt. 03.01.2011.

4. Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.49 prot, dt. 09.03.2011.

5. Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit nr.9 prot, dt. 03.01.2011

6. Regjistër i pranimit të ushqimit nga familjarët nr.118 prot, dt.30.08.2010

¹⁴² Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Kukes

¹⁴³ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Kukes



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me personat e shoqëruar në Zyrën e Informacionit¹⁴⁴ rezultoi se:

- *Formati nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.*
- *Në disa raste në rubrikën arsyeja e shoqërimit nuk pasqyrohej qartë arsyeja e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me termin "verifikim", si edhe verifikimi ishte me afate të gjata deri edhe në 10 orë.*

Ng verifikimi i kryer në lidhje me formularin "SH" rezultoi se mënyra e plotësimit dhe administrimit ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"

Komisariati i Policisë Tropojë

Për personat e ndaluar apo arrestuar:

Në këtë strukturë kishte 11 dhoma sigurie, por vetëm 3 prej tyre ishin në funksionim respektivisht 2 për meshkuj e 1 për femra ndërsa të ndaluarit/arrestuarit të mitur dërgohen në ambientet e DPQ Tirane¹⁴⁵.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të ndaluar.

Theksojmë se në bazë të një marrëveshjeje të përbashkët mes DPPSH dhe DPB, kësaj të fundit i janë vënë në dispozicion, 8 dhoma sigurie të Komisarariatit të Policisë, Tropojë deri në përfundim të rikonstruksionit të plotë të IEVP, Tropojë.

Infrastruktura

Secila prej dhomave të sigurisë kishte përmasa 110 x 220 cm dhe dritare 30 x 60 cm dhe asnjë parametër nuk ishte në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore".

Në dhoma nuk sigurohej ajrim normal dhe ndriçim i mjaftueshëm natyral, si dhe nuk bëhej ajrimi i të ndaluarve apo arrestuarve siç parashikon Kreu IV paragrafi VI i Urdhrit nr.64, datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH për miratimin e "Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Njësitë Policore"

Po ashtu, kushtet higjeno - sanitare nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në aktet e lartpërmendura, pasi tualeti ishte kolektiv, nuk kishte nje të posaçme për larjen e trupit, siç parashikohet në Kreun IV / A, pika 5/1, të Urdhërit nr.1417, datë 11.12.2009

¹⁴⁴ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Kukes / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.10, datë 03.01.2011.

¹⁴⁵ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" DPQ, Tropojë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

të DPPSH, "Për miratimin e Procedurave Standarte të Punës të Departamentit të Sigurisë Publike"¹⁴⁶.

Kushtet e trajtimit

Nga verifikimi i kryer rezulton se:

Të ndaluarit apo arrestuarit trajtohen me ushqim nga struktura përkatëse e policisë në bazë të numrit të personave në dhomat e sigurisë. Ushqimi gatuhej në kuzhinën e komisariatit, pasi nuk ka një kontratë shërbimi (catering) me subjekt privat për shkak të mungesës së interesit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Shërbimi shëndetësor për të ndaluarit apo arrestuarit, ofrohej nga Spitali Rajonal, Bajram Curri.

Dokumentacioni

Nga verifikimi i dokumentacioni në dhomat e sigurisë¹⁴⁷, rezultoi se:

- a) Regjistër i personave të ndaluar/arrestuar
 - Format i nuk ishte në përputhje me procedurat Standarde dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.
 - Ishte mbajtur në rregull.
- b) Regjistri i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit - Kishte mospërputhje të formatit me objektin, ndërsa përsa i përket mënyrës së mbajtjes rezultoi të ishte mbajtur në rregull.
- c) Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë
 - Kishte mospërputhje të formatit me objektin,
 - Nuk ishin pasqyruar të gjithë personat
- d) Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit - ishte plotësuar në mënyrë korrekte
- e) Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit - ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- f) Libër i kontrollit në dhomat e sigurisë. - ishte plotësuar në mënyrë korrekte.
- g) Fashikulli nuk kishte të ndaluar/arrestuar.
- h) Listë e punonjësve të shërbimit në dhomat e sigurisë. U gjet e rregullt dhe e afishuar.

Për shoqërimin e personave:

Në këtë strukturë kishte 1 dhomë për shoqërimin e personave¹⁴⁸.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar.

¹⁴⁶ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. nr.1 , Tropojë

¹⁴⁷ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Tropoje

1. Regjistër i personave të ndal/arrest. nr.41 prot, dt. 16.08.2007,

2. Regjistër i Sendeve Personale të të Ndaluarit dhe të Arrestuarit nr.66 prot, dt. 23.09.2010.

3. Libri i Vizitave Mjekësore në Dhomat e Sigurisë, nr.61 prot, dt. 16.08.2010.

4. Libri i Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit nr.49 prot, dt. 05.01.2011.

5. Regjistri i marrjes në pyetje nga Prokurorët, OPGJ dhe takimit të avokatëve me të ndaluarit dhe të arrestuarit nr.41 prot, dt. 31.03.2008

6. Regjistër i kontrollit në dhomat e sigurisë nr.44 prot, dt.29.05.2008.

¹⁴⁸ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Tropojë



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

Infrastruktura

Dhoma e shoqërimit të personave nuk kishte hapësirë dhe ajrim normal si edhe ndriçim natyral të mjaftueshëm.

Në këtë dhomë nuk kishte paisje dhe orendi në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009.

Kushtet higjieno sanitare nuk plotësonin kriteret e Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 i Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike¹⁴⁹.

Dokumentacioni

U verifikua dokumentacioni në lidhje me personat e shoqëruar i cili ndodhej në Zyrën e Informacionit¹⁵⁰ nga i cili rezultoi se: Formatu nuk ishte në përputhje me procedurat Standarte dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010.

Kishte përdorim të kodeve policore në rubrikën "Punonjësi i policisë që ka bërë shoqërimin"

Në disa raste në rubrikën arsyeja e shoqërimit nuk pasqyrohej qartë arsyeja e shoqërimit, por mjaftoheshin vetëm me termin "verifikim", si edhe verifikimi ishte me afate të gjata deri edhe në 10 orë.

Kishte korrigjime të shpeshta të cilat për nga mënyra e përdorimit e bënë informacionin të palexueshëm.

Nga verifikimi i kryer në lidhje me formularin "SH" rezultoi se mënyra e plotësimit dhe administrimit ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH "Për miratimin e Procedurave Standarte të Dep. të Sig. Publike"

Komisariati Policisë Has.

Në këtë komisarjat kishte 2 dhoma sigurie dhe shoqërimi, por asnjëra prej tyre nuk ishte në funksionim.

Nga kqyrja e këtyre dhomave u konstatua se ishin jashtë çdo kriteri teknik, jetësor dhe sigurisë të parashikuara në Urdhërin nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH dhe Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të PSH Personat e ndaluar ose arrestuar dërgoheshin në ambientet e Komisarjatisë të Policisë Kukës, ku distanca nga Kruma (qendra administrative e rrethit Has) në Kukës është 32 km dhe terreni është i vështirë dhe dërgimi i të gjithë personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar në Komisarjatin e Policisë Kukës ka kosto të lartë.

Gjatë intervistës shefi i komisarjatisë k/komisar **Ndricim KOKA**, u shpreh se problemi i mosfunksionimit të dhomave të sigurisë për shkak të amortizimit është

¹⁴⁹ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Tropojë

¹⁵⁰ Proc-Verb "Për mbledhjen e të dhënave gjatë inspektimit" Kom.Pol. Tropojë / Regjistër i Personave të Shoqëruar. Nr.64, datë 16.09.2010.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

bërë prezent në strukturat eprore, në mënyrë që ato të kthehen në gjendje funksionale.

KONKLUZIONE

1. Ambientet e shoqërimit të personave në Kom. Pol.Kukës dhe Tropojë nuk ishin në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH.
2. Regjistri i personave të shoqëruar në Kom. Pol.Kukës dhe Tropojë nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja model nr.2) të DPPSH.
3. Në Kom.Pol.Kukës, formulari i shoqërimit nuk mbahej dhe nuk administrohej, gjë që bie në kundërshtim me pikën D/5 të kapitullit V të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH.
4. Plotësimi i regjistrit të shoqërimit të personave në Kom.Pol. Kukës dhe Tropojë nuk pasqyronte në mënyrë të qartë arsyen e shoqërimit.
5. Në Kom.Pol. Has, nuk mbahej dokumentacion për personat e shoqëruar, ndaluar apo arrestuar.
6. Dhomat e sigurisë në Kom.Pol Kukës dhe Tropojë nuk ishin në përputhje me Urdhrin nr.64, datë 25.01.2010 dhe Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH.
7. Regjistri i personave të ndaluar dhe arrestuar në Kom.Pol.Kukës dhe Tropojë nuk ishte në përputhje me Urdhrin nr.1417, datë 11.12.2009 dhe Urdhrin nr.506, datë 06.05.2010 (Lidhja model nr.1) të DPPSH.
8. Në dhomat e sigurisë të Kom.Pol.Kukës dhe Tropojë mungonte nyja për larjen e trupit siç parashikohet në Kreun IV/A, pika 5/1, të Urdhrit nr.1417, datë 11.12.2009 të DPPSH.
9. Dhomat e sigurisë së Kom.Pol. Kukës ishin në rikonstruksion dhe në muajin maj 2011, pritej dorëzimi i tyre. Duhet theksuar se paraprakisht nga kqyrja e këtyre dhomave në rikonstruksion, konstatohet se nuk plotësohen disa nga kushtet dhe kriteret e sigurisë, kryesisht sa i përket instalimeve elektrike.
10. Në organikën e DPQ, Kukës mungon pozicioni i mjekut.

Megjithë punën e bërë dhe përkushtimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të inspektuara sjellim në vëmendjen e tyre disa rekomandime zbatimi i të cilave mendojmë se do të përmirësojë edhe më tej punën e këtyre strukturave.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

REKOMANDIME

1. Respektimi i lirive e të drejtave të personave të ndaluar apo arrestuar të jetë një prioriteti punës së punonjësve të Policisë së Shtetit.
(Afati – Në vazhdimësi)
2. Të merren masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë e Policisë në Qarqe për përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve (duke i shtuar) të ambienteve të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë në nivel komisarati në përputhje me standartet e miratuara.
(Afati - Menjëherë)
3. Të njihen dhe të zbatohen me rigoroizitet nga të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike miratuar me Urdhrin Nr. 1417, datë 11.12.2009, Manuali "Për rregullat e Trajtimit dhe sigurimit të të ndaluarve dhe arrestuarve në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 64, datë 25.01.2010, si dhe Urdhri Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
(Afati – Në vazhdimësi)
4. Të trajnohen punonjësit e shërbimit të informacionit dhe dhomave të sigurisë për njohjen dhe zbatimin e Ligjit nr. 9749 "Per Policinë e Shtetit" dhe kreun IV dhe V të Procedurave Standarte të Punës miratuar me Urdhrin Nr. 1417, date 11.12.2009.
(Afati – Në vazhdimësi)
5. Të unifikohen dhe standartizohen nga Drejtoritë e Policisë së Qarqeve regjistrat e parashikuar në pikën 3, gërma B Kreu IV dhe gërma D e kreut V të Procedurave Standarte miratuar me Urdhrin Nr. 1417, date 11.12.2009 dhe Urdhrit Nr. 506, datë 06.05.2010 "Mbi dokumentimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar e arrestuar, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit".
(Afati – 6 muaj)
6. DPQ Lezhë, DPQ Shkodër dhe DPQ Korçë çdo rast të dërgimit të personave të ndaluar dhe arrestuar nga komisaritet e rretheve në komisaratin e qendrës së qarkut ta shoqërojnë me akt administrativ.
(Afati – Menjëherë)
7. DPQ Shkodër dhe DPQ Korçë të marrin masa për përmirësimin e trajtimit me ushqim i personave të shoqëruar dhe të miratojnë aktet përkatëse administrative për rregullimin e kësaj veprimtarie.
(Afati – Menjëherë)



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit European".

8. Komisariati i Policisë Vlorë të marrë masa për trajtimin me ushqim të personave të ndaluar apo arrestuar.

(Afati – Menjëherë)

9. Komisariati i Policisë Has dhe Sarandë të marrë masa për mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit për personat e shoqëruar, ndaluar apo arrestuar.

(Afati – Menjëherë)

10. Të merren masa për mbulimin e gjithë Drejtorive të Policisë në Qarqe (DPQ Dibër dhe DPQ Kukës), me shërbim shëndetësor.

(Afati – 3 muaj)

11. Të sigurohen nga DPPSH dhe Drejtoritë e Policisë në Qarqe ambiente dhe paisje profesionale (aparate, ilace, kartela, mjeksore etj) të mjekëve dhe nd/mjekëve, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit për një punë normale dhe *ruajtjen e konfidencialitetit të personave të arrestuar* në mënyrë që vizitat mjekësore të jenë sa më efektive.

(Afati – 6 muaj)

12. Të rishikohen nga DPPSH nenet 11 (pika 6), 101, 103, 106, 107 dhe 110 të Ligjit nr. 9749 "Për Policinë e Shtetit" dhe Procedurave Standarte IV dhe V "Sigurimi dhe trajtimi i personave të arrestuar dhe ndaluar nga Policia" dhe "Shoqërimi e trajtimi i personave në ambientet e Policisë së Shtetit" të Urdhërit Nr. 1417, datë 11.12.2009 në mënyrë që të jenë sa më të qarta dhe të zbatueshme. Për këtë duhet të garantohet:

- a. Momenti fillestar i shoqërimit të personit.
- b. Përcaktimin e punonjësve që shënojnë/dokumentojnë të dhënat e personit të shoqëruar në momentin e mbërritjes në strukturën policore.
- c. Detyrimin për ekzaminim si nga mjeku i policisë por edhe nga eksperti i mjekësisë ligjore në të gjitha rastet e pretenduara për tejkalim të forces apo dëmtimeve trupore.

(Afati – Sapo të bëhet i mundur ndryshimi i Ligjit nr. 9749)

13. Të hartohet nga DPPSH një formular/deklaratë (përmbledhje e të drejtave) e personit të shoqëruar/arrestuar ku të deklarohet se ai njihet me të drejtat e tij. Ky dokument duhet të kundërfirmoset nga i shoqëruari duke shënuar datën dhe orën menjëherë sapo arrin në strukturën policore.

(Afati – 3 muaj)

14. Të parashikohen fondet në buxhetin e Policisë së Shtetit për instalimin e kamerave në ambientet e Sigurisë.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian"

(Afati – Deri në fund të vitit 2011)

15. Të përmiresohet koordinimi i punës ndërmjet strukturave të PSH dhe atyre të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me zhvendosjen në kohë në vendin e vuajtjes së dënimit ose institucionin e paraburgimit, të personave të arrestuar që kanë marrë masën e sigurisë "Burg pa afat"

(Afati – Në vazhdimësi)

16. Të inicohet një marrëveshje ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për trajtimin e personave të arrestuar për përballimin e situatave të vështira (arrestime masive).

(Afati – 3 muaj)

17. Të respektohen nga strukturat policore garancitë procedurale të Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Policinë e Shtetit, Procedurat Standarte të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike. Nëse rastet e verifikimit të dhunës së ushtruar ndaj qytetarëve autoritetet policore të zbatojnë nenet 281 dhe 282 të KPP.

(Afati – Në vazhdimësi)

18. Të rritet mbikqyrja dhe llogaridhënia brenda strukturave policore.

(Afati – Në vazhdimësi)

FALENDERIM

Grupi i inspektimit i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm falenderon drejtuesit dhe punonjësit e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Durrës, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Vlorë, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Gjirokastrë, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Korçë, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Fier, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Berat, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Elbasan, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Lezhë, e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Dibër dhe të e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Kukës për bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe gadishmërinë e treguar gjatë zhvillimit të inspektimit.

Pjesë e këtij raporti inspektimi janë edhe fotot e dhomave të sigurisë dhe ambienteve të shoqërimit për të treguar më qartë veprimtarinë e strukturave të Policisë së Shtetit.

Ky raport i përpiluar në 121 faqe është bazuar në parimet e përgjegjshmërisë, paanshmërisë dhe transparencës.



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

Raport "Konstatimi i gjendjes aktuale të trajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të 12 Rekomandimeve të Raportit Analitik për vitin 2010 të Komisionit Europian".

Drejtori i Inspektimit

Heral SARAÇI

Përgjegjësi i Sektorit

Florian SULEJMANI

Inspektor

Altin PONARI

Inspektore

Rita GJATI

Inspektor

Sterjo GOLLOSHI

Inspektor

Artan KOLA

Inspektor

Ilir QARRI

Inspektor

Enton RADOVANI